

**INSTITUT ZA NAUČNA ISTRAŽIVANJA I RAZVOJ
INSTITUTI PËR KËRKIME SHKENCORE DHE ZHVILLIM
INSTITUTE FOR SCIENTIFIC RESEARCH AND DEVELOPMENT**

**NAUČNI BILTEN
BULETINI SHKENCOR**
Međunarodni naučni časopis
Revista Shkencore ndërkombëtare
International Scientific Journals

Seria e shkencave juridike

Seria pravnih nauka

**Br/Nr. 9-4
God - Viti IV / 2017**

Ulcinj-Ulqin

Montenegro

REDAKSIA

Prof.Ass. Dr. Shefket Jakupi, (kryeredaktor)
Yllka R.Imeri (sekretare shkencore)
Prof.Asc Dr.Azeta Tartaraj
Dr.Rovena Vata
Dr.Ylvije Kraja

DREJTOR I REVISTËS

Prof.Ass.dr. Elez Osmani

CIP – Каталогизација у публикацији
Централна народна библиотека Црне Горе, Цетиње 330(905L)
NAUČNI bilten:ekonomska istraživanja
Buletin Shkencor:hulumtime ekonomike

E- ISSN 2337-0521

ISSN 1800-9794

COBISS.CG-ID 20586256

Shtëpia botuese Qendra për hulumtime ekonomike -Ulqin

Shtypëshkronja **ROZAFA 1** Shkodër

Korrektori dhe punoi në kompjuter

Vait Nikaj

E drejta e autorit :

Instituti per kerkime shkencore dhe zhvillim

"Redaksia e Buletinit Shkencor"

Ulqin

Adresa e redaksisë :

Instituti per kerkime shkencore dhe zhvillim

"Redaksia e Buletinit Shkencor"

Ulqin ++382 69 265 707

web.: www.ekonomskiinstitut.com

**KOMITETI EDITORIAL INTERNACIONAL
INTERNATIONAL EDITORIAL COMMITTEE
Bordi shkencor i buletinit shkencor**

Prof.Dr Arta Museraj- Themeluese dhe drejtuese e "Academicus- International Scientific Journal,Kryetare

Prof.Dr.Arjeta Troshani dekan i fakultetit Ekonomik,Universiteti"Luigj Gurakuqi"Shkodër (kryetare)

Prof.Dr.Predrag Goranoviq-Fakulteti Ekonomik Podgorica

Prof.Ass.Dr.Artan Haxhi- Rektor Universiteti"Luigj Gurakuqi",Shkodër

Prof.Dr.Isak Mustafa-Kryetar i Institutit të financave Kosovë

Prof.Dr.Beqir Kalaç-Universiteti internacional Novi Pazar

Dr.Dragoljub Jankoviqi-Fakulteti per studime te biznesit ne Podgoricë

Prof.Ass.Dr.Hidajet Shehu Univivrsiteti Bujqesor"UBT", Tiranë

Prof.Ass.Dr.Mithat Mema-Rektor Universiteti"Aleksanderr Moisiu",Durres

Prof.Ass.Dr Armand Universitetit publik"Haxhi Zeka"Peje

Prof.Dr.Halid Kurtoviq-Universiteti i Zenicës

Prof.Dr.Husnija Bibiljica –Dekan i fakultetit të turizmit Universiteti"Haxhi Zeka" Peje

Prof.Dr.Laszlo Karpati Universiteti per biznes në Budapesht-Hungari

Prof.Ass.Dr.Illir Hoti-Dekan-fakulteti ekonomik"Aleksanderr Moisiu"Durres

Prof.Ass.Dr.Edmond Beqiri-Rektor Kolegji "Dugagjini" Pej, Kosovë

Prof. Ass.Dr.Shefket Jakupi, Universiteti Publik "ISA BOLETINI" Mitrovicë, Kosovë

Përmbajtja

1.Qëndrueshmëria e veprave penale të kryera me veprim dhe mosveprim	1
Jetmire Zeqiri	
2.Përgjimi në legjislacionin penal Shqiptar	10
Dr. Adrian LEKA	
3.Trafikimi i qënieve njërezore.....	21
Dr. Adrian LEKA	
Prof.Asc.Dr.Illir Berhani	
4.Dezintegrimi i Jugosllavisë dhe çështja e Kosovës	33
Ph.D Mustafë Haziri	
Ma. Agim Hyseni	
Ma. Milazim Hajra	
5.Ndikimi i opinionit të Komisionit të Venecias në vendimarrjen e Gjykatës Kushtetuese për ligjin nr. 133/2015 "Mbi trajtimin e pronës dhe finalizimin e procesit të kompensimit të pronave.....	39
Prof. Asoc. Dr. Florian BJANKU	
Eriklida SHPORI	
6.Shoqëria Civile dhe Interferimet e saja në Funksonimin e Shtetit Demokratik	52
Hajrullah Mustafa	
7.Diplomacia e Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore 1945-1978	57
Msc. Kosovar Alija	
8.Femrat e panatyrshme: Shmangiet nga normat morale viktoriane në romanin <i>Armadel të Uillki Kollinsit</i>	66
Dr. Suzana Ibraimi Memeti	
9.Mbrojtja e dhunës në familje	73
Msc. Besmir Nikqi	
Bsc.Milot Blakaj	
10.Dënimi me gjobë ndaj veprave penale në republikën e Maqedonisë.....	86
PhD candidate, Nurten Kala Dauti	
11.ВРШЕЊЕ НА РОДИТЕЛСКИТЕ ОДГОВОРНОСТИ ВО ЕВРОПСКИТЕ ЗЕМЈИ ...	95
Mr.sc. Irma Bajrami	
12.Mbështetja juridike lidhur me politikat strategjike për një zhvillim ekonomik në harmoni me mbrojtjen e mjedisit: “Green economy,,	105
MSc Rosalba Basho	
Dr.Senada Reçi	
13.Elementet themelore te vepres penale.....	113
IRIDA B.QOKU	

1.Qëndrueshmëria e veprave penale të kryera me veprim dhe mosveprim

Jetmire Zeqiri

Universiteti i Tetovës, Maqedoni, jetmire.zeqiri@unite.edu.mk

Abstract

Offenses stable or permanent as continuing offenses are doctrinal creation of law in general. Consistent with perceived offenses offenses that violate the criminal-legal relationship for a time in a continuous manner, ie. Latenente staying fit. In this type of offense consequences and consumption or the commission of the offense come slowly, lasting for a period of time. Consistent offense in action and consequences appear as a whole desired by the subject for prolonged unlawful action.

The structure of the offense stable is the legal nature of this offense only and it is not possible to share in some offense, being a single object legal prejudice at the time of the violation by action or inaction, in order to make such cases termination of punishment and other institutions to act when completed state of lawlessness.

Keywords: sustainable offenses, action, inaction, damaged, criminal action, the subject of the offense, the object of the offense etc.

Hyrje

Si vepra penale të qëndrueshme mund të përmendim p.sh rrëmbimin e personit, heqja e paligjshme e lirisë, pushtimi i tokës, armëmbajtja pa leje, dezertimi, etj. Vepra penale e qëndrueshme quhet e filluar në momentin në të cilin është realizuar minimumi i nevojshëm i mbajtjes së cënimit të marrëdhënies juridiko-penale, e nevojshme për ekzistencës e saj. Në qoftë se nuk realizohet ky minimum i nevojshëm kemi të bëjmë me rastet e tentativës, p.sh. kemi të kryer rrëmbimin e personit vetëm në qoftë se i dëmtuari është privuar nga liria personale për një kohë të konsiderueshme. Kjo vepër konsumohet në momentin në të cilin pushon veprimi i vullnetshëm dhe i kundërligjshëm i mbajtjes. Qëndrueshmëria pushon jo vetëm kur autori i jep fund veprimit kriminal, *pushim i vullnetshëm* (p.sh. lirimi i personit të rrëmbyer), por edhe për pamundësinë e kryerjes se tij, *pushim i forcuar* (p.sh. arrestimi i fajtorit apo shpëtimi i të rrëmbyerit nga vetë ai apo persona të tjerë).

Pushimi i veprimit ka rëndësi në të drejtën penale për parashkrimin, amnistinë, veprimin në kohë dhe hapësirë të ligjit penal, etj. vepra penale e qëndrueshme mund kryhet në dy faza:

- a) faza e kryerjes së veprimit (p.sh. në heqjen e paligjshme të lirisë kjo fazë konsiston në privimin e lirisë personale);
- b) faza e mbajtjes së kësaj gjendjeje të kundërligjshme, që zgjat në kohë (mbajtja e personit në gjendjen e privimit të lirisë personale.

Si vepra penale të qëndrueshme mund të përmendim p.sh rrëmbimin e personit, heqja e paligjshme e lirisë, pushtimi i tokës, armëmbajtja pa leje, dezertimi, etj.

1. Përkufizimi mbi kohëzgjatjen në veprën penale të qëndrueshme

Çdo vepër penale zë një periudhë kohe të caktuar, të përfshirë mes veprimit dhe ardhjes së pasojës, e cila njihet si *dies a quo* dhe *dies ad quem*, intervali i këtyre dy momenteve quhet

edhe kohëzgjatje e veprës penale. Kuptimi i kohëzgjatjes përmban në vetvete edhe qëndrueshmërinë e veprimit apo mosveprimit për këtë arsye duhet shpjeguar se çfarë duhet të kuptohet me qëndrueshmëri, duke iu referuar doktrinës më të mirë bashkëkohore.

Qëndrueshmëria nënkupton vazhdimësi, stabilitet, qëndresë, rezistencë, mundësia a aftësia e diçkaje për t'u ruajtur mjaft kohë pa ndryshuar dhe është një koncept i cili përdoret shpesh edhe në praktikë. Nocioni i saj lë të kuptojë atë të kohës edhe në rastin e veprës penale¹. Folja qëndroj është sinonim i foljes zgjat: duke iu referuar veprës penale do të thotë që ajo është në gjëndje të shtrihet në kohë, si periudhë kohore në të cilën subjekti realizon të gjitha elementët që e përbëjnë veprën penale, duke ndryshuar botën e jashtme.

Kjo qëndrueshmëri në strukturën e veprës penale të qëndrueshme ka një zotësi cënimi të objektit juridik, në thelb të vetëm, pasi nuk jemi në rastin e disa cënimeve të objekteve të njëjta apo të ndryshëm që janë vazhdimësi e njëri tjetrit në kohë, si në rastin e veprës penale vazhduese. Një koncept i vetëm, një cënim i vetëm që zgjat në kohë dhe që mund të zgjasë edhe pa u parapërcaktuar kohëzgjatja më para.

Për disa autorë qëndrueshmëria nënkupton një fazë të mëtejshme të konsumimit të veprës penale². Në këtë kuptim qëndrueshmëria e saj do të konsistonte në një periudhë tipike të zgjatjes së kundërligjshmërisë, e cila në vetvete nuk përbën element të veprës penale.

Për disa autorë të tjerë, kohëzgjatja përbën një fazë mbas asaj të konsumimit e cila do të përbente një element të veprës penale të përfshirë të tillë në veprimin e autorit të veprës penale si element i anës objektive që do të përcaktonte dhe llojin e figurës konkrete të veprës penale³. Ne jemi për mendimin e dytë pasi koha për këtë lloj veprë penale ka një rëndësi juridike shumë të madhe edhe pse në përmbajtjen e dispozitës ligjore nuk parashikohet shprehimisht elementi kohor apo të merret parasysh kohëzgjatja e tij në përshkrimin e figurës së veprës penale.

Duke u bazuar në këtë arsyetim koha do të fitonte në strukturën e veprës penale rolin e një elementi tipik për çdo figurë konkrete të veprës penale, pasi siç e trajtuam edhe mësipër në veprat penale të qëndrueshme është thelbësore jo vetëm veprimi i personit që cënon objektin juridik por edhe ai i mëvonshëm për mbajtjen e tij. Kështu që krahas elementëve përbërës të veprave penale të qëndrueshme duhet të përfshihet në anën objektive në mënyrën si element i saj mbajtja për një periudhë kohore të kundërligjshmërisë së krijuar që do të ishte thelbësore për vetë ekzistencën.

Qëndrueshmëria, si element i zgjatjes së veprimit do të përbente në vetë vete një element të njëjtë rëndësie për konfigurimin e konsumimit. Në bazë të kujt treguesve mund të përcaktohen llojet e këtyre veprave penale, duke qenë se ligjvënësi nuk shprehet aspak mbi to? I vetëm tregues për të përcaktuar kriterin e qëndrueshmërisë së veprës penale është vetë figura konkrete e veprës penale për të vendosur nëse mund të ketë karakter kohor apo jo. Pra, është vetë dispozita ligjore e cila do të na lejonte të përcaktonim një vepër penale të qëndrueshme duke iu referuar një përjasjeje të nevojshme mes veprës penale konkrete të kryer dhe figurës e veçantë të parashikuar nga dispozita, duke pasur si tipar një minimum të nevojshëm të shtrirjes kohore të cënimit të objektit juridik⁴. Kjo për arsyen se karakteri i qëndrueshëm apo i çastit të veprës penale nuk mund të varet nga kualifikimi i shprehur ose jo

¹ Pecoraro-Albani, *Del reato permanente*, in RIDPP, 1960, fq 394.

² De Francesco, *Profili strutturali e processuali del reato permanente*, fq 568. Grisolia, *Il reato permanente*, Padova fq 5, 1996, sipas të cilit, kohëzgjatja apo qëndrueshmëria e veprës penale, paraqet fazën e perfeksionit dhe nuk paraqitet si element i veprës penale.

³ Në këtë kuptim shprehet edhe pjesa më e madhe e doktrinës bashkëkohore si Pagliaro, *Principi*, fq. 407, Mantovani, *Diritto penale*, Parte generale, fq. 447, Romano, *Commentario sistematico del codice penale*, fq. 322, Fiandaca-Musco, *Diritto penale*, Parte generale, fq. 169.

⁴ Romano, *Commentario sistematico del codice penale*, Milano, 2004, fq. 322.

i ligjvënësit por nga thelbi i vetë veprës penale duke analizuar se si veprimi shfaqet ne botën e jashtme. Përcaktimi i këtij karakteri i lihet interpretimit të gjyqësorit.

Në këtë kuptim kriteri dallues i veprës penale të qëndrueshëm konsiston në llojin e veprimit i vet pranueshëm për t'u zgjatur në kohë dhe është vetë dispozita ajo e cila imponon karakterin e zgjatjes në kohë të tij.

Veprimi apo mosveprimi duhet të analizohet thjesht duke iu referuar praktikës apo përvojës, p.sh se si kanë ecur gjërat (pasi në këtë mënyrë edhe vjedhja mund të konsiderohet si vepër penale e qëndrueshme) por duhet të analizohet lloji i veprim. Dhe lloji i veprimit analizohet në normën që e përmban e cila në vetë vete duhet të imponojë kërkimin e atij veprimi që ka atë karakter të qëndrueshëm në kohë, pa të cilin nuk mund të konsiderohet figurë e veprës penale në atë lloj⁵. D.m.th kohëzgjatja e veprimit është një kusht në veprën penale të qëndrueshme: kështu rrëmbimi apo mbajtja peng e personit neni 104 i Kodit Penal, është një vepër penale e qëndrueshme sepse kjo dispozitë përmban një lloj veprimi dhe pret një lloj rezultati (mbajtja peng), e cila duke iu referuar definicionit nuk mund të konceptohet ndryshe pa kohëzgjatjen e tyre.

Ky është dhe kuptimi i praktikës gjyqësore që në rrëmbimin dhe mbajtjen peng të personit, kërkon si kusht të vendosur nga vetë norma që e parashikon si vepër penale një kohëzgjatje, pak a shumë të gjatë kufizimit të lirisë personale, derisa ajo zgjat në një kohë të arsyeshme për të përcaktuar cënimin e objektit juridik⁶. Në këtë kuptim shprehet edhe lidhja mes cënimit dhe llojit të figurës së veprës penale. Po në c`mënyrë ndikon koha (si kohëzgjatje) në veprat penale që për vendin e rëndësishëm që zë ky element quhen edhe të qëndrueshme? Kodi Penal nuk jep asnjë definicion për këtë lloj vepra penale duke e bërë atë një produkt të tërin doktrinal andaj edhe në zbatim të dispozitave përkatëse është në diskrecion të gjykatës për të analizuar dimensionin kohor ne figurën konkrete. As Kodi Penal dhe ai i Procedurës Penale nuk parashikojnë shprehimisht dispozita në lidhje me këtë lloj vepra penale por konkluzione mund të nxirren konkretisht në dy dispozita. Konkretisht neni 76 i Kodit të Procedurës Penale që parashikon kompetencën tokësore shprehet në përgjithësi për veprat penale dhe e përcakton atë në radhë të parë aty ku ajo është kryer ose aty ku ka ardhur pasoja. Vepra penale e qëndrueshme quhet e filluar në momentin në të cilin është realizuar minimumi i nevojshëm i mbajtjes së cënimit të marrëdhënies juridiko-penale, e nevojshme për ekzistencës e saj apo për t'u konsideruar e kryer. Pra, momenti se ku ajo fillon përcakton edhe kompetencën tokësore pasi në atë moment ajo quhet edhe e kryer. Neni 252 i K.Pr.P që përcakton gjendjen e flagrancës shprehet: "Është në gjëndje flagrante ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës....". Kjo dispozitë në mënyrë të qartë përcakton gjendjen e flagrancës edhe për veprat penale të qëndrueshme përderisa kapet në kryerje e sipër të veprës penale pra kur akoma nuk ka pushuar qëndrueshmëria dhe menjëherë pasi ajo të ketë pushuar.

Në qoftë se ekzistenca e veprës penale identifikohet me harkun kohor të formimit të të gjithë elementëve që e përbëjnë, atëherë në veprën penale të qëndrueshme ky hark kohor nuk ka si mund të shprehet ndryshe por duke iu referuar momentit se kur është kryer (që përkon me fillimin e saj). Vepra penale e qëndrueshme konsumohet në momentin që zhduket çasti i zhdukjes së gjendjes kriminale, i pushimit të cënimit të marrëdhënies juridike penale. Me fjalë të tjera në veprën penale të qëndrueshme konsumimi nuk është i çastit por zgjat në kohë dhe derisa zgjat, zgjat edhe vepra penale. Pra, në këtë kuptim, vepra penale e qëndrueshme është një vepër penale e konsumuar që vazhdon të konsumohet. Ky është një mendim në doktrinë⁷ i cili që kundërshtohet nga një opinion tjetër⁸. Sipas të cilit nuk është momenti

⁵ Coppi, *Reato continuato*, Torino, 2000, fq 323

⁶Në doktrinën juridike afati për këto lloj veprash penale fillon në çastin e zhdukjes së gjendjes kriminale, pra në momentin që i jepet fund veprimit të mbajtjes peng të personit në gjendjen e kundërligjshme.

⁷ Raponi, *Ibidem*, fq. 856. Massari, *Le dottrine generali del diritto penale*, Pisa, fq. 96

konsumativ që që zgjat në kohë por është veprimi i autorit të veprës penale që në çdo moment prodhon dhe vazhdon veprën penale, janë veprimet e kundërligjshme që njëra pason tjetrën, si akte të një veprimi të vetëm.

Por, duke iu referuar nocionit të veprës penale të qëndrueshme kemi të bëjmë me një vepër të vetme, një veprim që zgjat në kohë dhe kemi të bëjmë me një cënim të vetëm dhe jo disa cënime që janë vazhdimësi e njëra tjetrës. Prandaj ne mendojmë se opinioni i dytë nuk duhet pranuar pasi është i papajtueshëm me kuptimin e qëndrueshmërisë, e cila është në vetvete e pandashme.

Duke trajtuar edhe qëndrueshmërinë apo kohëzgjatjen e veprës penale nuk duhet lënë pa trajtuar edhe ato vepra penale të qëndrueshme por që kanë një tipar të veçantë. Ky tipar shprehet në vete qëllimin e veprës penale kur ajo kryhet për të arritur një pikësynim të caktuar, siç është neni 109 i Kodit Penal, ku “rëmbimi apo mbajtja peng e personit me qëllim për të fituar pasuri etj.”. Në këtë rast qëllimi është element kryesor i anës subjektive. Kohëzgjatja e veprës penale apo qëndrueshmëria e saj ka një trajtim të veçantë në lidhje me ato vepra penale objekti i të cilëve pas cënimit rikthehet në gjendjen e mëparshme dhe që nuk prishen apo shkatërrohen në kohë, pra me pasoja formale dhe materiale.

Duke iu referuar edhe objektit material, natyrës së tij, një pjesë e doktrinës në të kaluarën është e mendimit se mund të pranohet apo përjashtohet edhe mundësia e ekzistencës apo jo e veprës penale të qëndrueshme. Kështu, sipas saj mund të formojnë objekt të kësaj vepër penale, liria personale e personit, ndërsa jeta është rasti tipik i një objekti i cili po të cënohet nuk mund të rikthehet më. Pra, ky mendim i ndan objektet juridike në materiale dhe jo materiale dhe në bazë të tij caktohet nëse ekziston ose jo vepra penale e qëndrueshme⁹. mundësisë së ardhjes së tyre, mungon lidhja shkakësore”, (*Nullum crimen, nulla poena sine causa*)¹⁰.

Lidhja shkakësore zhvillohet në kohë dhe në hapësirë ku shkak i paraprur kurdoherë pasojës dhe pasoja shfaqet si një *quid temporalmente* i dallueshëm nga shkak i veprimit¹¹. Ky shkak duhet të jetë i domosdoshëm, vendimtar, përcaktues në ardhjen e pasojës duke mos u pajtuar me shkakun tipik, të përafërt apo adekuat¹². Edhe në veprën penale të qëndrueshme veprimi dhe pasoja janë pjesë të lidhjes shkakësore dhe pavarësisht lidhjes shkakësore se sa mund të zgjasë, duke iu referuar edhe natyrës së veprës penale të qëndrueshme, ajo konkretizohet gjithmonë në një çast. Është pikërisht ky çast për të cilin kjo vepër penale konsumohet¹³, prandaj do të ishte e vështirë të konceptohet zgjatja apo qëndrueshmëria e lidhjes shkakësore. Në momentin që verifikohet edhe lidhja shkakësore e iniciuar nga veprimi i autorit të veprës penale, nuk ngelet që pasoja të vijë dhe të zgjasë në kohë. Kohëzgjatja e pasojës apo e gjendjes së kundërligjshme është rrethanë që karakterizon natyrën e këtyre veprave penale dhe merret si bazë për caktimin e dënimit. Pasoja, me anë të së cilës i jepet fund lidhjes shkakësore zgjat në kohë tek këto lloj veprash penale. Për më shumë në veprat

⁸Petrocelli, *Il delitto tentato*, Padova, 1955.

⁹Ky mendim ka pasur kritika, duke u bazuar në llojin e objektit juridik të çon në arsyetime të gabuara sepse lloji i objektit juridik të mbrojtur nga ligji nuk përcaktohet në mënyrë të shprehur nga norma por evidentohet nga interpretimi i tij. Nuk është e vërtetë që objekti i veprës penale të qëndrueshme duhet të jetë vetëm jo material, pasi vepra penale e qëndrueshme ekziston edhe kur kemi të bëjmë me objekte materiale si në rastin e pushtimit të tokës, armëmbajtjes pa leje etj. Në veprat penale të qëndrueshme objekti juridik mund të jetë çdo lloj, mjafton që të mos jetë i shkatërrueshëm dhe në bazë të kësaj cilësie përcaktohet edhe limiti nëse ekziston apo jo vepra penale e qëndrueshme.

¹⁰ Kodi Penal I Republikës së Maqedonisë 2006.

¹¹ *Ibidem*, fq. 104.

¹² *Ibidem*

¹³ Rampioni, *Contributo alla teoria del reato permanente*, Padova, 1988, fq. 28

penale materiale konsumimi ndodh kur vjen pasoja dhe kjo mund të ndodhë edhe për një vepër penale të qëndrueshme, mjafton që të ekzistojë vullneti i autorit të veprës penale.

Si në vepra penale të qëndrueshme formale apo materiale, ajo që zgjat në kohë nuk është lidhja shkakësore, e cila përfundon në një çast të caktuar, por është fakti i kundërligjshëm nga i cili buron kjo lidhje shkakësore dhe i cili mund të vazhdojë në mënyrë të pandërprerë¹⁴. Ky përfundim është i lidhur dhe me faktin se vepra penale, pas shfaqjes së saj, është për tu parë në unitetin apo tërësinë saj, dhe jo në elementet përbërës (veprim dhe pasojë), pasi këto të fundit janë të lidhur në mënyrë organike në veprën penale.

1.1 Kundërligjshmëria e veprimit të qëndrueshëm

Shkenca e së drejtës penale shqiptare quan vepër penale çdo veprim ose mosveprim shoqërisht të rrezikshëm, të kryer me faj dhe të parashikuar me ligj. Në këtë përkufizim dallohen tre elementë të domosdoshëm të veprës penale që janë: rrezikshmëria shoqërore, kundërligjshmëria dhe fajësia e autorit të saj¹⁵. Kundërligjshmëria si element i domosdoshëm i veprës penale, përfaqëson tiparin juridik të saj dhe është shprehje e zbatimit të parimit të ligjshmërisë në të drejtën penale, e parimit të mosdënimit pa ligj. Bazën e kundërligjshmërisë të veprës penale e formon kurdoherë dispozita penale përkatëse edhe në rastet e dispozitivit të bardhë ose blanket, i cili i referohet një ligji tjetër për të sqaruar përmbajtjen e saj. Analizojmë, në lidhje me veprën penale të qëndrueshme, edhe kohëzgjatjen e kundërligjshmërisë¹⁶. Meqenëse vepra penale është një veprim/mosveprim që shfaqet në botën e jashtme në një kohë të caktuar, ku ka një fillim dhe një fund të saj, kundërligjshmëria ashtu si dhe fajësia, shpreh një marrëdhënie mes veprës penale dhe ligjit penal¹⁷. Duke qenë se vepra penale matet në shtrirjen kohore dhe kundërligjshmëria dhe fajësia shprehin një marrëdhënie apo raport me të, edhe kohëzgjatja e tyre varet detyrimisht nga vepra penale. Nga kjo rrjedh edhe ekzistenca e të qenit në të njëjtën kohë të këtyre tre elementëve, (duke përfshirë këtu edhe rrezikshmërinë shoqërore).

Kështu vepra penale e qëndrueshme zgjat në kohë përderisa zgjat edhe veprimi/mosveprimi dhe pasoja, që për gjithë kësaj kohe është i kundërligjshëm, i fajshëm dhe shoqërisht i rrezikshëm. Në rastet e nenit 19 dhe 20 të Kodit Penal mbi rastet përjashtimore të përgjegjësisë penale, gjendja e kundërligjshmërisë ka filluar dhe vazhdon, dhe paraqet tiparet e një sulmi të çastit edhe pse zgjat në kohë dhe rastet përjashtimore të përgjegjësisë penale përjashtojnë veprën penale të qëndrueshme vetëm për kohën që ato ekzistojnë.

1.2 Ana subjektive e veprës penale të qëndrueshme

Vepra penale e qëndrueshme, si çdo vepër penale, përbëhet nga kundërligjshmëria, rrezikshmëria shoqërore dhe fajësia. Në veçanti, duke iu referuar fajësisë, veprimi i kundërligjshëm, i qëndrueshëm ka si tipar kryesor prezencën e momentit volitiv, dëshirën për zgjatjen e veprimit në kohë. Kriter ky që, i jep veprës penale të qëndrueshme ekzistencën e momentit volitiv gjatë gjithë kohës së shtrirjes së këtij veprimi dhe ekzistencën e momentit intelektual, pasi kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje direkte. Pra, gjatë gjithë kohës që kryhet vepra penale duhet të shoqërohet me qëndrimin psikik të personit në lidhje me veprimin dhe pasojën e ardhur¹⁸.

¹⁴ Pecoraro-Albano, *Ibidem*, fq. 448.

¹⁵ Muçi, *Ibidem*, fq. 104

¹⁶ Në rastin konkret i referohemi p.sh. sulmit të çastit dhe të padrejtë, tek nenit 19, “Mbrotjtja e nevojshme”, apo rrezikut aktual tek nevoja ekstreme neni 20 i Kodit Penal.

¹⁷ Kambovski Vllado, *E drejta penale, Pjesa e pergjithshme*, Furkan, 2010.

¹⁸ De Francesco, *Struttura del reato permanente*, fq. 583.

Sipas doktrinë mbizotëruese, në veprat penale të qëndrueshme është i nevojshëm, zgjatja e cënimit të objektit juridik si pasojë e një veprimi që zgjat në kohë nga autori i veprës penale. Kështu, konsumimi pushon edhe atëherë kur sekuestruesi, i cili ka rënë në koma humbet kontrollin mbi situatën e krijuar, atë të privimit të lirisë së personit.

Në veprën penale të qëndrueshme (p.sh pjesëmarrja në organizata kriminale apo forma të tjera bashkëpunimi) ka rëndësi juridike dhe dënohet nga ligji veprimi që zgjat gjatë gjithë kohës së konsumimit të veprës penale, sepse ajo, përderisa nuk ndërpritet apo pushohet me vullnet të personit, përcakton një cënim të vazhdueshëm të normës juridike që zgjat në kohë dhe formon elementët e veprës penale në çdo moment të saj. Por kjo do të thotë, që ekziston elementi psikologjik në formën e dashjes direkte, pavarësisht nga prezenca aktuale dhe fizike e autorit të veprës penale, edhe pse ai në intervale të caktuara nuk ndodhet me subjektin pasiv të veprës penale. P.sh ne rastet e heqjes se paligjshme të lirisë, është e pamundur të konceptohet që autori i i veprës penale të mos largohet asnjëherë nga vendi se ku ka fshehur personin. Kështu, gjatë gjithë kësaj kohe të sekuestrimit është e pakonceptueshme që sekuestruesit, t'i drejtojnë vëmendjen e tyre në vazhdimësi dhe pandërprere vetëm tek vepra penale që ata po kryejnë.

Por për të mos dalë nga parimet e përgjithshme të së drejtës penale, ku faji duhet të ekzistojë në momentin e kryerjes së veprës penale, në doktrinë për këtë vepër penale duhet të kihet parasysh faza e qëndrueshmërisë dhe momenti i realizimit të elementëve përbërës së saj.

Në rastet kur, fillon me dashje dhe përfundon me pakujdesi nuk mund të konfigurohet duke marrë në konsideratë unitetin e strukturës së veprës penale të qëndrueshme, pasi në këto raste kemi të bëjmë me dy fakte të ndryshme një të kryer me dashje dhe tjetrën nga pakujdesia¹⁹. Kështu, nëse gjatë kohës së kryerjes së veprës penale ndryshimi i formës së fajësisë, nga dashja e personit në pakujdesi, në momentin e ndërhyrjes së formës së dytë të fajësisë, merr fund vepra penale e qëndrueshme me dashje dhe i hapet rruga veprës penale të kryer me pakujdesi, në qoftë se parashikohet nga ligji në këtë formë.

1.3 Dallimi midis veprës penale që kryhet aty për aty, të qëndrueshme dhe vazhduese

Thelbi i veprës penale të qëndrueshme është i ndryshëm dhe i kundërt me vepra penale që kryhen aty për aty. Vepra penale që kryhen aty për aty kryhen dhe përfundojnë në një moment të caktuar në pamundësi për t'u zgatur në kohë, ndërsa vepra penale e qëndrueshme (siç u trajtua dhe mësipër), pasi janë kryer nuk përfundojnë por tentojnë të vazhdojnë në kohë në mënyrë të pandërprerë. Pushimi i qëndrueshmërisë përbën edhe konsumimin e tyre²⁰.

Shembull i një vepër penale që kryhet aty për aty është vrasja, ku cënimi i objektit juridik që është jeta, bëhet në një çast të caktuar.

Në qoftë se këto dy vepra penale janë të kundërta, kjo do të mund të shpjegohet në planet e ndryshme në lidhje me konsumimin e veprës penale dhe në qoftë se pranojmë që konsumimi konsiston në plotësimin e të tërë elementeve përbërës të veprës penale, atëherë mund të themi që koha (kalimi i saj jo vetëm si çast), përben elementët, që përshkruan apo jep tiparet e veprës penale të qëndrueshme; elementi i kohëzgjatjes përben edhe tiparin kryesor për këtë lloj vepër penale por jo element kryesor.

Dallimi midis veprave penale që kryhen aty për aty dhe veprave penale të qëndrueshme shërben për një sërë arsyes, duke e lidhur me aplikimin e një sërë institutesh në të drejtën penale si parashkrimi, amnistia, shuarja e ndjekjes penale apo ekzekutimit të saj etj. Vepra penale e qëndrueshme dallon nga ato që kryhen aty për aty. Në vepra penale që kryhen aty për aty me mosveprim nuk mjafton, që të jetë caktuar një afat për

¹⁹ I njëjti konkluzion arrihet edhe në rastet kur një veprim kryhet fillimisht me pakujdesi dhe me tej përfundon me dashje, si në rastin e atij që mbyll në një dhomë me çels, duke e kujtuar se është bosh, por në të vërtetë ka brenda një person. Analiza e ndryshimit të formës së fajësisë duhet të pasqyrohet në unitetin e strukturës së veprës penale të qëndrueshme.

²⁰ Rampioni, *Contributo alla teoria del reato permanente*, Padova, 1988, fq. 856.

përmbushjen e detyrës të parashikuar penalisht, por është i nevojshëm që duhet të kemi të bëjmë me një afat me kalimin e të cilit veprimi i parashikuar me ligj nuk mund të përmbushët më, duke qenë se mos respektimi i këtij detyrimi ka cënuar në mënyrë përfundimtare marrëdhënien juridike të mbrojtur me ligj. Në qoftë se afati është vendosur thjesht për të rregulluar përmbushjen e një detyre, por veprimi i parashikuar mund të kryhet edhe me tej, vepra penale me mosveprim ka natyrë të qëndrueshme dhe qëndrueshmëria pushon vetëm në momentin kur pushon kundërligjshmëria për vullnetin e vetë autorit të veprës penale, apo për verifikimin e rrethanave që bëjnë të pamundur zgjatjen e gjendjes së dëmshme apo të kundërligjshme.

Në doktrinë dallohet vepra penale e çastit me pasoja të qëndrueshme apo vepra penale të gjëndjes, ku në kohë zgjasin pasojat e dëmshme, të pariparueshme që kanë ardhur nga vepra penale dhe veprimi kryhet vetëm në një çast të caktuar. Në këto vepra gjendja e kundërligjshmërisë se krijuar nuk përket me atë të kohëzgjatjes. Ajo është e përfunduar si në kuptimin formal ashtu dhe në atë material me vetë shfaqjen e pasojës, pa marrë parasysh në është permanente apo jo. Vepër e gjendjes apo e çastit me efekte të qëndrueshme është p.sh dëmtime apo vepra penale dhune që mund të sjellin dëmtime të përhershme të personit si neni 87 i Kodit Penal, “Tortura me pasoja të rënda”. Për këto vepra penale koha e kryerjes së veprës penale ka më tepër pasoja penalo- juridike. Kështu, p.sh. privimi i kundërligjshëm nga liria është i kryer në vetë momentin e mbylljes së viktimës; kohëzgjatja e mëtejshme e privimit nuk ka të bëjë më ekzistencën e saj por do të merret si element në caktimin e një dënimi me të rëndë apo më të butë.

1.4 Llojet e figurave të veprave penale të qëndrueshme sipas Kodit Penal

Në kodin penal ka një sërë dispozitash që parashikojnë figura të veprave penale, të cilat kanë karakter të qëndrueshëm në kohë por ne do të ndalemi vetëm në disa prej tyre. Një nga këto është edhe neni 199/a i cili parashikon “Ndërtimin e paligjshëm”. Vepër penale kjo në të cilën pasoja vjen me ngadalë dhe në mënyrë progresive, e cila kryhet me përfundimin e ndërtimit. Kështu që, edhe kur ndërtimi kryhet nga persona të tjerë, nga ata që janë iniciues të ndërtimit, qëndrueshmëria pushon vetëm atëherë kur përfundojnë punimet. Por jo vetëm kaq, por edhe kur merret një vendim nga gjykata e shkallës së parë apo një vendim sekuestroje që i heq të drejtën autorit të veprës penale të disponojë mbi të. Ndërtimi mund të konsiderohet i përfunduar kur janë kryer të gjitha punimet mbi të të brendshme dhe të jashtme, pasi në veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, qëndrueshmëria pushon me realizimin përfundimtar të objektit në çdo pjesë të tij. Në qoftë se ndaj një ndërtimi pa leje të përfunduar në çdo pjesë të tij, shtohet një tjetër në distancë kohore, nuk kemi të bëjmë me një vepër penale të vetme dhe qëndrueshmëria nuk pushon me ndërtimin e dytë, pasi këtu ekzistojnë dy vepra penale më vete²¹.

Në veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet, neni 180 parashikon “Fshehja e të ardhurave” e cila nga ana objektive kryhet me fshehje apo tregimin e rremë të të ardhurave apo objekteve që i nënshtrohen tatimeve dhe taksave, ka natyrë të qëndrueshme pasi konsumimi i saj zgjat për gjatë gjithë kohës, për të cilën dokumentet ruhen detyrimisht nga zyra e kontabilitetit ose në çdo rast deri në momentin që provohet²². Nga ana objektive kjo vepër penale kryhet në dy mënyra: a) me fshehjen e të ardhurave ose të objekteve që u nënshtrohen tatimeve, për të mos i paguar ato; b) tregimit të rremë të të ardhurave ose objekteve që i nënshtrohen tatimeve ose taksave.

Në veprat penale të mashtrimit dhe konkretisht në mashtrimet me kredi neni 146 i Kodit Penal, kundërligjshmëria zgjat në kohë për shkak të mosveprimit të personit dhe

²¹ Kambovski Vllado, *E drejta penale, Pjesa e pergjithshme*, Furkan, 2010.

²² Ibid.

qëndrueshmëria pushon në momentin kur autori i veprës penale është në pamundësi për të kryer më veprime të kundërligjshme.

Në vepra penale kundër mjedisit p.sh neni 201 i Kodit Penal, “Ndotja e ajrit”, qëndrueshmëria nuk pushon deri në momentin për të cilën personi nuk heq dorë nga veprimet tij të kundërligjshme apo ndërhyrjen e autoriteteve kompetente. Nga ana objektive vepra penale kryhet me anë të veprimeve ose të mos veprimeve të kundërligjshme, që qëndrojnë në ndotjen e ajrit. Në veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, neni 278 Kodit Penal, nga ana objektive kjo vepër penale kryhet në disa mënyra të cilat kanë si tiparin e tyre kryesor kanë qëndrueshmërinë e veprimit, si p.sh prodhimi i armëve, mbajtja e tyre etj. Veprat penale kundër lirise se personit”, neni 109 ka për objekt, jo thjesht mbrojtjen e lirise personale por edhe paprekshmerine dhe mbrojtjen e pasurise. Veprimet dhe motivet e autoreve te vepres penale e kthejne viktimen ne një instrument, “send” te cenuar si qenie njerezore dhe ne interesat e tij pasurore e jopasurore. Ekziston një lidhje e ngushte midis qellimit te vepres, perfitimit dhe lirimit te personit per kete shkak. Ai shkembet, pra lihet i lire, vetem perkundrejt realizimit te perfitimit te pasurise, perfitimeve dhe qellimeve te tjera te parashikuar ne dispozite. Në veprën penale të rrëmbimit ose mbajtjen peng të personit, qëndrueshmëria pushon kur autori i veprës penale liron personin dhe pushon veprimin e tij të mbajtjes së tij ndërsa vepra penale quhet e kryer që nga çasti kur personit i është hequr liria e lëvizjes së lirë. Koha e mbajtjes së personit ndikon në masën e dënimit por jo në kryerjen e tij²³.

Conclusion

In the definition of the offense itself stable, the notion of the action of the offender, as an element of the objective side, occupies a leading role. This element of the objective side of the offense is the only one consistent character as: the offense is stable when standing at the time the action that constitutes it. In this sense every action has its time, short or long after the action there to Vinarc did his time, that instant. When the time exceeds this moment, we do duration, extent and continuity as to time, and as a result the remaining time sustainable action. In this sense, it is necessary to analyze compatibility between category of durable offenses and offenses committed by omission proper. If these two offenses are contrary, it could be explained in different plans in connection with the consumption of the offense and, if you accept that consumption consists of the completion of all elements of the criminal offense, it may say that time (its not only the passage of a sudden), constitutes the elements that describe or give offense features durable; The duration element constitutes the main feature for this type of offense but not the main element. The difference between criminal offenses committed on the spot and sustainable offenses serves a variety of reasons related to the use of a variety of institutes in criminal law prescription, amnesty, remission of prosecution or execution of her etc. Sustainability, as an element of duration of action would constitute by itself, an important element for configuring the same consumption.

References

²³Ismet Elezi, *E drejta penale, Pjesa e posacme*, 2009, fq. 128.

Elezi.I., *E drejta penale, Pjesa e posaçme*, Botime Erik, 2007.
Kambovski Vllado, *E drejta penale, Pjesa e pergjithshme*, Furkan, 2010.
Romano-Grasso, *Commentario sistematico del codice penale*, 2004.
Pecorano-Albani, *Del reato permanente*, në RIDPP, 1960.
Rampioni, *Contributo alla teoria del reato permanente*, Padova 1988.
Muci, Sh., *E drejta penale, Pjesa e përgjithshme*, Botime Ora 2006.
Pecorella C., *Legge intermedia: aspetti problematici e prospettive de lege ferenda*, në
Peverati, *Osservazioni sulla legittima difesa*, Torino, 1942.
De Francesco, *Profili strutturali e proçessuali del reato permanente*.
Dine, Gobert, *Cases and materials on Criminal Law*, 2003.

2.Përgjimi në legjislacionin penal Shqiptar

Dr. Adrian LEKA
Universiteti: “Luigj Gurakuqi”
“Fakulteti i Drejtësisë”
e-mail: leka-ad@live.com

ABSTRAKTI

Ky punim trajton në një vështrim të përgjithshëm të vështrimit historik në periudha të ndryshme dhe të rolit që luan përgjimi në legjislacione të ndryshme por posaçërisht fokusimi është në “Legjislacionin Penal Shqiptar”. Gjithashtu bëhet edhe një vështrim krahasues me disa nga legjislacionet e vendeve të tjera. Ky studim bazohet që në fillimet e veta e deri në ditët e sotme, si dhe evolimi që ka pasur ndër vite. Janë përmendur format e ndryshme të përgjimit, përmbajtja gjuhësore, kuptimi juridik, llojet e përgjimit, kushtet dhe vlefshmëria e tij, kompetencat, kushtet ku ai lejohet e ku nuk lejohet, vlefshmëria e tij.

Në mënyrë të veçantë përgjimi luan një rol për zgjidhjen e shumë çështjeve delikate brënda dhe jashtë Shqipërisë duke u munduar që të vijë sa më në ndihmë të drejtësisë dhe mbi të gjitha duhet të jetë në mënyrë sa më të ligjshme që vlerat dhe rezultatet e tij të jenë sa më të arritshme .

Përgjimi është një nga masat parandaluese të krimit duke u munduar që të çoj përballë drejtësisë të gjithë individët që kanë bërë shkelje si në fushën penale dhe në shumë fusha të ndryshme . Tema ka një aspekt të përgjithshëm sesi përgjimi ka një efikasitet dhe se sa ndihmon në zbardhjen e shumë çështjeve si dhe në parandalimin e tyre.

1. HYRJE

Përgjimi si formulim juridiko-penal, bashkëkohor, nuk ka qënë ndeshur (fiksuar) në procedurën penale krahas mjeteve të kerkimit të provës. Kjo edhe për shkak të teknikes e të infrastrukturës së veçantë që ky mjet i kerkimit të provës kërkon. Në këtë vështrim, i përfshirë si kapitull më vete, në Kodin e Procedures Penale, përgjimi, pasqyron sot edhe nivelin e njohjes dhe shkallën e zhvillimit, kohët e fundit të teknikës e të teknologjisë së komunikimeve. Dhe është për t’u vënë re se sa herë që kjo teknike ka ecur përpara, aq here janë bërë dhe përshtatje në kode të procedures penale.

2. PËRGJIMI SIPAS LEGJISLACIONIT AKTUAL SHQIPTAR

2.1 Përmbajtja gjuhësore.

Emri PËRGJIM vjen nga folja PËRGJOJ që do të thotë: “Rri i fshehur diku e dëgjoj a vëzhgoj dikë për të marrë vesh çfarë thotë, çfarë bën etj; ndjek fshehurazi veprimet e dikujt, vëzhgoj pa më pare njëri”²⁴.. Pra, brënda kuptimit të emrit përgjim përfshihet edhe emri VËZHGIM që vjen nga folja VËZHGOJ dhe që do të thotë: “E ndjek me sy dikë a dicka, e vështroj me vëmendje që ta njoh mirë; përgjoj veprimet e dikujt, gjurmoj lëvizjet e tij, e ruaj nga vete a çfarë bën”²⁵.

2.2 Kuptimi juridik – roli dhe rëndësia.

Si përmbajtje juridike, përgjimi është një mjet i posaçëm hetimi i fshehtë, - mjet i kërkimit të provës, - me një teknikë që përdoret gjatë veprimtarisë hetimore nga organet e ndjekjes penale, sidomos në fushat e krimit të organizuar, të krimit ekonomik etj, pra në rrafshin e krimeve të rënda në përgjithësi. Përgjimi nuk bëhet vetëm me një teknikë, por kryhet nëpërmjet disa teknikash. Përgjimi përdoret gjatë fazës hetimore. Hetimet kalojnë në dy faza. Faza e parë është faza e fshehtë, - ku bën pjesë dhe përgjimi - dmth që personi nën hetim nuk ka dijeni që po hetohet. Ky hetim bëhet publik pasi organet hetimore shterrojnë te gjitha veprimet e nevojshme për hetimin. Kjo është dhe faza e dytë e hetimit, ku personit nën hetim i bëhen të njohura të gjitha teknikat që përdoren në fshehtësi. Pra, përgjimi është një mjet delikat, përdorimi i tij duhet të bëhet me shumë kujdes. Në vështirim të telekomunikimeve, me fjalën “Përgjim” kuptohet ndërhyrja e fshehtë për të kapur, dëgjuar e rregjistruar përmbajtjen e komunikimit dhe të dhëna që lidhen me të ndërmjet pikës së nisjes e pikës së mbërritjes²⁶. “Objekt përgjimi” janë sinjalet, shkrimet, fotografitë, të dhënat audiovizuale ose lloj tjetër informacioni, për të marrë ose transmetuar nëpërmjet pajisjeve të telekomunikacionit ²⁷. Sukseset e arritura në zbulimin e krimit, sidomos të krimeve të rënda dhe krimit të organizuar, siç janë p.sh trafikimi i lëndëve narkotike, armëve apo qënieve njerëzore, vrasjet me pagesë, shfaqjet korruptive, shpërdorimet ekonomike etj, që organizohen e kryhen me mënyra tepër të stërholluara sa në shumë raste nuk lënë as gjurmë prove sepse realizohen nëpërmjet mjetesh teknike nga më modernet e të sofistikuar, flasin për rolin dhe rëndësinë e përgjimit si mjet për kërkimin e provës për hetimin dhe vërtetimin e veprimtarive kriminale, që përgjithësisht mjetet e tjera të kërkimit të provës janë të papërshtatshme, të pamjaftueshme dhe jo efektive. Sidomos përgjimet telefonike dhe ambjentale që përbëjnë metoda hetimore të reja duke përdorur edhe mjete teknike moderne e

²⁴ Fjalor i gjuhës së sotme Shqipe, faqe 1437, Tirane, 1980

²⁵ idem, faqe 2161

²⁶ Ligji, nr.9157, dt.4.12.2003 “Per pergjimin e telekomunikimeve” neni 3

²⁷ idem

duke ndryshuar edhe vete pamjen dhe mënyrat e hetimit kriminal për grumbullimin e dhënave që me mënyrat e zakonshme të hetimit do të mbeteshin pa u zbuluar, i japin përgjimit vlerën e përparësisë dhe të domosdoshmërisë në rendin e mjeteve të kërkimit të provës.

2.3 Grupet – llojet e përgjimit.

Sipas Neneve 221 dhe 294/a/b të K.Proc.Penale del se ekzistojnë disa grupe e lloje përgjimi. Kështu mund të renditen:

- Përgjimi i fshehtë ambjental (ne vende publike dhe private).
- Përgjimi i bisedave dhe komunikimeve midis të pranishmëve (asnjëri prej personave nuk ka dijeni se po përgjohet ose ka dijeni vetëm njëri prej tyre).
- Përgjimi me telefon, faks, kompjuter, ose me mjete të tjera të telekomunikimeve.
- Përgjimi i fshehtë me audio (zanor) dhe video (pamor).
- Përgjimi i fshehtë fotografik.
- Përgjimi i fshehtë filmik ose me video.
- Rregjistrimi i numrave të telefonit, hyrëse dhe dalëse.
- Përdorimi i paisjeve gjurmuese të vëndndodhjes.
- Përgjimi jotipik (klandestin, me simulim, me infiltrim).

2.4 Kushtet kur lejohet përgjimi.

Përgjimi lejohet nga autoritetet e ngarkuara me ligj, vetëm kur ekzistojnë dy kushte:

1. Në kushtin e parë përfshihen dy grupe:

Grupi I. Mund të përgjohet personi për të cilin ka procedim penal, parashikuar në nenin 221/1 i K.Proc.Penale²⁸:

- krime të kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet.
- për kundravajtje penale të fyerjes e të kanosjes, të kryera me mjete të telekomunikimit.
- për të lehtësuar kërkimin e personave të ikur, që nuk gjenden (neni 247/5 i K.Proc.Penale).

Grupi II. Mund të përgjohet personi për të cilin ka procedim penal, parashikuar në nenin 221/2 K.Proc.Penale²⁹:

²⁸ Përgjimi i komunikimeve të një personi ose të një numri telefoni me telefon, faks, kompjuter ose me mjete të tjera të cdo lloji, përgjimi i fshehtë me mjete teknike i bisedave në vende private, përgjimi me audio dhe video, në vende private dhe regjistrimi i numrave të telefonit hyrës dhe dalës.

²⁹ Përgjimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video i personave në vende publike dhe përdorimi i paisjeve gjurmuese të vendndodhjes.

- krime të kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim, në maksimum, me dy vjet

2. Kushti i dytë:

- përgjimi është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara;
- ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar akuzën³⁰.

Vetëm prania e njëkohshme e këtyre dy kushteve e bën të ligjshëm lëshimin e autorizimit për përgjim, që **urdhërohet kundër:**

- a) të dyshuarit për kryerjen e një vepre penale;
- b) personit që dyshohet se merr ose transmeton komunikime nga i dyshuari;
- c) personit që merr pjesë në transaksione me të dyshuarin;
- d) personit, vëzhgimi i të cilit mund të çojë në zbulimin e vëndndodhjes ose të identitetit të të dyshuarit .

2.5 Vlefshmëria e përgjimit.

Rezultatet e përfituara gjatë veprimtarisë përgjuese janë të vlefshme për të gjithë komunikuesit. (neni 221/4 I K.Proc.Penale). Kjo do të thotë që rezultatet e përgjimit kanë vlerë për përdorim në funksion të vërtetimit të akuzës, jo vetëm për personin ndaj të cilit është urdhëruar përgjimi, por edhe ndaj personave me të cilët ai komunikon.

2.6 Karakteri parandalues.

Përgjimi parandalues rregullohet me ligj të veçantë³¹. Rezultatet e tij nuk mund të përdoren si prove (neni 221/5 I K.Proc.Penale). Me anë të përgjimit parandalues synohet të rritet efektiviteti i punës së institucioneve informative shtetërore, për zbulimin e veprimtarisë antikushtetuese kriminale dhe keqbërëse, si për zbulimin e veprimtarisë antikushtetuese kriminale dhe keqbërëse, si dhe të parandalojë pasojat që mund të vijnë nga kjo veprimtari³². Në radhën e përgjimeve parandaluese mund të futet edhe veprimtaria e “Shërbimit Informativ Shtetëror”, ajo e shërbimit informativ/policor i Ministrisë së Brëndshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe veprimtaria e çdo shërbimi tjetër informativ/policor, i krijuar me ligj³³ që kanë të drejtë të kërkojnë përgjimin, për të siguruar të dhëna të domosdoshme për

³⁰ Gjatë trajtimit të temës dhe në konkluzionet shtjellohet me gjerësisht kuptimi dhe përmbajtja e kesaj kërkesë.

³¹ Ligji “Për përgjimin e telekomunikimeve” nr. 9157, datë 04.12.2003

³² neni 2 I Ligjit “Për përgjimin e telekomunikimeve” nr. 9157, dt. 04.12.2003

³³ Shërbimi Informativ Shtetëror, është krijuar me Ligjin nr.8391, dt. 28.10.1998. Qëllimi i veprimtarisë së këtij organi (SHISH) është të sigurojë informacionin e domosdoshëm - nga zbulimi dhe kunderzbulimi - për problemet që lidhen me sigurimin kombëtar.

realizimin e detyrave të tyre ligjore³⁴. Në lidhje me përgjimin parandalues ka rëndësi të mbahet parasysh, se rezultatet që përfitohen nga ky lloj përgjimi nuk mund të shërbejnë si burim prove në qofte se nuk janë marrë në respektim të dispozitave që parashikohen në seksionin IV të përgjimeve në K.Proc.Penale (nenet 221-226).

2.7 Kërkesa për përgjim.

Kërkesa për përgjim duhet të hartohet në 2-kopje, një kopje mbahet në fashikullin e Prokurorit dhe tjetra i dërgohet Gjykatës. Kërkesa duhet të përmbajë:

- a) emrin e prokurorit dhe prokurorinë përkatëse;
- b) gjeneralitetet dhe adresen e subjektit në proces përgjimi si dhe adresen e mjedisit/mjediseve me të cilat lidhet kërkesa për përgjim;
- c) përshkrimin e llojit dhe të natyrës së përgjimit;
- ç) arsyet e përgjimit, si dhe bazën dokumentare, ose materialin dyshues, ku mbështetet kërkesa për përgjim;
- d) argumentet që vërtetojnë se përgjimi është i domosdoshëm në situatën e krijuar dhe se të dhënat që kërkohen nuk mund të sigurohen me mjete të tjera;
- dh) afatin kohor brenda të cilit do të bëhet përgjimi.

3. VENDIMI PËR LEJEN E PËRGJIMIT.

3.1 Përgjimet parandaluese.

Informacionet që merren gjatë përgjimeve parandaluese si ‘*notitiae criminis*’³⁵ mbi të cilat bazohet një kërkesë e prokurorit drejtuar gjyqtarit, për nxjerrjen e vendimit autorizues të përgjimit, në funksion provues, quhen ligjërisht të përdorshme. Meqënëse me dispozitat në fuqi ndalohet përdorimi i këtyre informacioneve si provë për vërtetimin e krimit (neni 221/5 I K.Pr.P), kur për të nuk janë respektuar rregullat e parashikuara në seksionin IV të K.Pr.P – Përgjimet, – por nga neni 36 i Kushtetutes, për fshehtësinë e komunikimeve, i cili së pari as shprehet dhe as nënkupton ndalimin e përdorimit të përgjimit parandalues. Së dyti prokurori e ka parasyshë nenin e cituar kur formulon kërkesën për gjyqtarin dhe e garanton zbatimin e tij me veprimet që bën: me të marre informacionin, bën kërkesën dhe analizon elementet e nevojshme, që çojnë te vepra penale e sinjalizuar, duke kërkuar burime të tjera e të ndryshme provash, që nuk çenojnë lirine dhe fshehtësinë e komunikimeve. Ndërkaq, me kërkesën me të cilën i drejtohet gjyqtarit, prokurori i përgjigjet kërkesës kushtetuese, se kufizimi i lirisë së komunikimeve mund të bëhet vetëm në rastet dhe në mënyrat e parashikuara me ligj.

³⁴ Idem, neni 6 I ligjit

³⁵ Latinisht, njoftime të krimit

3.2 Motivacioni për vendimin autorizues.

Mungesa e motivacionit në vendimet që autorizojnë ose zgjasin përgjimet, si dhe mosmiratimi i vendimit të nxjerrë nga prokurori në raste urgjence, sjell si pasojë mospërdorimin e rezultateve të përfituara nga veprimet përgjuese. Kjo gjë ndodh kur mungon ose është me mangësi të theksuara motivacioni në kërkesen e prokurorit për vendimin autorizues, jo vetëm si tekst fizik, por edhe kur ai (motivacioni) është dukshëm, thjesht përsëritje e përmbajtjes së dispozitës, ose i gjithi i ngjashëm me motivacionin e vendimit të prokurorit në rastet e urgjencës. Por, kur motivacioni ka mangësi sipërfaqësore, (mund të mos jetë i plotë, por ka gabime që nuk e mohojnë arsyetimin e saktë), rezultatet e përfitura nga veprimet marrëse janë të përdorshme, gjyqtari i miraton dhe lëshon vendimin autorizues të përgjimit. Motivacioni i vendimit autorizues fare mire mund të mbështetet te përmbajtja e kërkesës së prokurorit për përgjimin, por të mos jetë një paraqitje adequate e elementeve që përmban kërkesa e prokurorit. Ky motivacion pranohet si i plotë, në mënyre shterruese, edhe vetëm me paraqitjen përmbledhëse të elementeve të analizuar nga prokurori.

Për këtë arsye, një mangësi apo gabim i këtij motivacioni që mund të rregullohet nga bashkëpunimi, sipas rregullave të përgjithshme, i gjyqtarit me prokurorin, nuk bëhet shkak për pavlefshmëri dhe as për mospërdorim. Mospërdorimi i rezultateve të përgjimeve për mungese motivimi të vendimit autorizues, gjen zbatim vetëm në rastet e mungesës së vendimit autorizues, i cili barazohet me mungesën totale të motivacionit të shkruar, dhe jo kur motivacioni ka vetëm mangësi logjike. Motivacioni i vendimit autorizues duhet të jetë analitik e specifik, veçanërisht ai duhet të japë arsye të barazvlefshme të pranisë së dyshimit të arsyeshëm, mbështetur në prova dhe të domosdoshmërisë absolute të përgjimeve në funksion të vazhdimit të hetimeve. Kushti i pare i takon rëndësise së çështjes penale, - objekt i procedimit - dhe nevojitet që me paraqitjen e një sere supozimesh konkrete të justifikohet kufizimi i fshehtësise së komunikimeve. Kushti i dytë i përket përdorimit efektiv të rezultateve, për të cilat autorizohet përgjimi, si mjet thelbësor për vazhdimin e hetimeve në kërkim të provës dhe për mbledhjen e elementeve provues të krimit.

3.3 Kohëzgjatja e përgjimeve.

Kufiri i kohëzgjatjes që parashikohet në nenin 222/3 të K.Proc.Penale, për veprimet e përgjimeve duhet të përcaktohet jo vetëm për veprimet direkte që bëhen nga prokurori, por edhe për ato veprime që autorizohen sipas rregullit nga gjyqtari. Për rrjedhim, mosrespektimi i afateve konsiderohet shkelje dhe përgjimi, - përveç kur zgjatet afati me një vendim të ri autorizues – ndalohet. Rezultatet e përfituara prej tij duhen quajtur të papërdorshme (nenet

226 e 222 të K.Proc.Penale). Të tilla shkelje zbulohen edhe kryesisht në çdo fazë e shkallë të procedimit.

Përcaktimi i kohëzgjatjes së veprimeve për përgjim, brënda kufijve që parashikohen nga ligji, i besohet ekskluzivisht prokurorit. Sipas nenit 222/3 të K.Proc.Penale, kërkesa e prokurorit për autorizim të përgjimit, tregon si mënyren, ashtu edhe kohëzgjatjen e veprimeve. Gjyqtari, që vlerëson kërkesën e prokurorit, nuk i takon të përcaktojë në vendimin autorizues kohëzgjatjen – qoftë kjo edhe brënda kufijve të përcaktuar me ligj – (përfshihen rastet e zgjatjes së përgjimit që përcaktimin e afatit të kohëzgjatjes, legjislatori ia ka kaluar gjyqtarit autorizues, si domosdoshmëri për të zvogëluar sa më shumë afatet e ligjshme të kufizimit të së drejtës së fshehtësisë së komunikimeve), aq më pak ka të drejtë gjyqtari të posedojë mbi afatet e përcaktuara nga prokurori për rastet e urgjencës. Kështu p.sh, nëse për një përgjim, (në rast urgjence) prokurori përcakton për përgjimin afatin prej 15-ditësh, këtë afat, gjyqtari autorizues nuk mund ta reduktojë në 5 ose 10 ditë.

Fillimi i afatit.

Me fillim të afatit të përgjimit duhet kuptuar fillimi efektiv i përgjimit dhe jo dita e marrjes së vendimit autorizues. Gjyqtari autorizon atë afat që përcakton prokurori në kërkesën e vet, brënda kufijve që parashikohen në ligj. Kjo do të thotë që, nëse në vendimin autorizues përcaktohet afati prej 15-ditësh, por veprimet përgjuese fillojnë p.sh 5-ditë pas lëshimit të vendimit autorizues dhe përfundojnë, të themi, brënda 14-ditëve (pra, brënda afatit prej 15-ditësh) nuk kemi të bëjmë me shkelje dhe për rrjedhim, përgjimi është i ligjshëm dhe rezultatet e përfituara prej tij janë të përdorshme si element provues. Kështu mund të themi se në asnjë dispozite nuk përcaktohet që përgjimi duhet të fillojë në datën fiksuar nga prokurori në kërkesën e vet, ose gjyqtari në vendimin autorizues. Ligji përcakton kufijte brënda të cilëve duhet të kryhet përgjimi, me qëllim që të respektohet kërkesa e nenit 36 të Kushtetutes dhe kufizimi i së drejtës së lirisë dhe fshehtësisë së komunikimeve të jetë sa më i ngushtë. Sic u tha, gjyqtarit autorizues të përgjimit nuk i takon të fiksojë kohëzgjatjen e përgjimit të bisedave, ose të komunikimeve, sipas bindjes së vet. Megjithatë edhe kur ky “gabim” ndodh, nuk përben kusht as për pavlefshmëri të përgjimit, as për mospërdorim të rezultateve të përfituara prej tij (neni 226 i K.Proc.Penale). Pra, afatet për përgjimin përcaktohen nga prokurori dhe miratohen pa u ndryshuar nga gjyqtari autorizues (përveç kur është afat për zgjatje afati), por gjithnjë brënda afateve skajore që përcaktohen në ligj.

4. RUAJTJA E DOKUMENTACIONIT.

4.1 Vendi i ruajtjes.

Procesverbalet dhe regjistrimet për veprimet që kryhen gjatë përgjimit ruhen pranë prokurorisë që zbaton vendimin autorizues të përgjimit. Ruajtja vazhdon deri sa vendimi të marrë formë të prerë, por nuk ruhen të gjitha aktet dhe dokumentet, përdorimi i të cilave ndalohet. Gjithashtu nuk mbahen në ruajtje dokumentacioni që konsiderohet i panevojshëm dhe që i interesuari kërkon asgjesimin e tij. Por për këtë kërkesë vendos gjykata që vlerëson përgjimin. Në çdo rast, duhet pasur parasysh që nuk mund të vendoset për mos ruajtje të akteve dhe dokumenteve, procesverbaleve, regjistrimeve apo transkriptimeve të cilat mund të përbëjnë provë materiale. (neni 226/3 i K.Proc.Penale).

4.2 Asgjesimi.

Për sa i përket asgjesimit të dokumenteve (procesverbaleve, regjistrimeve, etj), që quhen të panevojshme në funksion të procedimit dhe që kërkohet nga i interesuari me arsyetimin se duhet ruajtur fshehtësia e komunikimeve, është e domosdoshme që para se të shqyrtohet kjo kërkesë, të shterohet procedura e parashikuar nga neni 223 i K.Proc.Penale. Ndërkaq e drejta që kanë personat nën hetim për t'u njohur me përmbajtjen e regjistrimeve, në mbyllje të hetimeve paraprake, nuk presupozon që në të njëjtën kohë të kryhet edhe asgjesimi i dokumenteve, me kërkesën e të interesuarit. Asgjesimi i dokumenteve të panevojshme vendoset në përfundim të shqyrtimit gjyqësor (223/4 i K.Proc.Penale), dhe të drejten për të vendosur dhe kryer asgjesimin e ka gjyqtari që vlerëson regjistrimet e kryera. Ky i fundit vendos asgjesimin e atyre dokumenteve që i quan të panevojshme apo që çenojnë të drejten e fshehtësisë së komunikimeve (neni 36 i Kushtetutes).

4.3 Imuniteti.

Sipas nenit 221/4 i K.Proc.Penale, “Rezultati i përgjimit është i vlefshëm për të gjithë komunikuesit”, por kjo dispozite nuk mund të zbatohet pa u mbështetur dhe pa qënë në pajtim me nenin 289/1 i K.Proc.Penale, sipas të cilit “... nuk lejohet ... dhe përgjimi i bisedimeve ose i komunikimit ndaj personit për të cilin kërkohet autorizimi”. Në këtë kuptim përfshihen deputet, ministra, e persona të tjerë që kanë imunitet. Kur procedohet për persona për të cilët nuk kërkohet autorizim, por gjatë kryerjes së veprimeve përgjuese implikohen edhe persona për të cilët kërkohet autorizim për procedim (neni 289/1 i K.Proc.Penale) dhe ky autorizim kërkohet, por nuk jepet, ose vonohet nga institucioni përkatës, rezultatet e

përgjimit nuk mund të përdoren, ndërsa për personat e tjerë, - për të cilët nuk kërkohet autorizim, - rezultatet e përgjimit mund të përdoren (neni 289/2). Por, kujdes: “Rezultatet e përgjimit të cilat nuk “lejohej” të përdoren, nuk ka pse asgjeshen, në rast se përbejnë provë materiale. (neni 226/3 i K.Proc.Penale).

KONKLUSIONE

Gjatë 10-vjeçarit të fundit, por sidomos në vitin 2004, seksioni “Përgjimet” ka njohur shumë ndryshime në kuadrin e përmirësimeve të bëra në të. Përmirësimet e ndryshimet vërehen në strukturë, në përmbajtje dhe në kompetenca, duke bërë zgjerim të përmbajtjes e të sferës së veprimtarisë së përgjimit, saktësime të vendeve dhe të menyrave të kryerjes së përgjimit dhe të kompetencës për autorizimin e përgjimit etj. Kam bindjen se ndryshime e saktësime të tilla, nuk mund të jenë shtrënguese dhe do të jetë e nevojshme të bëhen edhe në të ardhmen. Po paraqes, shkurtimisht dhe vetëm një pjesë, që i gjykova më të domosdoshme, prej atyre që edhe mund të kuptohen nga leximi tërësor i materialit.

1. Formulimi në nenin 222/1 “ ... kur ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës” nuk mund të jetë në një plan me vazhdimin e hetimeve; vazhdimi i hetimeve është në funksion të vërtetimit të akuzës. Formulimi i mësipërm prova të mjaftueshme “për vërtetimin e akuzës” duhet kuptuar si “mbështetje e kërkesës së prokurorit”, dhe jo akuzës. Prandaj, për të mos krijuar keqkuptime, mendoj se do të ishte më mirë që formulimi i mësipërm për të shprehur në menyrë më të qartë e të saktë, kuptimin e vërtetë të përmbajtjes dhe të qëllimit, do të mund të formulohej si më poshtë: “... Gjykata autorizon përgjimin me vendim të motivuar për rastet e lejuara me ligj, kur ai është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara dhe kur ka prova të mjaftueshme që *mbështesin kërkesën e prokurorit*”. Në fund të fundit është kërkesa e prokurorit dhe arsyetimi i motivuar i tij që përbëjnë dhe bazen e vendimit autorizues,.

2. Mendoj se mospërdorimi eventuale i përmbajtjes së rezultateve të përgjimit si element prove për vërtetimin e përgjegjësisë ose të dyshimit, në funksion të marrjes së masës së sigurisë, nuk duhet të ndalojë që të njëjtat rezultate që mund të vlerësohen si njoftim krimi, që nxit hetime të mëvonshme. Mospërdorimi i një veprimi ose i një akti nuk ka pse të përdoret si kusht për mospërdorim të të gjithë akteve të tjera, që ndodhen në marrëdhënie bashkëlidhese me të, sepse në këtë mënyrë do të paragjykohej vlera dhe efektiviteti i një veprimi të

dobishëm. Kështu p.sh, ndalimi i një përgjimi nuk ka pse sjell si pasojë mospërdorimin e të gjitha rezultateve e regjistrimeve të tij, pa përjashtim.

3. Për veprimet që kryhen nga institucione me funksione informative/policore në praktike bashkëpunohet, por mendoj që ky bashkëpunim të zgjerohet e të shtrihet përtej kufijve e qëllimit për parandalimin e krimit, për t'i shërbyer edhe mbledhjes së provave, për ta bërë procesin penal më efektiv dhe akuzen të mbështetur në fakte e prova të pakundërshtueshme, të cilat do ta bënin edhe më të lehtë, bindës e në afate kohore të përshtatshme procesin penal – sot për sot po vërejmë afate të tejzgjatura.

LITERATURA

- Kanuni i Leke Dukagjinit.
- Mbi legjislacionin Otoman.
- Statuti i Mbretërisë së Shqipërisë.
- Kodi i Procedures Penale i vitit 1953 dhe 1979.
- Kodi Penal i vitit 1979.
- Kodi i Procedures Penale i vitit 1995.
- Kodi Penal i vitit 1995.
- Kodi i Përkohshëm i Procedures Penale i Kosovës.
- Kodi i Procedures Penale të Francës.
- Kodi i Procedures Penale Italiane.
- Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë e vitit 1946, 1950 dhe 1976.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e vitit 1998.
- Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.
- Jurisprudenca e Gjykatës së Kasacionit në Itali.
- Revista “Të Drejtat e Njeriut”.
- Ligji nr. 9157, datë 4.12.2003, “Për përgjimin e telekomunikimeve”.
- Ligji nr. 8618, datë 14.6.2000, “Për telekomunikimet në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 8391, datë 28.10.1998, “Për Shërbimin Informativ Shtetëror”.
- Ligji nr.8749, datë 1.3.2001, “Për shërbimin e kontrollit të brëndshëm në Ministrinë e Rendit Publik”.
- Antoneta Bejko, - teme - “Mjetet e kërkimit të provës”, Qërshor 2002.
- Donna Gomien, “Udhëzues i shkurtër i Konventes Europiane Për të Drejtat e Njeriut”, botim I Këshillit të Europës, viti 2005.
- Ejup Sahiti, “Argumentimi në Procedurën Penale”, Prishtinë, botim i vitit 1999.
- Halim Islami “Demokratizimi i legjislacionit penal”.
- H. Islami, A.Hoxha, I. Panda, “Komentar i Kodit të Procedures Penale”, viti 2003.
- Kujtim Luli – kumtese – “Manual i Prokurorit dhe Policisë Gjyqësore”, Tiranë 2003.
- Pertef Hamzai – kumtese – “Kurs Kualifikimi për Prokurorë” – Tiranë 2006.
- Ledi Bianku, “Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut” , Tiranë 2005.
- Marek Antoni Nowicki, “Rreth Konventes Evropiane” – komentari.
- Ursula Kilkelly, “Ë drejta për respektimin e jetës private dhe familjare” –udhëzues – viti 2003.
- Xhemal Meçi, Kanuni i Leke Dukagjinit - varianti i Mirditës.

3. Trafikimi i qënieve njerëzore

Dr. Adrian LEKA

Universiteti "Luigj Gurakuqi" Fakulteti I Drejtësisë

Prof. Asc. Dr. Ilir Berhani

Universiteti "Luigj Gurakuqi" Fakulteti I

Drejtësisë

Abstrakt: Hapja e Shqipërisë me vendet e tjera gjatë periudhës së tranzicionit drejt demokracisë krahas anëve shumë pozitive solli edhe shfaqjen e shumë problemeve për shoqërinë. Niveli i ulët ekonomik i trashëguar nga sistemi i kaluar ekonomik-politik, mungesa e shpresave për një jetë më të mirë, kultura në drejtim të raporteve gjinore, kultura e ulët demokratike, paaftësia për të ndërtuar shpejt edhe mirë një shtet funksional, papunësia edhe fenomene të tjera të shoqëruara nga perceptime të gabuara mbi realitete jashtë vendit tone, bënë që të rriten tendencat imigratore në rrugë të ligjshme dhe të paligjshme, dhe po në këtë mënyrë të zhvillohet dhe trafikimi. Ndërsa bota e provoi zhvillimin e tij në fund të shekullit të kaluar, Shqipëria ndjeu realisht "shijen" e tij, një dekadë më pare. Shteti Shqiptar dhe në përgjithësi shoqëria shqiptare në bashkëpunim aktiv me partnerët ndërkombëtarë, ka nisur një luftë të ashpër dhe sistematike kundër këtij fenomeni të rëndë që u shfaq në fillim të viteve '90. Ndonëse nuk mendohej rreth tij, ai zuri vend pa "zhurmë" në këtë periudhë, situata e krijuar ishte tepër e favorshme, varfëria e tejskajshme po i shtynte shqiptarët të zhvisheshin nga parimet dhe ndjenjat humane. Dëshira për të fituar sa më shumë para, brenda një kohe sa më të shkurtër, pushtoi dhe errësoi mendjet e shumë njerëzve, të cilët nuk vonuan të ngrinin rrjetet e tyre dhe të krijonin lidhje me rrjetet ndërkombëtare të trafikantëve. Diskutimet dhe informacionet rreth këtij fenomeni, thuajse mungonin. Kur u kuptua që trafikimi kishte marrë përmasa të jashtëzakonshme, u deshën vite të tëra që të hiqej dore nga theksimi i pjesëmarrjes së Shqipërisë në të, vetëm si vend TRANZIT, "për shkak të pozitës së saj gjeografike të favorshme". Por, tashmë njerëzit dhe shteti janë tërësisht koshiente dhe pranojnë se vendi ynë, nuk mund të konsiderohet më vetëm si vend TRANZIT, por edhe si vend ORIGJIN dhe DESTINACIONI. Në këtë kontekst Trafikimi si një plagë e rëndë sociale, si një nga format më të egra të dhunimit të drejtave dhe lirive themelore të njeriut çoi në deformimin e vlerave shoqërore baze, stimuloi krimin e organizuar dhe korrupsionin, duke krijuar një imazh tejet negativ në arenën ndërkombëtare për vendin tone. Kur flasim për trafikim të qënieve njerëzore, duhet të kuptohet trafikimi i njerëzve në përgjithësi, e në veçanti i grave dhe femijëve, si kategoria më e përhapur dhe më e prekur nga ky fenomen kriminal, i cili për nga pasojat që sjell për viktimat e tij, përben një formë bashkohore të skllaverimit, ose e thënë ndryshe "Skllaveri i kohërave moderne". Shoqëria Shqiptare, vazhdon të mbart mentalitetin patriarkal dhe konservator të trashëguar nga e kaluara. Faktoret mikrosoacial, tipi dhe karakteristikat e familjes, mbeten gjithashtu faktore kryesore, të cilët përcaktojnë përfshirjen e grave, vajzave dhe femijëve në trafikun njerëzor duke u përjekur të hidhet drite, mbi evoluimin historik të trafikimit, kushtet që e favorizojnë atë, kategoritë e përfshira në të, elementet e sjelljes së legjislacionit (të brendshëm dhe ndërkombëtarë), dhe mekanizmat veprues të tij.

1. Vështrim historik në lidhje me fenomenin dhe trafikimin e qënieve njerëzore, si figurë e veprës penale.

Shoqëria njerëzore është njohur me fenomenin e trafikimit të qënieve njerëzore dhe shfrytëzimit në formë të ndryshme përgjatë gjithë kohërave. Kur flitet për trafikimin jemi mësuar shpesh ta përcaktojmë si —skllavëria e kohëve modernë. Ndaj dhe në një këndvështrim historik duhet të marrim në analizë këtë fenomen që nga shoqëria e lashtë

greke, për të kaluar tek romakët në kohën e Mesjetës dhe për të vazhduar më tej, deri më sot, kohëra në të cilat njerëzit i janë nënshtruar formave të ndryshme të skllavërisë fizike dhe seksuale. Secila etapë njerëzore ka përfaqësuar fenomenin e trafikimit në përshtatshmëri me kohën dhe nevojat e saj. Disa nga pikat më të spikatura të trafikimit të qenieve njerëzore në vite përfaqësohen nga fenomene të tilla si lindja dhe zhvillimi i skllavërisë, tregëtia me skllavë, ¹ shfrytëzimi i personave për shërbime seksuale, shfrytëzimi i personave për shërbime të tjera etj. Për të nxjerrë në pah historikun në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore do të na duhet të marrim në analizë periudhën më të hershme të shfaqjes së trafikimit, duke analizuar skllavërinë, kuptimin e saj dhe tregëtinë me skllavë. Skllavëria e përkufizuar ndryshe si mohim i të qënurit i lirë i personit, është baza kryesore që çoi më tej në tregëtinë me skllavë. ² Tregëtimi i skllavëve ka lindur që në kohë të lashtë ³ dhe ka gjetur lulëzimin e saj deri në ditët tona. Lashtësia përfaqëson një ndër etapat njerëzore ku tregëtia e skllavëve kishte përhapjen më të madhe. Ajo çfarë i lidh të gjitha etapat njerëzore me fenomenet negative është elementi i realizimit të përfitimeve. Janë këto përfitime të cilat bëhen promotor lëvizës për të gjitha këto fenomene. Në kohërat e lashta ndodhte shndërrimi i skllavëve në një prej burimeve kryesore për realizimin e punëve të ndryshme dhe të detyrueshme. Skllavërit shiheshin si objekte dhe si të tilla dhe trajtoheshin ⁴).

¹ E Drejta Romake, Mandro A, Tiranë 2011, fq 136-138.

² La sciavitu del nostro tempo. 2010. Fq 53-62.

³ Trafikimi i qenieve njerëzore, trajtim juridiko-penal dhe kriminologjik, Leskoviku M, Tiranë 2006, fq 11-22.

Kjo bënte që ata të përjashtoheshin nga një sërë të drejtash duke përfshirë dhe të drejtën për të mos qenë të lirë. Ky kufizim avanconte deri në mohimin e plotë të të drejtave jetësore. Duke mos u njohur atyre asnjë të drejtë, skllavërit shiteshin dhe bliheshin në mënyrë të njëjtë me objektet apo sendet e ndryshme. Tregëtia e skllavëve ka qenë më e përhapur duke filluar nga shek XV deri në shekullin XIX. Janë dukuritë që lidhen me krijimin e perandorive siç mundet të përmendim krijimin e Romës, si element ku nis zanafilla për tregëtinë me skllavë. Periudha e lashtë ku u shfaq tregëtia e skllavëve nis me krijimin e Romës viti 753, ⁵ (p.e.s) deri në shek. II (p.e.s). Nëse i referohemi periudhave më të hershme kategoria e personave me statusin —skllav nuk ekzistonte, kjo dukuri filloi të shfaqej për shkak të luftërave të shumta të ndodhura dhe për shkak të trofeve të përftuara gjatë luftimeve. Si rrjedhojë e këtyre luftimeve dhe trofeve të marra nga lufta, ku pjesa më e madhe e trofeve përfaqësohej nga njerëz të kthyer në robër, numri i skllavëve pati një rritje të madhe dhe për pasojë lindi dhe tregëtia me ta.

1.2 Trafikimi i qenieve njerëzore në historinë e Shqipërisë.

Kur flasim për trafikimin në historinë e Shqipërisë nga shumë studiues është pranuar se ky fenomen në vendin tonë nuk ka histori. Duke qenë se trafikimin e pamë të lidhur ngushtë me prostitucionin, duhet të marrim në analizë duke konkluduar se megjithëse prostitucioni në Shqipëri është njohur në të gjitha kohërat, krahasuar me vendet e tjera ka patur një përhapje më të pakët. Arsytet të cilat kanë bërë që prostitucioni të mos jetë një formë e përhapur në vendin tonë gjithmonë para shndërrimeve të ndodhura në vitin 90-të, lidhen me një sërë faktorësh që kanë të bëjnë me: Traditat shoqërore dhe zakonet, Pozita e dobët të gruas

shqiptare ne shoqëri, Mënyra e jetesës në shoqërinë shqiptare. Gjatë Luftës së Dytë Botërore flitet për një shtëpi publike që ka ekzistuar në Tiranë, konkretisht në vendin e quajtur Zogu i Zi, i cili ka marrë këtë emërtim për shkak të kësaj veprimtarie. Edhe gjatë periudhës së komunizmit prostitucioni ka njohur zhvillimet e veta, por e shprehur në mënyrë të fshehur, gjithsesi edhe në këtë periudhë flasim për një shkallë më të ulët të zhvillimit të tij në krahasim me vendet e tjera të botës. E parë në një vështrim historik mund të themi se kjo dukuri që lidhet me trafikimin e qenieve njerëzore nuk e ka burimin nga vendi ynë. Megjithatë për shkak të pozitës gjeografike dhe për shkak të zhvillimeve historike dhe vendi ynështetë bërë —pre— e kësaj dukurie shkatërruese për shoqërinë e cila cënon të drejta dhe liri themelore të individit.

⁴ Mandro A., E Drejta Romake. Tiranë 2011, fq 138-139.

⁵ Mandro A., E Drejta Romake. Po aty.

Me një shtrirje gjeografike të pëlqyeshme dhe të favorshme Shqipëria është bërë shpesh arenë e luftërave të ndryshme, ku pushtuesit së bashku me shkatërrimin sillnin dhe kulturën e tyre të sjelljes. Shqipëria është përballur dhe ka jetuar një sërë luftërash të cilat së bashku me shkatërrimin sillnin dhe dukuri të panjohura më parë. Duke u populluar me pushtuesit vendi ynështetë përballur dhe me kultura të ndryshme të tyre. Shqipëria ka qene ne udhekryqe historike e gjeografike ⁶ dhe eshte 'populluar' nga pushtues te kulturave te ndryshme: kristiano-romake, turko-islame, austro-hungareze, sllavobullgare apo sllavo-serbomalazeze, greke, italiane, gjermane etj. Rruga "Egnatia", per shembull, qe pershkon Shqiperine, mbart nje histori mbi 23 shekulle dhe, sic eshte logjike apo edhe sic theksohet ne burime te ndryshme, pergj ate saj ka patur motele e hane ne te cilat edhe seksi eshte ofruar si sherbim. Megjithate shqiptaret lane ruajtur identitetin e tyre 'vendor': gjuhen, zakonet, kodin e tyre etiko moral etj. Fale imunitetit kulturor te shqiptareve dhe paraardhesve te tyre, pushtimet nuk kane lene gjurme te qenesishme, megjithe ndikimin e pamohueshem. Kete pohim e gjejme edhe per pushtimin lene gjurme. Ne forma te ndryshme, eshte pohuar se ka patur njerez, te vleresuar si te degjeneruar, qe trafikonin gra dhe vajza te reja shqiptare apo i benin ato "dhurate" per haremet e Stambollit. Nuk vertetohet qe trafikimi i grave dhe adoleshenteve te kete ekzistuar si fenomen edhe Shqiperi, madje edhe legalizimi i tij (vitet 1920-1944); ne ate kohe e vleresuar si mase per ruajtjen e shendetit dhe -moralit publik. Lidhur me kete çështje ka patur disa hulumtime, kryesisht arkivore. Dhe, nga dokumentacioni i arkivuar, del se ne Shqiperine e kësaj periudhe tregu legal i prostitucionit plotesohej vetem ose kryesisht nga prostituta 'vullnetare'. Pra, nuk njihej trafikimi i grave dhe vajzave per shfrytezim seksual apo qellime te tjera fitimprurese. Kjo konfirmohet edhe nga burime zyrtare. Ne nje leterkembim te Ministrit te Puneve te Brendshme, per shembull, te dates 11 shtator 1935, thuhet: "Kam nderin t'ju parashtroj se, ne Shqiperi, nuk ekziston tregtia e te bardheve, qofte per gra ose per diem". Per me teper, ne tetor 1937, Shqiperia ka aderuar edhe ne konventen nderkombetare per zhdukj en e tregtise se grave dhe femijeye. Krejt ndryshe nga c'ndodh sot, edhe kahja e levizjes se prostitutave te asaj kohe ishte "nga jashte-brenda" dhe jo e kunderta. Pra, tregu shqiptar i prostitucionit plotesohej edhe nga femra te huaja. Por edhe ato nuk rezulton te kene gene te trafikuar, por vullnetare. Per shembull, ne nje urdher te Ministrit te Puneve te Brendshme, me 20 korrik 1936, thuhet: "Kemi konstatuar se kohet e fundit nje numer grash te huaja kane ardhur ne vendin tone me pasaporta te rregullta, me viza te perfaqesive tona diplomatike, te cilesueme si turiste. Keto gra, me shume greke e hungareze, ne realitet nuk jane turiste, por prostituta dhe vine ne Shqiperi per to ushtruar profesionin e kurverise". Vendosja e regjimit komunist ne Shqiperi, ⁷

i dha fund epokes se prostitucionit profesionist te krijuar deri ne ate kohe. Por ai, gjithashtu, nuk lejoi kurrfare trafikimi te grave, adoleshenteve e, pergjithesisht, te qenieve njerezore.

⁶ Leskoviku M., Trafikimi i qenieve njerezore, trajtim juridiko-penal dhe kriminologjik.Tiranë 2006 fq 15-25.

Madje edhe lufta kunder ketij lloj trafikimit qe konsiderohej si "plage e kapitalizmit", vleresohej si pjese e luftes se klasave, nclersa te trafikuarit droguarit, prostitutat etj., konsideroheshin si 'te hedhurit tej te shocierise'. Por regjimi. komunist e evitoi trafikimin "me menyren e vet. Kete e pohon edhe akademiku Luan Omari, i cili thote: "Para viteve '90-te, ne Shqiperi nuk njihej koncepti i trafikanteve dhe i trafikimit dhe Kodi Penal parashikonte te denohej, madje asher, vetem ushtrimi i prostitucionit".Ne Shqiperi trafikimi i grave dhe adoleshenteve filloi pas vitit 1990, ne kushtet e mungeses se nje "ligji antitrafik". Gjate viteve 1992-1995, pothuajse mungonte legjislacioni per trafikimin e qenieve njerezore. Mbas vitit 1995 hyn ne fuqi Kodi i ri Penal, por edhe ai nuk e specifikon trafikun e qenieve njerezore si figure te vecante te vepres penale. Vetem ne Janar miratohet ligji Nr.8733, date 24.1.2001 "Per disa shtesa e ndryshime ne Kodin Penal te Republikes se Shqiperise", i cili percakton si vepra penale te vecanta trafikimin e qenieve njerezore, trafikimin e femrave per shfrytezim per prostitucion si dhe trafikimin e fëmijëve me qëllim abuzimi dhe përfitimi.Në ditët e sotme trafikimi i qenieve njerezore si një ndër format e krimit të organizuar mbetet akoma shqetësuese për vendin tonë.

2. TRAFIKIMI SI FENOMEN DHE SI FIGURE E VEPRES PENALE .

2.1 Kuptimi i trafikimit.

Trafiku I qenieve njerezore konsiderohet nje forme e krimit te organizuar per vete karakterin maksimalisht shoqerisht te rrezikshem, I cili eshte I asimilueshem edhe me format e skllaverise moderne – forma kriminaliteti qe prodhojne miliarda dollare⁸ dhe qe cenojne ne format me te renda te mundshme lirite dhe te drejtat themelore te njeriut⁹. Sipas statistikave te Organizates se Kombeve te Bashkuara dhe Keshillit te Evropes, trafiku I qenieve njerezore gjeneron rreth 32 miliarde dollare ne vit dhe perben formen e trete te trafikimit me te perhapur ne bote, pas trafikut te droges dhe atij te armeve.¹⁰ Cdo vit rreth 2,5 milione persona ndodhen nen rrezikun e trafikimit. Sipas statistikave te publikuara nga Komisioni Evropian (Eurosat-DG),¹¹ ne 2013 numri I personave te prezumuar te trafikuar eshte rritur me 18% nga 2008 ne 2010. Permes ketyre viktimave 68% ishin femra, 17% burra, 12% vajza dhe 3% djem.¹² Vendet kryesore te origjines se trafikimit jane Rumania dhe Bullgaria per vendet e BE-se, Nigeria dhe Kina per vendet jashte BE-se. Pervec ketyre vendeve, vendet e Afrikes subsahariane, Vietnami, Filipinet dhe vendet e Evropes lindore llogariten ne vendet kryesore prej nga origjinojn trafikimi. Fenomen kriminal nderkombetar per nga natyra, trafikimi eshte gjithashtu nje fenomen multiformesh. Format e trafikimit synojne te privojne personat nga autonomia e tyre, nga liria e tyre, dhe te nenshtrojne personat nepermjet formave te ndryshme e te rend ate keqtrajttimeve fizike dhe psikologjike.

⁷ Leskoviku M., Punim i cituar , Tiranë 2006, fq 14-20.

Ekzistojne tre forma kryesore te trafikimit te qenieve njerezore¹³:

1. Trafikimi me qellim ushtrimin e punes se detyruar;
2. Trafikimi me qellim shfrytezimin seksual;
3. Trafikimi me qellim perdorimin e organeve njerezore;

2.2 Trafikimi i qënieve njerëzore sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria shqiptare nuk e ka fenomen të prodhuar prej saj, trafikimin. Në periudha të ndryshme historike mund të flitet për mungesën totale të kësaj veprimtarie si dhe mund të përmendet këtu edhe historia shumë vjeçare e periudhës së komunizmit. Arsyet e mungesës së këtij fenomeni në shoqërinë tonë para ndryshimeve të ndodhura pas vitit 90', lidhen me një sërë faktorësh ku përmendim: mënyrën e jetesës së shoqërisë shqiptare, rolin dhe pozitën e gruas në shoqëri si dhe traditat dhe zakonet. Gjatë kohës së sundimit të Mbretit Zog, prostitucioni si element i lidhur ngushtë me trafikimin, ishte i njohur dhe i bazuar në ligj. Shumë studjues kanë nxjerrë në pah mungesën historike të trafikimit apo formave të tjera të shfrytëzimit për qëllim përfitimi në vendin tonë.

Ky fenomen nuk ka patur përhapje edhe po ta shohim në planin krahasimor me vendet e tjera, duke përmendur edhe Greqinë, Italinë apo dhe deri Anglinë, të cilat këtë fenomen e kanë patur të zhvilluar në faza të qytetërimit të tyre. Të paktën trafikimi nuk përmendet në librat mbi historinë e Shqipërisë, në të drejtën tonë zakone, në libra kronikanësh, gjeografësh, albanologësh, në folklorin shqiptar etj. Ky 'përrjashtim', lidhet, para së gjithash, me njëfarë puritanizmi karakteristik, përgjithësisht me jetën tradicionale të shqiptarëve, një jetë e mbyllur, 'në mbrojtje', në një familje të mbyllur, patriarkale, në të cilën gjithçka, përfshirë edhe jetën seksuale të pjesëtarëve të saj, ishte rreptësisht e koduar dhe e kontrolluar.

⁸ Shih per me teper: "Traite d'êtres humains", e disponueshme ne <http://www.interpol.int/fr/Criminalite/C3%A9/Trafic-d%C3%AAtres-humains/Traite%E2%80%99C3%AAtres-humains>, konsultuar ne shtator 2014

⁹ Shih: "Traite des êtres humains » ne Enciklopedine Wikipedia, e disponueshme ne http://fr.wikipedia.org/wiki/Traite_des_%C3%AAtres_humains

¹⁰ Per kete shih: Ministère des Affaires étrangères de la France (2014), La France et la lutte contre la traite des êtres humains, ne faqen web: <http://www.diplomatie.gouv.fr/fr/politique-etrangere-de-la-france/droits-de-lhomme/lutte-contre-la-traite-des-etres/> ¹¹ Shih: Commission européenne, Eurostat – DG affaires intérieures (2013), Trafficking in human beings, fq.13

¹² Keto statistika jane marre nga faqja web e sipercituar. ¹³ Po aty .

Pohimi se trafikimi —nuk ka historil duhet kuptuar si një fakt: Shqipëria, përgjithësisht, nuk ka prodhuar të tilla dukuri —së brendshme. Megjithatë, Shqipëria ka qenë në udhëkryqe historike e gjeografike dhe është —populluar nga pushtues të kulturave të ndryshme: kristianoromake, turko-islame, austro-hungareze, sllavo - bullgare apo sllavo-serbomalazeze, greke, italiane, gjermane etj. Rruga "Egnatia", për shembull, që përshkon Shqipërinë, mbart një histori shekullore dhe siç është logjike apo edhe siç theksohet në burime të ndryshme, përgjatë saj ka patur motele e hane në të cilat edhe seksi është ofruar si shërbim. Në hanet e udhëtarëve këtë prostitucion e kanë ushtruar kryesisht vajza jetime, të cilat e bënin këtë shërbim veç punës së tyre. Por ato mund të kenë qenë edhe objekt trafikimi, në kuptimin që ka marrë sot kjo fjalë. Shqipëria ka qenë, madje për shumë kohë, arenë luftërash të të tjerëve apo një vend i pushtuar. Megjithatë, shqiptarët kanë ruajtur identitetin e tyre 'vendor': gjuhën, zakonet, kodin e tyre etiko-moral etj. Falë imunitetit kulturor të shqiptarëve dhe paraardhësve të tyre, pushtimet nuk ka lënë gjurmë të qenësishme, megjithë ndikimin e pamohueshëm. Këtë pohim e gjejmë edhe për pushtimin pesëshekullor osman. Por, kjo periudhë, edhe përsa i përket trafikimit të grave, nuk ka kaluar pa lënë gjurmë.

Nuk vërtetohet që trafikimi i grave dhe adoleshenteve të ketë ekzistuar si fenomen edhe në gjysmën e parë të shekullit XX, kohë në të cilën vërtetohet përhapja e prostitucionit në Shqipëri, madje edhe legalizimi i tij (vitet 1920-1944), në atë kohë e vlerësuar si masë për ruajtjen e shëndetit dhe moralit publik. Lidhur me këtë çështje ka patur disa hulumtime bazuar

kryesisht në burime arkivore. Dhe, nga dokumentacioni i arkivuar, del se në Shqipërinë e kësaj periudhe tregu legal i prostitucionit plotësohej vetëm ose kryesisht nga prostituta _vullnetare_. Pra, nuk njihej trafikimi i grave dhe vajzave për shfrytëzim seksual apo qëllime të tjera fitimprurëse. Kjo konfirmohet edhe nga burime zyrtare të kohës. Kështu, për shembull, në një letërkëmbim të ministrit të Punëve të Brendshme, të datës 11 shtator 1935, thuhet¹⁴) : “Kam nderin t’ju parashtoj se, në Shqipëri, nuk ekziston tregtia e të bardhëve, qoftë për gra ose për djem”.

Për më tepër, në tetor 1937, Shqipëria ka aderuar edhe në Konventën Ndërkombëtare për Zhdukjen e Tregëtisë së Grave dhe Fëmijëve. Në këto kushte trafikimi në vendin tonë njohu lindje të plotë dhe lulëzim në masë vetëm pas ndryshimeve të ndodhura në vitet 90-të. Normalisht që në lindjen dhe zhvillimin e kësaj veprimtarie ndikuan një sërë faktorësh të cilët jo vetëm që çuan në lindjen e saj por dhe në zhvillimin me hapa të mëdhenj të saj. Pavarësisht se kjo vepër penale ka njohur lindjen e saj në vendin tonë me ndryshimet e ndodhura në vitet 90-të, parashikimi i parë ligjor për këtë vepër penale ka ndodhur me ndryshimet e ndodhura në Kodin Penal në vitin 2001 me ligjin Nr. 8733, datë 24.01.2001. Mbetet për tu zgjidhur fakti se cilat janë arsyet dhe faktorët të cilët bënë të mundur që kjo vepër penale mos të gjente parashikimin ligjor si e tillë në Kodin Penal të R.Sh-së që nga momenti i ndryshimeve në ligjin tonë penal, ku mundet të përmendim atë të vitit 1995. Megjithatë në një analizë të hollësishme mund të konkludojmë që një ndër faktorët mundet të ketë qenë dhe mosnjohja e fenomenit në tërësi dhe veprës penale në veçanti. Në këtë mënyrë edhe në momentin e parashikimit në ligjin tonë penal të kësaj vepre penale, institucionet tona të drejtësisë u përballën me konfondime të cilat vinin si rezultat i mungesës së praktikës dhe njohjes teorike të situatës.

Me fillimin e hapjes së kufijve por dhe me përballjen e shtetit shqiptar me disa ndryshime të karakterit ekonomik, politik dhe gjeografik, fenomeni i trafikimit njohu një lulëzim të menjëhershëm dhe erdhi duke u përhapur në masë. Ndoshta në këtë arritje ndikoi dhe mosreagimi ligjor në kohën e duhur ku u deshën gati 10 (dhjetë) vjet për të reaguar, duke qenë se vetëm pas 10 (dhjetë) viteve erdhi parashikimi ligjor për këtë figurë vepre penale. Ky afat dhjetë vjeçar u përdor nga trafikantët në mënyrën më të mirë të mundshme duke mos kursyer si viktimat të trafikimit persona të ndryshëm dhe duke përdorur për efekt të realizimit të qëllimit të tyre mënyra nga më të ndryshmet. Edhe pas parashikimit në ligjin penal si vepër penale të trafikimit, problemet e hasura ishin nga më të shumtat për disa arsye, të cilat lidhen me moskuptimin e mirë të ligjit nga ana e profesinistëve, ekzistenca e disa figurave të veprave penale të ngjashme në përmbajtjen e tyre, si dhe në lidhje me faktin se në momentin e parë sipas Kodit Penal të vitit 2001, trafikimi si dispozitë u parashikua si dispozitë blanket, element ky prania e të cilit vështirësoi zbatimin e saj. Formulimi i kësaj dispozite, nga ana e ligjvënësit, me anë të një norme blankete, ku përmbajtja e veprës penale nuk jepej në vetë dispozitën, e vështirësoi edhe më tej punën për kuptimin dhe zbatimin e drejtë të kësaj vepre penale. Nisur nga fakti që, kjo vepër penale ishte një vepër penale e re, e pa hasur më parë në praktikën gjyqësore shqiptare, ishte e domosdoshme që, nga ana e ligjvënësit kjo vepër penale të parashikohej me një dispozitë përshkruese, ku të jepej në mënyrë të qartë, përmbajtja dhe elementet e kësaj vepre penale. Duhet të arrinim në vitin 2004, që të kishim një parashikim të tillë ligjor, ku me ndryshimet e reja të ndodhura në Kodin Penal¹⁵) u parashikua se: “Trafikimi i personave” është rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës, ose përfitimit nga gjendjashoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies

së përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga dy milionë deri në pesë milionë lekë. Parashikimi i mësipërm, në vitin 2004, përfaqëson një arritje për ligjin tonë penal nga njëra anë, por dhe një përpjekje objektive në kuptimin dhe identifikimin e plotë të fenomenit. Për herë të parë u përcaktua në mënyrë të qartë vepra penale konkrete, dhe përmbajtja e dispozitës është e plotë. Fillimisht, sipas ndryshimeve të vitit 2004, trafikimi përmbledhej në tre dispozita ku ndarja e tyre në nenet 110/a, 114/b dhe 128/b të Kodit Penal ishte në varësi të karakteristikave të moshës dhe të gjinisë së personit – viktimë trafikimi.

¹⁴ Dokument i Arkivit të Shtetit.

Në këtë mënyrë kur ligji parashikonte Trafikimi i Personave, neni 110/a i Kodit Penal bëhet fjalë për të gjithë personat e rritur të cilët ishin objekt trafikimi. Neni 114/b i Kodit Penal parashikon trafikimin e femrave. Kjo ndarje bëhej në varësi të faktit, nëse i dëmtuari është fëmijë, në këtë rast zbatohet neni 128/b i Kodit Penal, nëse është femër mbi 18 vjeç, në këtë rast zbatohet neni 114/b i Kodit Penal dhe nëse është mashkull mbi 18 vjeç dhe në këtë rast zbatohet neni 110/a i Kodit Penal. Nga ana tjetër, duhet të mbajmë parasysh faktin se, pavarësisht se këto tre vepra penale janë vepra penale të ndryshme dhe zbatohen në varësi të rrethanave konkrete, që kanë të bëjnë me të dëmtuarin, të shpjeguara më lart, këto tre vepra penale në thelb, janë të njejta dhe kanë të njejtën natyrë. Një gjë e tillë rezulton, jo vetëm nga përmbajtja e tyre, ku, po të shikojmë formulimet e secilës prej tyre, me ndonjë përjashtim të vogël, tek masat e dënimit, ato janë pothuajse identike, aq sa është e vështirë të gjejmë dallime ndërmjet tyre, por edhe nga qëllimi i njejtë që kanë këto vepra penale, i cili ka të bëjë me parandalimin dhe ndëshkimin e fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore. Me ndryshimet e ndodhura me Ligjin nr. 144/2013, neni 114/b i Kodit Penal u shfuqizua, duke mbetur vetëm dy dispozita ligjore në lidhje me trafikimin, që u emërtuan „Trafikimi i personave të rritur“¹⁶) dhe Trafikimi i të miturve“, respektivisht parashikuar nga nenet 110/a të Kodit Penal dhe 128/b të Kodit Penal. Përcaktimi i konceptit të trafikimit të personave, nga ana e ligjvënësit shqiptar, i bërë në Kodin Penal në fuqi, është në përputhje me kuptimin që i jep këtij koncepti „Konventa e Kombeve të Bashkuara“ kundër krimit të organizuar dhe dy Protokollat Shtesë të saj, të cilët janë bërë pjesë e brendshme të legjislacionit shqiptar, me anë të Ligjit nr. 8920, datë 11.7.2002. Për të analizuar këtë figurë veprë penale, do të marret në analizë dhe do të përcaktohet fillimisht elementët e figurës së veprës penale. Le të analizojmë sa më poshtë në dhënien e kuptimit për veprën penale të kryer:

- veprimi i njeriut, - rrezikshmëria shoqërore, - kundërligjshmëria, - përcaktueshmëria e veprës penale në ligj, - përgjegjësia penale e autorit.

Elementët themelore të një veprë penale mundet të ndahen në elementë objektivë dhe elementë subjektivë. Elementët objektivë mund të ndahen në elementë formalë dhe elementë materialë. Në grupin e elementëve objektivë bëjnë pjesë: Veprimi i njeriut, Rrezikshmëria shoqërore, Kundërligjshmëria. Veprat penale janë të drejtuara kundër të mirave apo vlerave të cilat janë të mbrojtura në sistemin juridik. Të mirat juridike që janë të mbrojtura në të drejtën penale janë dhe objekt i veprës penale. Objekti i veprës penale është e mira juridike kundër së cilës është e detajuar vepra penale¹⁷.

¹⁵ Neni 110/a i Kodit Penal të RSH-se.

¹⁶ Ligji Nr 144/2013, shpallur me dekretin 8176 dt 14.05.2013.

¹⁷ Kambovski V, E drejta penale e përgjithshme, Shkup 2007, fq 141 -162.

Në të drejtën penale njihen dy lloje të objektit të veprës penale:

1. Objekti i Përgjithshëm, - Objekti i përgjithshëm është dhe njeriu dhe bashkësia shoqërore.

2. Objekti grupor, - Objekt i përgjithshëm është dhe tërësia e të gjitha të mirave materiale që janë që janë të mbrojtura nga e drejta penale.

3. TRAFIKIMI DHE KRIMI I ORGANIZUAR

3.1 Kuptimi i trafikimit dhe viktimës së trafikimit.

Në fjalorin shqiptar nuk mund të gjejmë një përcaktim për termin —trafikim, për faktin se ky fenomen përfaqëson një dukuri që nuk ka lindur në Shqipëri, por është hasur vetëm pas rënies së komunizmit dhe ndërrimit të sistemeve. Në kuptimin e përgjithshëm termi trafikim gjendet në kuptimin e një fjale që tregon “të bërit tregëti”. Në ditët e sotme është pranuar shprehja se trafikimi i personave si një dukuri sociale, është fenomen ndërkombëtar dhe siç sqarohet dhe më sipër, është shfaqur në vendin tonë gjatë viteve të tranzicionit postkomunist dhe paraqet rrezikshmëri të madhe shoqërore. Kjo për arsye se dhunon liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, duke e trajtuar këtë të fundit si mall tregu, me një shkelje të dukshme të dinjitetit njerëzor. Kategoritë e personave më të prekur nga ky fenomen janë: 1. Personat, të cilët largohen nga vendet e origjinës drejt vendeve më të zhvilluara, kryesisht personat e botës së tretë.

2. Femrat dhe fëmijët e rrëmbyer ose të tërhequr nga premtimet për punë nga organizatat kriminale.

3. Personat që largohen nga lufta apo persekutimi.

4. Përkufizimi i “trafikimit të qenieve njerëzore” jepet në shumë gjuhë ndërkombëtare si dy protokollet e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar.

- ***Kuptimi i viktimës së trafikimit.***

Për të përcaktuar se çfarë është trafikimi, duhet të analizojmë disa detaje që lidhen me faktin se çfarë ka ndodhur, mënyra se si ka ndodhur, përse ka ndodhur. Në këtë mënyrë do të nxjerrim në pah: Aktin si veprim¹⁹) (për të përcaktuar se çfarë është bërë). Mjetet konkrete me të cilat është kryer akti, të cilët përcaktojnë faktin se si është bërë, Qëllimi ishfrutëzimit, me anë të të cilit përcaktohet se përse kjo është bërë. Kur flitet për aktin si veprim kemi parasysh të gjitha ato veprime të cilat kryhen me qëllimin e posaçëm trafikimit me qëllim përfitimi. Një analizë e detajuar është e detyrueshme për mjetet e përdorura për të arritur qëllimin, dhe në funksion të kësaj mjetet e përdorura për të kryer veprimin.

¹⁹ Konventa e Kombeve të bashkuara kundër krimit të organizuar, Protokoll i Palermos 2000. Protokoll i Trafikimit²⁰ kërkon që krimi i trafikimit të definohet përmes një kombinimi të tre elementeve përbërës dhe jo vetëm në ekzistencën e njerit prej tyre, komponent individual, edhe pësenëdisarastekëto elemente individuale, të cilat mundet të qëndrojnë të shkëputura nga njëra tjetra, mundet të formojnë vepra penale në mënyrë të pavarur. Për ta ilustruar mund të paraqesim një shembull, që lidhet konkretisht me aktin e rrëmbimit ose mbajtjen e tjetrit pa pëlqim nëpërmjet përdorimit të forcës. Një element i tillë, po të qëndrojë i shkëputur, përbën një figurë tjetër të veprës penale. Në kushtetë legjislativë penal, këta elemente përbërëse mund të identifikohen si elementë objektivë dhe elementë mendorë.

- ***Vepra penale e trafikimit kryhet me elementet e mëposhtem:***

Rekrutimi, nënkupton fazën e njohjes dhe të afrimit me qëllim krijimin e besimit tek personi që do të trafikohet. Krijimi i besimit mundet të realizohet në formë të ndryshme por e rëndësishme është që viktimë të ketë bindjen e plotë që zgjedhja dhe zgjidhja që rekrutuesi i jep është më e mira dhe më e drejta. Rastet e trafikimit të kryera që në fazë rekrutimi janë të shumta.

Transporti, përfaqëson realizimin e lëvizjes së viktimës të trafikimit drejt destinacionit konkret. Marrja përsipër e lëvizjes, kryerja e saj si dhe realizimi konkret i saj, gjetja e mjeteve të posaçme për kryerjen e transportit.

Elemente të tjerë janë dhe: *Transferimi, strehimi, marrja e një personi*. Të gjitha këto veprime duhen kryer nëpërmjet:

- Përdorimit të forces.
- Kërcënimit.
- Shtrëngimit.
- Rrëmbimit.
- Mashtrimit.
- Abuzim të pushtetit apo të pozitës së dobësisë.
- Dhënies ose marrjes së përfitimeve.

²⁰ Protokoli i Palermos 2000.

Legjislacioni ynë penal parashikon si vepra penale:

- Trafikimi i personave, neni 110/a ²¹ i Kodit Penal.
- Trafikimi i femrave, neni 114/b ²² i Kodit Penal,
- Trafikimi i të miturve, neni 128/b ²³ i Kodit Penal.
- Kualifikimi i mësipërm bazohet në subjektin e dëmtuar ose më saktë karakteristikat që ka ai.

3.2 Shkaqet e trafikimit.

Shkaqet e trafikimit janë të ndryshme ²⁵ dhe të shumëllojshme por ato që ndikojnë drejtëpërdrejtë në trafikun e qenieve njerëzore janë : - Faktorët ekonomikë (ekonomi e shkatërruar, papunësi e madhe etj.) - Faktorët socialë (martesat, divorcet, dhuna në familje, mungesa e perspektivës për të ardhmen, papunësi etj.) - Faktorët politikë (mungese e stabilitetit politik, trazirat civile, lidhja e politikës me krimin e organizuar etj.) - Dhunë fizike - Dhunë psikologjike - Dhunë seksuale - Dhunë ekonomike. Trafikantët synojnë, gjejnë dhe rekrutojnë duke bërë pre njerëzit me premtime, me qëllim realizimin e të ardhurave më të larta, për të përmirësuar situatat ekonomike. Ata mbështesin prindërit dhe familjet në fshatra apo dhe në qytete duke përfituar nga situata e tyre ekonomike. Nga ana tjetër shoqëritë përballen dhe me luftën dhe konfliktin, të cilat çojnë në lindjen dhe zhvillimin e situatave kriminale në përgjithësi dhe lidhen direkt me trafikimin në veçanti. Kategoritë më të prekura janë gratë dhe fëmijët, jo vetëm për shkak të tregut të punës por dhe për shkak të burimeve të tyre të kufizuara ekonomike. Grupet e tjera të synuara kryesore përfshijnë: njerëz nga familjet me të ardhura të ulëta, minoritetet etnike, refugjatët dhe emigrantët e paligjshëm, njerëzit me

nivel të ulët të arsimimit, vajzat e reja të larguara nga shtëpia. Shkaqet e trafikimit mundet të klasifikohen në faktorë të brendshëm dhe faktorë të jashtëm. Por, faktorët kryesore që ndikojnë janë gjendja ekonomike si dhe ekzistenca e personave në nevojë. Nuk mundet të lihet pa përmendur shkaqet familjare që lidhen, më së shumti, me dhunën në familje. Fëmijët apo gratë e dhunuara fizikisht psikologjikisht apo seksualisht brenda familjes, janë të destinuar të jenë viktimat të mundshme të trafikimit. Dhuna në familje dhe sjellja në të, mbetet një problem i madh, pasi shndërrohet në një faktor tepër të madh, ku gjejnë burim subjektet kriminale për zgjerimin e viktimave të trafikimit. Tipologjia më e zakonshme klasifikuese për personat që përdoren për qëllime trafikimi, ka të bëjë me femrat, qofshin ato të mitura apo të rritura.

²¹ Kodi Penal i RSH-se, neni 110/a.

²² Kodi Penal i RSH-se, neni 114/b.

²³ Kodi Penal I RSH-se, neni 114/b.

Për këtë arsye, në raport me moshën e viktimës së trafikimit klasifikohet dhe vepra penale në dy parashikime ligjore, nisur nga fakti nëse personi është i rritur apo i mitur. Veprat penale që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore paraqesin si veçori: Kompetencën lëndore ²⁶ të ushtrimit të ndjekjes penale nga Prokuroria, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, çënojnë integritetin moral dhe fizik të personit, shoqërohen me cënim dhe kufizim të pjesshëm ose të plotë të të drejtave dhe lirive themelore të individit, Duhet pohuar që në fillim se nuk është aspak i lehtë identifikimi i rasteve apo, më saktë, gjetja e provave të plota në lidhje me trafikimin e qënieve njerëzore. Si persona të trafikuar mundet të jenë përfaqësues nga të gjitha klasat sociale, racat dhe profesionet. Megjithatë, si kontribut i praktikës, janë evidentuar disa tipologji personash të përfshirë më shpesh në trafikim si më poshtë:

Së pari, viktimat e trafikimit zakonisht janë femra, si në moshë të rritur ashtu dhe në moshë të mitur. **Së dyti**, në më shumë se 1/3 e rasteve, këto kategori vijnë nga shtresa të varfra shoqërore, duke përcaktuar se një shkak dominant është niveli i ulët ekonomik. **Së treti**, në pikëpamje numerike, meshkujt e shfrytëzuar dhe të trafikuar në vendin tonë, janë më pak në numër, pasi rastet e trafikimit të femrave dominojnë. **Së katërti**, shumica e rasteve rrjedhin nga familje në krizë ekonomike e morale, me prindër të divorcuar ose të braktisur. **Së pesti**, një grup më vete përfaqësohet nga shtresa rome, të cilët kanë dhe problemin e qënies së tyre të paregjistruar, ku shkak kryesor për trafikimin bëhet dhe mënyra e tyre e jetesës. **Së gjashti**, disa nga rastet përfaqësohen nga martesat e rreme. Sa për subjektet kriminale të prirur drejt kësaj veprimtarie ata janë nga më të ndryshmit, ku moshat nga 25 deri në 40 vjeç janë më të prirur drejt veprimeve të tilla.

Konkluzione.

Trafikimi i qënieve njerëzore është një fenomen kompleks dhe nën ndikimin e shumë faktorëve. Ai ka një shtrirje të gjerë në të gjithë botën. Pavarësisht nga masat e marra në përgjithësi, prania e viktimave të trafikimit në shkallë kombëtare apo dhe ndërkombëtare është dëshmi e drejtëpërdrejtë e pranisë së fenomenit dhe rritjes së tij në mënyrë të vazhdueshme. Në funksion të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit, të parashikuara në Kushtetutë, vjen dhe legjislacioni penal. Mbrojtja e dinjitetit të individit është një element thelbësor në disa prej figurave të veprave penale, të parashikuara si të tilla në legjislacionin tonë. Me ndryshimet e ndodhura në shoqërinë shqiptare, me shndërrimet pas vitit 1990, edhe legjislacioni, si çdo fushë tjetër, u përball me problematika të reja, të cilat ishin në dimensione të konsiderueshme dhe në zhvillim e sipër. Gjatë këtij punimi janë bërë përpjekje për shpalosjen e problemeve kryesore që lidhen me fenomenin e trafikimit të qënieve njerëzore duke e trajtuar si në aspektin social dhe juridik, madje duke e parë ecurinë

e këtij fenomeni në raport me dimensionet e reja të zhvillimit ligjor, shoqëror dhe politik të vendit tonë. Me qëllim rritjen e efektivitetit të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore do të theksojmë këto rekomandime: Rritjen e nivelit profesional të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore nëpërmjet trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme të karakterit të edukimit të vazhdueshëm në fushën e veprave penale kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Është e detyrueshme të bëhen ndryshime dhe në rrafshin e parashikimeve ligjore në drejtim të sigurimit të provave nga autoriteti i huaj në një mënyrë më të shpejtë nga rruga e tanishme procedurale me anë të letërporosisë. Një rekomandim i mirë, do të ishte ndryshimi ligjor për krijimin e skuadrave të përbashkëta hetimore, ku oficerët tanë do kishin mundësi të kryenin veprime konkrete me qëllim sigurimin e provave jashtë vendit tonë, në bashkëpunim me autoritetin e huaj. Kjo do çonte në përfundimin e çështjes në një mënyrë më të shpejtë e cilësore. Në raport me vendet e tjera, masat e dënimit të parashikuara në legjislacionin tonë penal janë të larta. I duhet kushtuar më shumë vëmendje goditjes së autorit të veprës penale, jo vetëm në burgosjen e tij por edhe sekuestrimin e aseteve të siguruara nga veprimtaria kriminale. Një arsyetim i tillë është i lidhur ngushtë me faktin se dhe arsyeja e përfshirjes në krim të tyre bëhet për shkak të përfitimit material. Rekomandohet një jetë shkencore e profesionale më e shpeshtë, organizimi i konferencave, seminareve kombëtare e ndërkombëtare me këtë temë, botime në revista shkencore etj. Kurrikulat e fakulteteve të drejtësisë të Universiteteve Publike dhe Private të përfshijnë më tepër orë mësimore për trajtimin e këtyre figurave të veprave penale.

BIBLOGRAFIA.

- E Drejta Romake, Mandro A, Tiranë 2011, fq 136-138.
- La sciavitu del nostro tempo. 2010. Fq 53-62.
- Trafikimi i qënieve njerëzore, trajtim juridiko-penal dhe kriminologjik, Leskoviku M, Tiranë 2006, fq 11-22.
- Mandro A., E Drejta Romake. Tiranë 2011, fq 138-139.
- Mandro A., E Drejta Romake. Po aty.
- Leskoviku M., Trafikimi i qënieve njerëzore, trajtim juridiko-penal dhe kriminologjik. Tiranë 2006 fq 15-25..
- Leskoviku M., Punim i cituar , Tiranë 2006, fq 14-20.
- Shih per me teper: “Traite d’êtres humains”, e disponueshme ne <http://www.interpol.int/fr/Criminalite/C3%A9/Trafic-d%C3%AAtres-humains/Traite%E2%80%99C3%AAtres-humains>, konsultuar ne shtator 2014
- Shih:”Traite des êtres humains » ne Enciklopedine Wikipedia, e disponueshme ne http://fr.wikipedia.org/wiki/Traite_des_%C3%AAtres_humains
- Per kete shih: Ministère des Affaires étrangères de la France (2014), La France et la lutte contre la traite des êtres humains, ne faqen web: <http://www.diplomatie.gouv.fr/fr/politique-etrangere-de-la-france/droits-de-lhomme/lutte-contre-la-traite-des-etres/>
- Shih: Commission européenne, Eurostat – DG affaires intérieures (2013), Trafficking in human beings, fq.13
- Keto statistika jane marre nga faqja web e sipercituar. Po aty .
- Dokument i Arkivit te Shtetit.
- Neni 110/a I Kodit Penal te RSH-se.
- Ligji Nr 144/2013, shpallur me dekretin 8176 dt 14.05.2013.
- Kambovski V, E drejta penale e pergjithshme,Shkup 2007, fq 141 -162
- Leskoviku M., Trafikimi i qënieve njerëzore, trajtim juridiko-penal dhe kriminologjik, Tiranë 2006 fq 24-36.
- Konveta e Kombeve te bashkuara kundër krimit të organizuar,Protokolli i Palermos 2000.
- Protokolli i Palermos 2000.
- Kodi Penal i RSH-se, neni 110/a.
- Kodi Penal i RSH-se, neni 114/b.
- Kodi Penal I RSH-se, neni 114/b.
- Roli aktin i organizatave jofitimpruese ne mbrojtjen e te drejtave dhe lirive te njeriut. Imeraj E, Tirane 2011, fq 130-136.
- Roth V.Defining human trafficking and identifying the victims. 2011, fq 15-36
- Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale të RSH-së.

4. Dezintegrimi i Jugosllavisë dhe çështja e Kosovës

Ph.D Mustafë Haziri³⁶

Ma. Agim Hyseni³⁷

Ma. Milazim Hajra³

Abstract

In this work we are going to treat the general developments in Yugoslavia during the period of transition since 1981 till 2008 when Kosovo is proclaimed as independent state.

Here, we'll mention the factors which affected the Yugoslavian diffraction, based on the fact that proves that contemporary historiography is a very important part of the changments which touched the economic, social and politic plan and brought the consequences in social life and politics to the states which experienced this transition.

These changements have indirectly affected the South – East Europe and specially the ex-federation of Yugoslavia . In this case Kosovo as a part of that federation has been affected by the changements by which later changed the structure of the Balcan's map.

In the end of the 20th century has started a new period when till the 90ies, Balcan became a part of the international agenda about the decision making .

In order to try to be careful in this study, and to pay a big attention to the politic developments in Yugoslavia, since the popuplar resistance, the UÇK –a war and the intervention of NATO till the independence of Kosovo.

The aim of this was to highlight the determiating factors which affected the politic developments, generally in Yugoslavia and specially in Kosovo . We will try to reach this aim in order to satisfy the authors morally.

Keywords: Kosovo, International, NATO, UÇK, Independence

Dezintegrimi i Jugosllavisë dhe çështja e Kosovës

PhD. Mustafë Haziri ³⁸

Ma. Agim Hyseni ³⁹

Ma. Milazim Hajra ⁴⁰

ABSTRAKT

Në këtë punim do të trajtojmë në mënyrë shkencore zhvillimet e përgjithshme në Jugosllavi në periudhën e tranzicionit nga viti 1981 deri në vitin 2008 , Kur Kosova shpallet shtetë i pavarur .

Në pergjethësi do të paraqesim faktoret të cilet kane ndikuar në shpërberjën e Jugosllavisë si atë të brendeshëm ashtu edhe atë të jashtëm , duke u nisur nga fakti se historiografia bashkëkohore është një periudhe e rëndesishme e levizjeve dhe ndryshimeve të mëdha si ne

³⁶ University of Pristina

³⁷ University of Pristina

³⁸ University of Pristina

³⁸ PhD . Mustafe Haziri , Universiteti i Prishtinës

³⁹ Ma. Agim Hyseni , Universiteti i Prishtinës

⁴⁰ Ma. Milazim Hajra, Universiteti i Prishtinës

planin ekonomiko-shoqëror ashtu edhe në planin politik – gjeostrategjik , prandaj është e natyrshme së këto ndryshime kanë lënë pasojë në jetën shoqërore dhe në organizimin politik të shtetëve të cilën kaluan në këte tranzicion .

Në këtë kontekst , këto ndryshime në Evropën Juglindore kanë ndikuar në mënyrë indirekte edhe në ish federatën Jugosllave ,në këtë rast edhe Kosova si pjesë konstituive e kësaj Federate e cila u perfshi në këto levizje të cilat sollen ndryshime të mëvonëshme në hartën gjeografike të ballkanit .

Fundi i shek XX në parim ishte fillim i një epoke të re e cila deri në vitet 90-ta të shek. të kaluar Ballkani nuk ishte në agjendën ndërkombëtare të qendrave vendimmarrëse .

Duke bërë përpjekje që në këte studim një rëndësi të vecante i kemi kushtuar trajtimit dhe zhvillimeve politike në Jugosllavi që nga suprimimi i dhunëshëm i autonomisë së Kosovës , rezistencës popullore , luftës së armatosur të UÇK-së , intervenimit të NATO-së e deri të shpallja e Pavarësisë së Kosovës .

Intencë e këtij studimi është që të vihen në pahë faktorët determinues të cilët kanë ndikuar në zhvillimet politike , në përgjithësi në Jugosllavi e veqanarishtë në Kosovë .

Nëse sado pakë do të ja arrijme këtij qellimi për autoret do të jetë një satisfaksion moral .

Fjale Kyqe : Kosova , Nderkombëtare , NATO , UÇK , Pavarësia

HYRJE

Vështrim i përgjithëshëm Politik dhe Historiografik

Çështja e Kosovës mori karakterin e një qështje gjeopolitike qysh në fillim të viteve 80-ta , si dhe pas demonstratave të vitit 1981 , të cilën u pa kjartë se problemët e brendëshme në Jugosllavi dhe problemet nacionale në Evropë , konsideroheshin të “ngrira “⁴¹

Në demonstratat e vitit 1981, filloi një periudhë e re e ndryshimeve në Kosovë, të cilat me vonë ndikuan edhe në Jugosllavi , dhe krejt kjo si rezultat i ndryshimeve në Evropën Juglindore , por edhe të diferencave shoqërore në shoqërinë Jugosllave, të cilat ndikuan në zhvillimet e më vonëshme politike të vendit .

Çështja e Kosovës dhe situata ndërkombëtare e posaqerishtë Ballakani në fund të shek XX , ishin një proces kompleksë , pasi rendi i ri botëror i krijuar prej luftërave botërore nuk u tregua i qëndrueshëm .Arsyjet ishin te natyrës politike dhe ideologjike .⁴²

Vetëqeverisja në Jugosllavi dhe sistemi i saj liberal demokratik ndikoi në zhvillimet pozitive në ekonominë Jugosllave dhe ngritjen e prestigjitë të saj në botë, por zgjidhja jo e drejt nacionale në sistemin e komplikuar politik të sajë, nxiti nacionalizmin që të dalë në skenë dhe ti paraqes pikpamjet politike dhe shoqërore për të ardhmën e vendit .

Zhvillimet politike ne Ballkan (ish Jugosllavi) erdhen si rezultat i zhvillimeve ne Hungari, çekoslovakia e Poloni , ku si arsyeje e ketyre ndryshimeve ishte sovraniteti i kufizuar i ketyre vendeve .⁴³

Keto ngjarje ndikuan me vonë edhe ne zhvillimet politike ne Jugosllavi e veqanarishtë në Kosovë , ku Monatorët ishin të parët që u brengosën për fatin e Kosovës , të cilët filluan rganizimin e protestave dhe Grevën e përgjithëshme . Ata menduan se ishte moment i fundit për t’iu kundërvene politikës diskriminuese Serbe që për qëllim kishe suprimimin e kushtetutës së vitit 1974 .

Shikuar nga perspektiva e tashme greva e minatorëve të Trepcës paraqet një ngjarje të vecantë për nga rëndësia në kuadrin e levizjes se joviolencës. Për më tepër ajo mundë të quhet edhe pikënisje e procesit të shtetëformimit të Kosovës.

⁴¹ Sinani , Shaban , “ Kosova ne Gjeopolitike “ botuar ne “Dritero” 1998 , fq. 96.

⁴² Grup Autresh, “ Bosna ne Pranga “ , Lublane , Tirane , 1996 fq 71 .

⁴³ Tahiri , Edita , “ Konferenca e Rambujes” , NGBL , Dukagjin , Peje , 2002 , fq 274 .

Sipas profesorit të shkencave politike në universitetin e Gjenevës Marko Guingni, levizjet e organizuara mire përvec suksesit në realizimin e kërkesave ato nxisin edhe mbështetje masive.⁴⁴

Minatorët filluan greven në 20 Shkurt 1989 , ku 1300 Minatorë u mbyllën në horizontet e Minierës duke qendruar 8 dite në nëntokë kështu duke shënuar rekorde botërore të një greve të orgnizuar mirë , e cila u bë promotore e zhvillimeve të mëvonëshme politike në Kosovë .⁴⁵

Strukturat politike shtetërore në Jugosllavi , duke mos u pajtuar me kërkesat e Minatorëve , provuan që ti qetesonin ata , duke i fajësuar te tjeret .⁴⁶

Duke shfrytëzuar epëresin politike dhe forcat policore Serbia me 23 Shkurt 1989 pa miratimin e krahinava autonome miratoi 40 amandamente të cilat rrënuan kushtetutën e Kosovës e vitit 1974.

Greva e Minatorëve të Trepçës nxorën në Shesh brishterinë e kreaturës së quajtur Federate Jugosllave .⁴⁷

Duke i komentuar keto ngjarje Toni Judi ne librin e tij “Historia e Evropes “ shkruan se në vitin 1989 përfundoi një epokë duke lindur një Evropë e re .⁴⁸

Shpërbërja e jugosllavisë, sipas professor Esat Stavileci, duhet shikuar në dy arsyeje , e para arsyeje është se procesi i shpërbërjes se Jugosllavisë filloi në Kosovë dhe rreth Kosovës, kur ajo u perjashtua nga kuvendimet për rendin e ri federal apo konfederal. Dhe arsyeja e dytë është mua për shkak të shpërbërjes se jugosllavisë, ceshtja e Kosovës paraqitet me nje dimension te ri politik, por edhe konstitucional-juridik etj⁴⁹

Përpjekjet Serbe ishin që çështja e Kosovës të reduktohej në dimensionin e lirivë dhe të drejtave të njeriut , e cila ishte e paqendrueshme . Shqipëtarët nuk ishin të kënaqur as me autonominë bujare , të kushtetutës së Kosoves e vitit 1974 e lëre me nëse ajo cungohej .⁵⁰

Të ndodhur përball këtyre situatave kuvendi i Kosovës me shumicë votash shpalli deklaratën e 2 Korrikut 1990 , kurse me 7 shtator të po këtij vitit shpalli kushtetutën e re të Kosovës në Kacanik .⁵¹

Si rezultat gjendjës së krijuar në nëntor të vitit 1990 , u formua këshilli qëndrore i solidaritetit , sindikata e pavarur , Shoqata Humanitare “ Nëna Tereze “ , pastaj paraqitja ne rethana të jashtëzakoneshme e sistemit shumë partijak dhe KMDLNJ .⁵²

Kosova në arenen nderkombetare e afirmoi identitetin e vet ne konferencen e Londres 1992 , te Geneves 1995 , ndersa ne vitin 1994 Asambleja e OKB- se miratoi nje rezulute per respektimin e vullnetit te Kosoves , por renja nderkombetare e pozites se Kosoves u vrejt ne pjesmarrien e Kosoves ne Konferencen e dejtonit .

Në librin e vetë “Thellësia Strategjike: pozita ndërkombëtare e Turqisë”, Ahmet Davutoglu shkruan se : “Vetëdija strategjike është detyruar që të mbështetet në histori, kurse planifikimi strategjik në realitetet e sotme .⁵³

⁴⁴ Dr.Ibrahim Gashi, “Kosova rruga tek Pavarësia “ shb , Grafoprint, Prishtinë 2012, fq 65-66.

⁵ Aziz ,Abrashi, Burhan Kavaja, “Epopeja e Minatoreve” , 1996 , Prishtine , fq 14.

⁶ ASH-AK , Imbox , 111 , Prishtine .

⁷ Miranda Vicker , “Midis Serbeve dhe Shqiptareve nje histori e shkurter “ , Tirane 2008 , fq 371.

⁸ Tom , Judi “Historia e Evropes “ Tirane , 1989 , fq 83 .

⁹ Akademik Esat , Stavileci”Kosova dhe çështja Shqipëtare në udhëkryqet e kohës”,shb Instituti për studime

bashkëkohore, Prishtinë 2005, fq 487.

⁵⁰ Noel, Malcolm , “ Kosova një histori e shkurtër” , Prishtinë, 2001, fq. 97 .

⁵¹ Mustafë Haziri , “ Greva e minatorëve të Trepçës në Stan – Tërg” , Prishtinë, 2011, fq .27.

⁵² Gani ,Mehmetaj, “Midis serbëve dhe shqiptarëve një histori e shkurtër” Tiranë, 2010 , fq. 22 .

⁵³ Ahmet, Davutoglu, “Thellësia strategjike:Pozita ndërkombëtare e Turqisë”, SHB Logos-a, Shkup, 2010, fq.

Eshtë për tu vlersuar mendimi i Janush Bugajskit, (Drejtor i institutit të studimeve në Uashington), sipas të cilit, ... e vetmja mënyrë për të arritur qëndrueshmërinë në rajon është vetëvendosja e popullit të ballkanit, vecanarisht e atyre vendëve që e kanë pothuajse gati strukturën e shtetit të tyre, pra ato vende që aspirojnë për shtetin e tyre. Jamë i mendimit se Kosova i plotëson kushtet për këtë dhe gjykoj se kjo do ti ndihmonte edhe zgjidhjes së problemeve në Beograd dhe Kosova të shkonte përpara drejt Evropës . Përfundimisht, shton Bugajski , se Kosova duhet të jetë në OKB dhe jo Kombet e Bashkuara të pranishme në Kosovë.⁵⁴

Radikalizimi i gjendjes në Kosovë përshpejtoi daljen në skenë të UCK-se . Ndertimi i relacioneve të Kosovës me SHBA-ne , vendet Evropiane dhe NATO-s u bë komponenti themelor përelimin i Kosovës . SHBA në krye me presidentin Clinton që ai e quajti partneritet për paqe , i cili ftoi të gjitha shtetet pasardhese të bashkimit sovjetik të marrin pjesë në një sistem të papercaktuar të sigurisë kolektive .⁵⁵

Ndërhyrjes së NATO-së në Kosovë i parapreu Konferenca e Rambujës e mbajtur më 23 shkurt 1999.14 Gjatë luftërave të gjata që ndodhën në Ballkan popujt e sajë dolën të rraskapitur dhe të shumë vuajtur .⁵⁶

Dezintegrimi i bllokut të lindje , zhbërja e paktit të Varshavës dhe pavarësia e vendeve baltike , shënuan përfundimin e rendit të krijuar pas luftës së dytë botërore .⁵⁷

Diplomacia Evropiane ndaj çështjes Shqipëtare filloi atëherë kur relacionet e Kosovës me SHBA –në dhe vendet Evropiane me NATO-në u bë komponenti themelor në procesin e çlirimit të Kosovës .

Diplomacia amerikane ishte më vendosur , ndaj çështjes së Kosovës karshi asaj Evropiane e cila kishte ngritje dhe rënje

Me miratimin e rezolutës 1244, në OKB dhe vendosjes së administratës civile dhe ushtarake në Kosovë për ruajtjen e paqes dhe sigurisë .⁵⁸

Me vendosjen e trupave të Kforit të administratës së OKB-së , UNMIK dhe ndihmën e OSB për herë të parë u mbajtën zgjedhje lokale në Kosovë gjatë vitit 2001 ndërsa ato qëndrore në vitin 2004 .

Prandaj nuk do të jetë i qëndrueshëm mendimi i ish komisionerit për zhvillim i BE-së Olirhen i cili thotë “çështja e Përcaktimit të kufinjëve të Evropës duhet të jetë si një projekt i gjeneratave .⁵⁹

Kosova e sotme qysh nga periudha antike ishte territor qendror i provincës ilire të dardanisë .Kosova gëzonte mëvetësinë e vet qysh në periudhën kur u konstitua si vilajet (1868).Edhe në periudhat tjera të historisë së zhvillimit të vetë, Kosova kishte status të njësisë së veçantë .

Shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 Shkurt 2008 dhe formimi i shtetit të pavarur të Kosovës është një rezultat i pavarur dhe real .

Pavarësia e Kosovës është çelësi i stabilitetit të rajonit , prandaj sa më shpejtë që kuptohet ky realitet nga bashkësia ndërkombëtare aq më shpejtë ballkani do të ece rrugës së një paqeje dhe stabilitetit të qëndrueshëm .

⁵⁴ Haxhi, Ferati, “Gjeopolitika dhe gjeostrategjia” SHB, “ILAR”, Tiranë, 2013, fq. 348.

⁵⁵ Henery, Kisinger, “ Diplomacia “ , Tiranë, 1999 , fq. 325.

⁵⁶ Koha Ditore , 2010 , Prishtinë, fq. 11.

⁵⁷ George ,Catelen, “ Historia e Ballkanit “ Tirane 1991 ,fq 418 .

⁵⁸ Abaz, Lleshi “ Gjeopolitike në Ballkan dhe perspektiva e sigurisë në Rajon “ , Prishtinë, 2009, fq. 176.

⁵⁹ Revista “ Evropa” Prishtinë 2008, fq. 80 .

Shpërbërja e Jugosllavisë filloi në Kosovë , kur ajo u përjashtua nga bisedimet për rëndin e ri federal apo konfederal të saj , prandaj për këtë arsyeje çështja e Kosovës paraqitet me një dimension të ri politik por edhe konstitucional – juridik .⁶⁰

Çështja e Kosovës, bashkë me çështjen Shqiptare , paraqet sot një prej problemeve qendrore të zgjidhjes së krizes politike në ballkan .

Në përfundim konsiderojmë se komponentet më të rëndësishme të shqyrtimit të çështjes së Kosovës dhe të vërtetën e saj është se ajo, historikisht dhe aktualisht, përbente dhe përbën një tërësi të vaçant politiko teritoriale.

Kosova e sotme qysh nga periudha antike ishte territor qendror i provincës ilire të Dardanisë .Kosova gëzonte mëvetësinë e vet qysh në periudhën kur u konstitua si vilajet (1868).Edhe në periudhat tjera të historisë së zhvillimit të vetë, Kosova kishte status të njësisë së veçantë .

PËRFUNDIM

Në përfundim mund të themi se është të qartë se konfiguracioni politik i ballkanit veçanarisht i Jugosllavisë është akoma i papërfunduar pasi që në rajon kanë mbetur çështje të pazgjedhura .E kjo nga fakti i gërshetimit të interesave politike dhe gjeostrategjike të faktoreve të jashtëm dhe të brendshëm në raport me këtë pjesë të rajonit .

Në kontekstin e trajtimit të problemeve në ish Jugosllavi veçanarisht në çështjen e Kosovës i kanë paraprirë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm .

Në përfundim konsiderojmë , së zgjedhja finale e të gjithave çështjeve që lidhën me ballkanin , ish jugosllavinë dhe Kosovën , duhet shikuar në një të ardhme të afërt të njohjes reciproke të shtetëve të cilët do të ndikojnë në normalizimin e raporteve politike ndërmjet veti .

Prandaj përfaqësuesve të institutucioneve të Kosovës zyrtareve të lartë dhe të mesëm , elitës politike dhe inteligjencia duhet të jenë të vetdijshëm së e ardhmja e shtetit dhe kombit varet nga aftësia dhe paaftësia e tyre .

Në përgjethësi solucionin i Kosovës sovranë dhe të pavarur paraqet dhe mund të paraqesë vetëm një zgjidhje kaluese drejt zgjedhjes së drejtë të çështjes shqiptare, duke u nisur nga fakti se çështja e Kosovës paraqet njërën nga përbërësit,, siguriasht më të rëndësishme, të çështjes shqiptare në përgjethsi .

Duke qenë se Kosova përbën një territor të njësisë dhe se atje shqiptaret përbëjnë rreth 90 % të popullatës, do të ishte shumë normale shprehjet Paule Garde në librin e tij “ Vie et mort de la Yougoslavie “(Jeta dhe vdekja e Jugosllavisë),të botuar në librarinë Artheme, Paris 1992, që ky territor të jetë gjithashtu i pavarur me mundësi që t’i bashkohet Shqipërisë, në qoftë se dy vendet e dëshirojnë këtë.

⁶⁰ Esat, Stavileci, “ Kosova dhe Çështja shqiptare në udhëkryqet e kohës” botoi institute për studime bashkëkohore , Prishtinë 2005, fq. 487 .

Burime dhe Literatura

1. Abrashi, Aziz, Kavaja Burhan, “Epopeja e Minatoreve” , 1996 , Prishtinë.
2. ASH-AK , Imbox , 111 , Prishtinë
3. Ahmet, Davotoglu, “Thellësia strategjike: Pozita ndërkombëtare e Turqisë”, shb Logos-a, Shkup, 2010.
4. Catelen , George, “ Historia e Ballkanit “ Tiranë 1991 .
5. Stavileci, Esat, “ Kosova dhe Cështja Shqiptare ne udhëkryqet e Kohes “ botoi instituti për studime bashkekohore, Prishtine 2005 ,
6. Gashi, Ibrahim, “Kosova rruga tek Pavaresia” shb, GrafoPrint, Prishtine 2012.
7. Grup Autresh, “ Bosna ne Pranga “ , Lublane , Tiranë, 1996 .
8. Ferati, Haxhi , “Gjeopolitika dhe Gjeostrategjia” shb, “ILAR”, Tiranë, 2013.
9. Haziri , Mustafë , “ Greva e Minatoreve te Trepces ne Stan – Terg “ , Prishtinë 2011.
10. Judi, Toni, “Historia e Evropes “ Tirane , 1989 .
11. Kissinger, Henery , “ Diplomacia “ , Tiranë, 1999 .
12. Koha Ditore , 2010 , Prishtinë.
13. Lleshi , Abaz , “ Gjeopolitike ne Ballkan dhe perspektiva e sigurise ne Rajon “ , Prishtinë 2009
14. Malcolm , Noel, “ Kosova nje Histori e shkurter “ , Prishtine , 2001 .
15. Mehmetaj , Gani, “Midis Serbeve dhe Shqiptareve nje histori e shkurter “ Tiranë, 2010.
16. Revista “ Evropa “ Prishtinë, 2008.
17. Tahiri , Edita, “ Konferenca e Rambujes” , NGBL , Dukagjin , Pejë, 2002 .
18. Sinani , Shaban, “ Kosova ne Gjeopolitike “ botuar ne “Dritëro” 1998 .
19. Vicker , M “Midis Serbeve dhe Shqiptareve nje histori e shkurtër”, Tiranë 2008 .

5.Ndikimi i opinionit të Komisionit të Venecias në vendimarrjen e Gjykatës Kushtetuese për ligjin nr. 133/2015 "Mbi trajtimin e pronës dhe finalizimin e procesit të kompensimit të pronave

Prof. Asoc. Dr. Florian BJANKU

Profesor në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Eriklida SHPORI

Anëtar i Domës së Avokatisë, Shkodër

Abstrakt

Që nga fillimi i tij në vitin 1990-të, Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit, zakonisht më i njohur si Komisioni i Venecias, ka luajtur rol të rëndësishëm, sidomos në vendet e demokracive të reja të dala nga regjimet moniste, në miratimin e kushtetutave që të jenë konform standardeve të trashëgimisë kushtetuese të Evropës. Fillimisht u konceptua si një mjet për rregullime kushtetuese emergjente, ndërsa tashmë komisioni është shndërruar në një konsulent ligjor i pavarur, i njohur ndërkombëtarisht. Ai po kontribuon në vazhdimësi në përhapjen e trashëgimisë evropiane kushtetuese, bazuar në vlerat ligjore themelore të kontinentit, të cilat përfshijnë një gamë të gjerë të burimeve. Sigurisht, që burimi kryesor është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe interpretimi i saj nga ana e Gjykatës së Strasburgut, por Komisioni i Venecias i referohet edhe "ligjit të butë" siç janë rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës. Komisioni luan një rol unik në menaxhimin e krizave dhe parandalimin e konflikteve nëpërmjet kontributit në hartimin e kushtetutave dhe këshillimeve. Komisioni ka ofruar edhe për Shqipërinë një "ndihmë të parë kushtetuese".

Problematikat e vazhdueshme të procesit të kthimit/kompensimit të pronave në Shqipëri kanë sjellë një debat shumë të gjërë politik dhe reagime të grupeve të interesit, reagime të cilat, duke qenë se kanë të bëjnë me një të drejtë kushtetuese, siç është e drejta e pronës private, kanë shkuar për zgjidhje edhe pranë Gjykatës Kushtetuese, si dhe në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg. Ky artikull ofron një analizë të rolit të Komisionit të Venecias në vendimarrjen e Gjykatës Kushtetuese për ligjin nr. 133/2015 "Mbi trajtimin e pronës dhe finalizimin e procesit të kompensimit të pronave", duke vënë theksin jo vetëm tek karakteri i rëndësishëm këshillues që kanë opinionet *amicus curiae*⁶¹ të Komisionit për çështje apo detaje teknike që hasin vështirësi interpretimi nga trupa e gjyqtarëve, por duke sjellë edhe një vështrim kritik për situatën kur Gjykata Kushtetuese në një mënyrë pragmatiste e përdor Komisionin për t'iu shmangur presioneve politike dhe preceptimeve për anëshmëri në vendimarrjen e saj.

⁶¹ *Amicus curiae* është një frazë latine që e ka origjinën në të drejtën romake që fjalë për fjalë ka domethënie "miku i gjykatës", i cili është dikush që nuk është palë në një rast dhe nuk kërkohet nga palët ndëgjyqëse në proces, por që ndihmon një gjykatë duke ofruar informacion që në lidhje me një rast konkret. Vendimi në se do të pranohet ky informacion është në diskrecionin e plotë të gjykatës. Kjo frazë përdoret kryesisht në të drejtën ndërkombëtare, në veçanti në lidhje me të drejtave të njeriut. Sot, kjo frazë përdoret nga ana e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Komisionit Ndër-Amerikan për të Drejtat e Njeriut, Gjykatës Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, etj. Burim i cituar: The role of an *amicus* is, as stated by Salmon LJ (as [Lord Salmon](#) then was) in *Allen v Sir Alfred McAlpine & Sons Ltd* [1968] 2 QB 229; fq. 266 F-G:

Gjykata Kushtetuese duhet të jetë një gur themeli për demokracinë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit. Është vetë Komisioni i Venecias i cili këmbëngul në pavarësinë institucionale, administrative dhe financiare të gjykatave kushtetuese. Gjykata Kushtetuese vendos për çështje delikate dhe është në natyrën e funksionit të saj kushtetues që vendimet e saj në mjaft raste të mos pëlqehen nga qeveria, parlamenti apo opozita. Sidomos në rastin e Shqipërisë që hyn në vendet me demokraci të re dhe me institucione akoma të brishta është esenciale që Gjykata Kushtetuese të mos vihet në presion nga këto autoritete për vendimarrje të padëshiruara. Në këtë logjikë duhet që edhe vetë Gjykata Kushtetuese në veprimtarinë dhe vendimarrjet e saj të tregohet më shumë kurajoze, pasi fleksibiliteti dhe pragmatizmi i tepërt çënon ushtrimin e funksionit të saj dhe konsolidimin e institucionit që është garant i Kushtetutës.

Hyrje

Me ligjin nr. 133/2015 "Mbi trajtimin e pronës dhe finalizimin e procesit të kompensimit të pronave", Këshilli i Ministrave, i cili ushtroi iniciativën ligjvënëse, synonte të gjente një balancë mes interesit publik dhe së drejtës së pronës. Projektligji u përgatit duke pasur si referim vendimin pilot të GJEDNJ-së "Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Republikës së Shqipërisë" dhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese, duke u zotuar në respektimin e rekomandimeve e parimeve përkatëse dhe me qëllimin për të konkluduar me një formulë efikase dhe realiste për kompensimin e pronarëve; një afat të arsyeshëm dhe të përcaktuar kohor për përfundimin e të gjithë procesit dhe me një zgjidhje të drejtë, duke respektuar normat kushtetuese për të gjithë pronarët, por gjithashtu edhe për të gjithë qytetarët, duke mbajtur në konsideratë interesin publik. Në thelb, objektivi i kthimit të të drejtave të pronës nuk ishte fshirja e të gjitha padrejtësive, por zvogëlimi i tyre, gjithmonë brenda kushteve dhe mundësive ekonomiko-sociale të vendit tonë.⁶²

Ligji nr. 133/2015 përcakton se ka për qëllim përfundimin e procesit të njohjes dhe kompensimit të pronave të subjekteve, të cilave u janë shpronësuar, shtetëzuar ose konfiskuar pronat, sipas akteve ligjore e nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose të marra me çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga shteti komunist prej datës 29.11.1944; rregullimin dhe shpërblimin e drejtë të kompensimit të pronës, ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit, si dhe përfundimin e procesit të kompensimit, brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj, nëpërmjet fondit të kompensimit.

Megjithë këtyre synimeve ambicioze, miratimi i ligjit të ri ka kaluar përmes një procesi të kundërshtuar nga grupet e interesit, si dhe institucionet kushtetuese të pavarura si Presidenti i Republikës dhe Avokati i Popullit. Këto subjekte e kanë konsideruar ligjin nr. 133/2015 si në kundërshtim me Kushtetutën dhe në cenim të së drejtës së pronësisë për kategoritë e ish-pronarëve. Presidenti i Republikës, referuar nenit 85/1 të Kushtetutës, me Dekretin nr. 9377, dt.29.12.2015 e ktheu për rishqyrtim në Kuvend ligjin nr.133/2015, mirëpo konstatimet e tij nuk u morën në konsideratë nga mazhoranca parlamentare dhe dekreti u rrëzua.

Ndër çështjet më problematike të ligjit të ri, të cilat nga ana e Presidentit të Republikës dhe opozitës parlamentare⁶³ u dërguan në Gjykatën Kushtetuese më qëllim shfuqizimin e tyre, ishin :

⁶² Shih relacionin për projektligjin "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2015/10/relacioni_trajtimi_i_pronave_24184_1.pdf

⁶³ Një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë (*jo më pak se 1/5 e deputetëve*) - anëtarë të grupit parlamentar të Partisë Demokratike.

Së pari, ligji i ri nuk e njeh më konceptin e “kthimit të pronës”, por e trajton atë si një nga format e kompensimit. Konkretisht, “kompensim” është shpërblimi i drejtë, sipas procedurave të përcaktuara në ligj. Format e kompensimit janë: “kompensim financiar”, “kompensim fizik nga fondi i tokës” dhe “kompensim fizik brenda pronës së njohur subjektit të shpronësuar”. “Kompensim fizik brenda pronës së njohur subjektit të shpronësuar” është sipërfaqja e pasurisë që është vendosur t’u jepet subjekteve të shpronësuar me vendim përfundimtar.

Së dyti, sipas ligjit të ri, për efekt të ekzekutimit, të gjitha vendimet përfundimtare për kthimin dhe kompensimin e pronës do t’i nënshtrohen vlerësimit financiar nga Agjencia e Trajtimit të Pronës (ATP), si më poshtë:

- a) prona e njohur për kompensim vlerësohet në bazë të zërit kadastral që ka pasur në kohën e shpronësimit;
- b) prona e kthyer vlerësohet duke e përcaktuar atë nga diferenca, që do të rezultojë midis vlerës së saj, sipas zërit kadastral aktual, dhe vlerës së kësaj prone, sipas zërit kadastral në kohën e shpronësimit. Vendimet përfundimtare, që kanë të njohur vetëm të drejtën e kompensimit, vlerësohen financiarisht, sipas zërit kadastral që ka pasur prona në kohën e shpronësimit. Në rastet kur subjektet e shpronësuar kanë përfituar me vendim kthimi dhe kompensimi, diferenca e llogaritur, zbritet nga vlerësimi i pronës së njohur për kompensim.

Së treti, ligji parashikon se në rast se ATP-ja merr vendim për njohje dhe kompensim fizik në pronën e subjektit, prona vlerësohet sipas rregullave të ligjit të ri. Kur nga ky vlerësim rezulton se subjekti përfiton një pronë që ka vlerë më të lartë sesa prona që ka pasur në momentin e shpronësimit, atëherë subjektit i kompensohet fizikisht sipërfaqja që i korrespondon vlerësimit dhe pjesa tjetër e pronës kalon në fondin e tokës me vendim të ATP-së. Të gjitha vendimet përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit dhe ato që do të merren deri në përfundim të procesit, do të zbatohen sipas parashikimeve të ligjit të ri. Vlerësimi financiar i vendimeve përfundimtare për kompensim do të bëhet duke vlerësuar financiarisht pronën e njohur për kompensim, sipas rregullave të ligjit të ri, në përputhje me procedurën e mëposhtme: a) nëse vlerësimi i pronës së kthyer me vendim përfundimtar rezulton se është më i madh sesa vlerësimi i tokës së njohur për kompensim, atëherë subjekti i shpronësuar konsiderohet i kompensuar; b) nëse vlerësimi i pronës që është njohur për kompensim është më i madh sesa vlerësimi i tokës së kthyer, atëherë subjektit i kompensohet diferenca; në rast se vendimi përfundimtar nuk ka vendosur kthim prone, atëherë llogaritet vlerësimi financiar i pronës së njohur për kompensim, bazuar në zërin kadastral që ka pasur prona në momentin e shpronësimit; ç) në rast se vendimi përfundimtar nuk ka vendosur kompensim prone, atëherë vendimi dhe dokumentacioni përkatës arkivohen sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për arkivat.

Së katërti, kërkesat e bëra para hyrjes në fuqi të këtij ligji, si dhe kërkesat e bëra brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj, do t’i nënshtrohen trajtimit të pronës nëpërmjet njohjes së të drejtës së subjekteve të shpronësuar me vendim të ATP-së dhe kompensimit të tyre sipas këtij ligji. Në çdo rast, aty ku është e mundur, i jepet përparësi kompensimit fizik në pronën që i njihet subjektit me vendim të ATP-së. Subjekteve të shpronësuar u njihet e drejta e pronësisë dhe u kompensohen pa kufizim fizikisht, brenda pronës së njohur, pronat e paluajtshme të lira, sipas përcaktimeve të këtij ligji, me përjashtim të tokës bujqësore, e cila kompensohet fizikisht deri në 100 ha.

Së pesti, kundër vendimit të ATP-së për njohjen e së drejtës, palët e interesuara dhe Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi, pranë Gjykatës së Apelit, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Nga këto subjekte u pretendua se ligji cenon parimin e sigurisë juridike, për shkak se nuk përmbush kërkesat e qartësisë së tekstit normative dhe kuptueshmërisë së ligjit. Parimi i sigurisë juridike presupozon besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë e akteve juridike të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të cenojnë ose përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. E thënë me fjalë të tjera rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive. Kujdes duhet bërë se ky ndryshim “pozitiv” nuk duhet parë thjesht si rezultante vetëm e situatës juridike të një individi konkret, por duke e parë individin si pjesë të publikut dhe duke vlerësuar se e mira që i vjen publikut është edhe e mirë individuale, paqka se mund të jetë indirekte dhe jo e matshme në terma konkrete.

Për të gjitha parashikimet e mësipërme të përfshira në nenet 2, 3, 5, 6, 7, 12, 14, 15, 20, 21, dhe 29 të ligjit nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, nga subjektet që vendosën në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, u pretendua se bien ndesh me nenet 4/1, 17, 18, 41, 42/1 dhe 181 të Kushtetutës.

- Procedurat paraprake në Gjykatën Kushtetuese

Të përcaktosh kufirin midis gjykimit të legjitimitetit të ligjeve dhe gjykimit mbi thelbin/meritën e tyre nga Gjykata Kushtetuese është një operacion jo i thjeshtë. Gjykatës i takon në fakt të gjykojë legjitimitetin e një ligji duke prezumuar në masën e saj të vlerësimit ekzistencën e kriterëve elastike si arsyeshmëria, në sensin e përgjithshëm; ndërgjegjjen sociale; “të drejtën e gjallë”; “përdorimin e mirë të pushtetit legjislativ”; vlerat estetiko-kulturore, madje duke mbajtur parasysh se disa dispozita kushtetuese përmbajnë koncepte të papërcaktuara, janë formuluar në mënyrë të përgjithshme, tregojnë qëllime të përgjithësuara që legjislatori duhet të ndjekë. Të mbyllësh sferën e gjykimit të legjitimitetit pa pushtuar sferën e diskrecionalitetit që i përket legjislatorit, të evitosh që gjykimi mbi përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën të transformohet në një gjykim mbi “drejtësinë” ose “barazinë” ose “oportunitetin” e ligjeve ose në një vlerësim mbi “vlerat” që ligjet përmbajnë, kërkon mbi të gjitha, nga ana e Gjykatës Kushtetuese, një vetëkufizim rigoroz të pushteteve të saj (self-restraint) në kuptimin që ajo vetë duhet të vërë në themel të vlerësimeve të saj kriterë dhe masa objektivisht të bazuara në normat kushtetuese, pa ndërhyrë në zgjedhjet e operuara nga legjislatori⁶⁴.

Për t’i ardhur në ndihmë vendimmarrjes çështjes së rëndësishme dhe komplekse të ligjit nr. 133/2015 “Mbi trajtimin e pasurisë dhe finalizimin e procesit të kompensimit të pronave”, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi marrjen e opinionit *amicus curia* të Komisionit European për Demokraci Nëpërmjet Ligjit, i njohur më mirë si Komisioni i Venecias, i cili është organizëm

⁶⁴ Temistocle Martines, Diritto Costituzionale - Decima edizione interamente riveduta da Gaetano Silvestri, 2000, fq. 459-46.

këshillues mbi çështjet kushtetuese, lidhur me respektimin ose jo të standardeve të vendosura nga KEDNJ-ja dhe praktika e GJEDNJ-së sa i takon respektimit të parimit të sigurisë juridike dhe barazisë para ligjit në garantimin e së drejtës së pronës nga ligji objekt shqyrtimi para kësaj Gjykate.

Në letrën e datës 7 korrik 2016, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, z. Bashkim Dedja, kërkoi një interpretim të shkurtër *amicus curiae* nga Komisioni i Venecias mbi pajtueshmërinë e ligjit nr. 133/2015 i Republikës së Shqipërisë "Mbi trajtimin e pasurisë dhe finalizimin e procesit të kompensimit të pronave", me kërkesat e nenit 1, Protokollit nr 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe përkatëse jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi marrjen e opinionit *amicus curia* të Komisionit të Venecias me arsyetimin për t'i ardhur në ndihmë vendimmarrjes për këtë çështje të rëndësishme dhe komplekse, lidhur me respektimin ose jo të standardeve të vendosura nga KEDNJ-ja dhe praktika e GJEDNJ-së sa i takon respektimit të parimit të sigurisë juridike dhe barazisë para ligjit në garantimin e së drejtës së pronës nga ligji objekt shqyrtimi para kësaj Gjykate⁶⁵.

Katër pyetjet e adresuara në Komisionin e Venecias ishin si më poshtë:

1. A shkel ky ligj të drejtat e fituara dhe pritshmëritë legjitime duke iu referuar Kushtetutës (nenet 18 dhe 41) dhe nenit 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së? Nëse po, a është kjo një ndërhyrje proporcionale dhe e justifikueshme nga ligji?
2. A është në përputhje me KEDNJ dhe rekomandimin e GJEDNJ, dispozita e ligjit sipas të cilit vendimet përfundimtare të pavlerësuar dhe jo të detyrueshme për kompensim të rivlerësohen sipas një skemë të re / formulë, e cila nuk ishte e njohur në kohën kur është këto vendime kanë marrë formë të prerë?
3. A është skema e re / formula e kompensimit e parashikuar, reale dhe efektive?
4. A ka ky ligj nëpërmjet skemës / formulës një mënyrë efektive dhe transparente brenda një kohe të caktuar të trajtojë çështjet pronësore të subjekteve që janë të shpronësuar gjatë regjimit komunist, në përputhje me rekomandimet e dhëna nga GJEDNJ-ja në gjykimin e saj pilot Manushaqe Puto etj kundër Shqipërisë?

Përveç vështirësisë që me të drejtë paraqet trajtimi i kushtetutshmërisë së ligjit nr. 133/2015 "Mbi trajtimin e pasurisë dhe finalizimin e procesit të kompensimit të pronave" nga ana e Gjykatës Kushtetuese, ajo ndodhej në një situatë presioni shumë të lartë nga partitë politike kryesore, të cilat edhe në mjaft raste të tjera kishin vënë në diskutim paanshmërinë e kësaj gjykatë dhe anëtarëve të saj. Segmente të pozitës dhe opozitës kanë akuzuar shpesh herë njëra tjetrën për ndërhyrje politike jo vetëm në vendimmarrjet e këtij institucioni, por edhe në procedurat e emërimit të gjyqtarëve.

Në një situatë të tillë, sic ka vepruar edhe në situata të ngjashme⁶⁶, Gjykata Kushtetuese, vlerësoi t'i drejtohej paraprakisht për një opinion Komisionit të Venecias, më tepër se sa nga ana e vlerësimit dhe opinionit për çështjet teknike, ai do t'i shërbente Gjykatës Kushtetuese edhe si mundësi që t'i shmangej presionit politik dhe vendimmarrja e saj të mos trajtohej më pas si politikisht e ndikuar. Nga njëra anë ky veprim i Gjykatës Kushtetuese mund të vlerësohet sa i takon pragmatizmit në zgjidhjen e rastit dhe ndihmesës teknike që jep Komisioni i Venecias në çështje që kanë të bëjnë sidomos me Konventën Evropiane për të

⁶⁵ Shih Vendimin nr. 1 datë 16.01.2017 (V-1/17) të Gjykatës Kushtetuese.

⁶⁶ Së fundmi edhe për Ligjin Nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i njohur si ligji i "Vettingut".

Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. Nga ana tjetër kur kjo procedurë kur praktikohet për të shmangur situata të presionit politik dhe nëpërmjet pyetjeve shteruese në drejtim të Komisionit të Venecias, e cila praktikisht con në vendimarrje konfirmuese prej “noteri” të Gjykatës Kushtetuese, janë tregues të pasigurisë institucionale që ka një institucion i tillë që është garant i kushtetutës dhe i sistemit tonë juridik. Komisioni i Venecias nuk mund të “të shpëtojë” në çdo rast vendimarrjet e Gjykatës Kushtetuese nga presionet politike apo ndërhyrjet e ndryshme.

- **Vlerësimi *Amicus Curiae* i Komisionit të Venecias**

Së pari, duhet të theksojmë se opinionet e Komisionit të Venecias nuk janë të detyrueshme, Komisioni bën vetëm rekomandime. Komisioni i Venecias mund të analizojë dhe krahasojë tekstet e normave dhe të sugjerojë ndryshime, por ai nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi kushtet themelore që diktojnë zbatimin praktik të normave në një shtet të caktuar. Këto kushte përfshijnë mënyrën në të cilën një shoqëri tradicionalisht ballafaqohet me ligjin - për shembull, rasti i nihilizmit legal i zhvilluar gjatë një periudhe të gjatë kohore, kultura politike mbizotëruese dhe qëndrimet e palëve të interesuara (rrjedhimisht edhe ndikimi i elitave të vjetra me qëllim ruajtjen e status quo-së)⁶⁷. Vlerësimi i situatës konkrete në raport me vendin në të cilin ndodh duhet të jetë tepër i rëndësishëm dhe merret në konsideratë nga Komisioni i Venecias, për këtë ka patur edhe kritika për Komisionin. Një anëtar i Komisionit ka pranuar në vitin 2000 se *"Ndoshta Komisioni mund të ketë dhënë përshtypjen se nganjëherë opinionet e tij nuk ishin me të vërtetë të bazuara në një njohuri të plotë të gjendjes aktuale të vendit ku trajtohet rasti, por ajo që dihet se Komisioni është quajtur shpesh se jep këshilla pa ju lënë mundësinë e përfshirjes së të dhënave nga misioni fakt-mbledhës"*⁶⁸.

Shpesh ndodh që aktorët politikë si Bashkimi Evropian i bën thirrje një shteti të caktuar për të ndjekur një rekomandim që Komisioni i Venecias e ka bërë, por kjo është pjesë e diplomacisë dhe politikës ndërkombëtare dhe mbetet jashtë fushëveprimit të Komisionit, i cili është vetëm juridik. Rekomandimet e Komisionit të Venecias bazohen kryesisht tek Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe interpretimi i saj nga jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut. Gjithashtu, Komisioni i Venecias i referohet ligjit të butë siç janë rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

Madje, nga ana tjetër, edhe GJEDNJ-ja ka përdorur shpesh opinionet e Komisionit të Venecias në vendimarrjen e saj. Megjithatë, opinionet e Komisionit nuk janë ligjërish të detyrueshme dhe ato nuk mund të përdoren nga Gjykata si një burim i drejtpërdrejtë i zbatueshëm. GJEDNJ-ja ka përdorur opinionet e Komisionit si një burim informacioni, si dhe për udhëzime me karakter normativ dhe empirik. Gjithashtu është e mundur që Gjykata e përdorë këtë mënyrë për të forcuar pranimin e vendimeve të saj⁶⁹. Ndërsa, Pieter van Dijk, një ish-anëtar i GJEDNJ dhe i Komisionit të Venecias, i referohet një " rrugë dyanëshme " kur flitet për marrëdhëniet e "shartimit" në mes dy institucioneve. Sipas tij GJEDNJ-ja nuk duhet të mbështetet në Komisionin e Venecias, edhe pse vendimet e saj mund të pasurohen duke u bazuar në studimet e Komisionit. Në kontrast me këtë, Komisioni i Venecias duhet të mbështetet në jurisprudencën e GJEDNJ-së gjatë përcaktimit të standardeve minimale për shqyrtimin e normave dhe instrumenteve ligjore. Me fjalë të tjera, Komisioni i Venecias nuk mund të punojnë në mënyrë efektive pa iu referuar vendimeve të GJEDNJ. Nëse dikush

⁶⁷ [Wolfgang Hoffmann-Riem](#) “The Venice Commission of the Council of Europe – Standards and Impact” Eur J Int Law (2014) 25 (2): 579-597.

⁶⁸ S Bartole, “Final Remarks: The role of the Venice Commission” (2000) 26 Review of Central and East European Law 351, 363.

⁶⁹ [Wolfgang Hoffmann-Riem](#) “The Venice Commission of the Council of Europe – Standards and Impact” Eur J Int Law (2014) 25 (2): 579-597.

kërkon të dijë për rëndësinë e opinioneve të Komisionit në aspektin se si ato interpretohen dhe zbatohen në mënyrë të veçantë, është e qartë se GJEDNJ-ja përdor Komisionin si një burim informacioni dhe frymëzimi. Megjithatë, nuk ka asnjë tregues se Vendimet e Gjykatës do të kishin qenë ndryshe, pa punën e Komisionit. Komisioni i Venecias është vetëm një nga disa burimet e shumta të informacionit për Gjykatën. Por, në çdo rast, opinionet e Komisionit marrin vlerë, për shembull, kur shqyrtohet dhe arsyetohet në lidhje me kufizimet në shkelje të të drejtave të njeriut në bazë të parimit të proporcionalitetit. GJEDNJ gjithashtu dukshëm përdor ato për të forcuar pranimin dhe legjitimitetin e vendimeve të saj⁷⁰.

Në fusha të caktuara, Komisioni i Venecias ka identifikuar vetë standardet, për shembull në kodet e saj të njohura gjerësisht të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore apo për partitë politike. Në disa fusha, Komisioni ka përcaktuar standardet së bashku me OSBE/ODIHR, për shembull në fushën e lirisë së tubimit ose lirisë së asociimit. Megjithatë, Komisioni i Venecias i referohet edhe parimeve themelore të së drejtës kushtetuese, siç janë kontrolli dhe ekuilibri dhe shpesh thjesht arsyes së shëndoshë.

Kërkesat për opinione Komisionit të Venecias mund t'i bëhen nga autoritetet shtetërore, Presidenti i Republikës, Kuvendi, Këshilli i Ministrave dhe institucionet tjera shtetërore, përfshirë edhe gjykatat kushtetuese. Komisioni i Venecias mbështet në mënyrë aktive gjykatat kushtetuese në shtetet e saj anëtare. Sipas një prej studiuesve më të rëndësishëm të teorisë hierarkike dhe dinamike të së drejtës pozitive dhe shkencës të së drejtës kushtetuese, profesorit austriak Kelsen: "*Një Kushtetutë e cila nuk do të krijonte një gjykatë kushtetuese me kompetencë që të anulojë aktet antikushtetuese, është një dritë e cila nuk shkëlqen.*" Kështu që kërkesa e datës 7 korrik 2016 e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë mbi pajtueshmërinë e ligjit nr. 133/2015 i Republikës së Shqipërisë "Mbi trajtimin e pasurisë dhe finalizimin e procesit të kompensimit të pronave", me kërkesat e nenit 1, Protokolli nr 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe përkatëse jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, u mor në konsideratë nga ana e Komisionit.

Kur përgatitet një mendim, Komisioni i Venecias krijon gjithmonë një grup të vogël ekspertësh në mes të anëtarëve të tij, të cilët trajtojnë rastin konkret dhe quhen raportues. Kur paraqitet e nevojshme, raportuesit udhëtojnë në vendin që ka kërkuar opinionin dhe organizojnë takime dhe shkëmbejnë informacione teknike me autoritetet përkatëse, të cilët mund të jenë përfaqësues nga qeveria, nga parlamenti, nga gjyqësori, por edhe me opozitën dhe shoqërinë civile. Këto takime i japin raportuesve njohuri të vlefshme jo vetëm për diskutimin kombëtar mbi çështjet e shqyrtuara, por ato gjithashtu tregojnë cilat rrugë janë në dispozicion për kompromis dhe konsensus. Duhet theksuar se anëtarët nga vendi në fjalë nuk bëhen kurrë raportues për vendin e tyre. Ky rregull siguron që ata të mos bien nën presion për të ndikuar në një mendim për vendin e tyre. Praktikisht të gjitha mendimet janë të miratuara me konsensus, por përsëri, anëtari nga vendi në fjalë nuk mund të parandalojë një konsensus të tillë që duhet të arrihet.

Z. Auresku, z Grabenëarter dhe znj. Hermanns u caktuan raportues për përgatitjen e *amicus curiae* mbi pajtueshmërinë e ligjit nr. 133/2015 "Mbi trajtimin e pronës dhe finalizimin e procesit të kompensimit të pronave" të Republikës së Shqipërisë me kërkesat e nenit 1, Protokolli nr 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo *amicus curiae* e shkurtër u hartua mbi bazën e komenteve të raportuesve dhe u miratua nga Komisioni i Venecias në sesionin e 108 plenarë⁷¹.

⁷⁰ Pieter van Dijk, 'The Venice Commission on Certain Aspects of the European Convention of Human Rights Ratione Personae', in S. Breitenmoser et al. (eds), Human Rights, Democracy and the Rule of Law: Liber Amicorum Luzius Wildhaber (2007), fq 183.

⁷¹ Venecia, 14-15 tetor 2016

Raportuesit kishin detyrën për t'i dhënë përgjigje katër pyetjeve të Gjykatës Kushtetuese. Përgjigjet kishin të bënin më tepër me substancën e këtyre pyetjeve dhe jo domosdoshmërisht në mënyrën në të cilën ata u pyetën, kjo edhe për shkak se një pjesë e madhe e përgjigjeve për pyetjet 3 dhe 4 u përfshinë në përgjigjet e pyetjeve 1 dhe 2.

Esencë e katër pyetjeve kishte të bënte me pajtueshmërinë e ligjit nr. 133/2015 me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, i cili parashikon: "Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pronës së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Dispozitat e mësipërme, megjithatë, në asnjë mënyrë nuk çenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i konsiderojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pronave në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve të tjera, ose të gjobave."

Ky në fakt ishte vetëm një *amicus curiae* i shkurtër për Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë. Si i tillë, Komisioni i Venecias e theksoi qartë se nuk kishte marrë përsipër një qëndrim përfundimtar mbi çështjen e kushtetutshmërisë së disa dispozitave të ligjit nr. 133/2015 "Për trajtimin e pronës dhe finalizimin e procesit të kompensimit të pronave", por thjesht i ka dërguar Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, një material për pajtueshmërinë e dispozitave përkatëse me standardet evropiane, në mënyrë që të lehtësojë shqyrtimin nga ana e Gjykatës Kushtetuese të këtyre dispozitave sipas Kushtetutës së Shqipërisë.

Komisioni i Venecias që në krye të herës sqaroi se, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, është ajo që ka fjalën e fundit për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve kombëtare me këtë tekst.

Më tej Komisioni i Venecias u ndal në këto argumente:

Vendimet përfundimtare administrative apo gjyqësore, të cilat parashikojnë një sasi të caktuar të kompensimi, por që ende nuk janë ekzekutuar, në mënyrë të padiskutueshme kanë të bëjnë me një "pritje legjitime" dhe nuk do të rivlerësohet në bazë të ligjit nr. 133/2015. Në këto raste, nuk ka "ndërrhyrje" brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, për sa kohë që këto vendime do të zbatohen në mënyrë të rregullt. Për sa i përket vendimeve që përcaktojnë kthimin ose kompensimin vetëm në sipërfaqe dhe jo në vlerë financiare, nuk është e qartë nëse sa larg shkon një pritshmëri legjitime.

Mënyra për të përcaktuar nëse janë apo jo të tilla "pritjet legjitime", GJEDNJ-ja nuk e konsideron një pretendim të argumentueshëm, si kriter, por kërkon që padia të ketë një bazë të mjaftueshme në ligjin kombëtar. Thjeshtë shpresa e sigurimit të një aktivi nuk është e mjaftueshme për të krijuar pasurinë brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit Nr.1 të KEDNJ. Kështu, ekzistenca e thjeshtë e shpresës se një pretendim mund të pranohet në një rast në pritje nuk shkakton "pritjet legjitime"⁷².

Një kërkesë për kthimin e pronës mund të sjellin "pritjet legjitime"⁷³. Pritjet legjitime të mbrojtura nga neni 1 i protokollit nr.1 konsiderohen, në mënyrë të veçantë, kur një Shtet, pas kalimit nga një sistem socialist në atë të ekonomisë së tregut, miraton legjislacionin për pretendimet që kanë të bëjnë me kthimin ose kompensimin të pronave⁷⁴. Kjo është për shkak se, sipas GJEDNJ, "Neni 1 i Protokollit 1 nuk mund të interpretohet si vendosje e ndonjë detyrim të përgjithshëm mbi Shtetet Kontraktuese për të kthyer pronën e cila ishte transferuar atyre para se ata të ratifikonin Konventën"⁷⁵, por, "kur një Shtet Kontraktues, që ka ratifikuar Konventën, duke përfshirë Protokollin Nr 1, miraton legjislacionin që siguron kthimin e plotë apo të pjesshëm të pronës së konfiskuar nën regjimin e mëparshëm, një legjislacion i tillë

⁷² GJEDNJ 13.12.2000 (GC), Nr. 33071/96, Malhous/Czech Republic.

⁷³ EComHR 16.4.1998, No. 37912/97, Gospodinova/Bulgaria.

⁷⁴ GJEDNJ 28.9.2004 (GC), Nr. 44912/98, Kopecký/Slovakia, § 38.

⁷⁵ Maria Atanasiu and Others v. Romania, op. cit., §135.

mund të konsiderohet që gjeneron një të drejtë të re pronësie të mbrojtur nga neni 1 i Protokollit Nr 1 "⁷⁶

Megjithëse, Ligji nr. 133/2015 ndryshoi metodën e vlerësimit dhe skemën e kompensimit, e cila mund të çojë në kompensim më të ulët. Edhe në qoftë se kompensimi është më i ulët nuk mund të kualifikohet si shpronësim formal, por mund të kualifikohet si "ndërhyrje të tjera" sipas nenit 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ. Kjo ndërhyrje, megjithatë, ka një bazë të qartë ligjore në ligjin nr. 133/2015, prandaj nuk duket të ketë një bazë mjaft të qartë dhe e detajuar ligjore për ndërhyrjen në fjalë. Raporti shpjegues i ligjit nr. 133/2015 argumenton se një skemë përfundimtare e kompensimit, e cila mund të aktivizojë "pritjet legjitime" për një sasi të caktuar të kompensimit, nuk ka qenë e hartuar ndonjëherë. Subjektet që nuk kanë marrë ende një vendim përfundimtar nga një organ administrativ ose gjykata që njeh të drejtën e kthimit ose kompensimit, qeveria shqiptare i referohet rastit të *Bici kundra Shqipërisë*⁷⁷ për të justifikuar se këta subjekte nuk zotërojnë pronën dhe as që kanë krijuar pritshmëri legjitime përderisa e drejta e tyre nuk është e njohur në nivel lokal.

Ndërhyrja gjithashtu duket të ndjekë një qëllim legjitim, si qëllim i Ligjit nr. 133/2015 është që në mënyrë efektive të finalizojë procesin e trajtimit të pronës me anë të njohjes dhe kompensimit. Vendosur në sfondin e problemeve të ndryshme në lidhje me përfundimin efektiv procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave në Shqipëri, qëllimet e Ligjit nr. 133/2015 gjithashtu duket të jenë në përputhje me interesin publik brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ. Ndërhyrja është proporcionale nëse fondi financiar prej 50 miliardë lekë sipas skemës së kompensimit për një periudhë prej 10 vjetësh është përcaktuar me kujdes në dritën e buxhetit të shtetit në tërësi dhe PBB-së.

Sipas ligjit, vendimet përfundimtare administrative apo gjyqësore që parashikojnë një sasi të caktuar të kompensimit që do të jepet, por nuk janë zbatuar ende, nuk do të rivlerësohen. Prandaj, sipas Komisionit, edhe pse në këto raste ka pa diskutim një "pritshmëri legjitime", nuk ka "ndërhyrje" brenda kuptimit të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, për sa kohë që këto vendime do të zbatohen në mënyrë të rregullt. Në këtë kontekst, sipas GJEDNJ-ja mungesa e fondeve apo burimeve të tjera nuk mund të jetë një arsye për vendin që të mos respektojë detyrimin e saj sipas KEDNJ-së për të siguruar pajtueshmërinë me një vendim të formës së prerë brenda një kohe të arsyeshme.⁷⁸

Sipas Komisionit në situatën specifike të Shqipërisë, mund të thuhet se një kornizë e re dhe efektive ligjore sigurohet nga ligji nr.133 /2015, e cila mund të çojë në një sasi më të ulët të kompensimit të paguar për ish-pronarëve, por i përmbush kërkesat e proporcionalitetit të përcaktuar në nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ. Në mënyrë të veçantë, duket e arsyeshme se Ligji nr. 133/2015 i referohet kategorizimin të pronës kadastrale bazuar në kohën e shpronësimit, pa u konsideruar si një disproporcion ekstrem mes vlerës zyrtare kadastrale të tokës dhe kompensimit të paguar për ish-pronarët.

Elementet e mësipërme u vlerësuan nga Komisioni i Venecias si të destinuara për të ndihmuar Gjykatën Kushtetuese të bëjë një vlerësim abstrakt të ligjit. Megjithatë, Komisioni theksoi se çështja nëse kompensimi për pronën e shpronësuar në Shqipëri plotëson kërkesat e nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, në fund të fundit do të varet zbatimin efektiv i ligjit nr. 133/2015 dhe ekzekutimi i tij nga autoritetet kombëtare. Ajo do të jetë detyrë e autoriteteve shqiptare për të siguruar që qëllimet e Ligjit nr.133 / 2015 nuk mbeten teorike.

- Vendimarrja përfundimtare e Gjykatës Kushtetuese

⁷⁶ Ibidem, §136.

⁷⁷ Bici v. Albania, nr. 5250/07, §§ 49 – 52, 3 dhjetor 2015.

⁷⁸ Manushaqe Puto and Others v. Albania, op. cit., §96

Pas ardhjes së opinionit të Komisionit të Venecias, Gjykata Kushtetuese shqyrtoi këtë rast dhe doli me vendim nr. 1 datë 16.01.2017, i cili në të gjithë pjesën e tij arsyetuese referonte thujtse totalisht tek opinionin e Komisionit të Venecias. Mjafton që të përmendesh një fakt krejt të thjeshtë që Komisioni i Venecias është cituar plot nëntë herë në këtë vendim, duke përfshirë argumentet kryesore si më poshtë:

1. Gjykata vlerësoi se ka një interes publik, i cili duhet të vlerësohet si i rëndësishëm deri në atë masë sa të justifikojë ndërhyrjen e ligjvënësist. Referuar edhe opinionit amicus curia të Komisionit të Venecias, Shtetet gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi në përcaktimin e asaj çka është në interesin e publikut, veçanërisht për sa i takon nenin 1 të Protokollit nr.1 dhe gjatë implementimit të politikave sociale dhe ekonomike. Ajo çka nuk përmbush kërkesat e interesit publik është vetëm privimi i pronësisë që është haptazi i pabazuar. GJEDNJ-ja pranon se “për shkak të njohjes së saktë të shoqërive të tyre dhe nevojave që ato kanë, në parim autoritetet kombëtare mund ta vlerësojnë më mirë sesa gjyqtari ndërkombëtar atë çka është “në interes të publikut” [...]. Për këtë arsye, u takon autoriteteve kombëtare të bëjnë vlerësimin fillestar lidhur me ekzistencën e një problemi që shqetëson publikun, duke garantuar marrjen e masave që do të zbatohen në fushën e ushtrimit të së drejtës së pronësisë, duke përfshirë privimin dhe kthimin e pronës. Këtu [...] autoritetet kombëtare gëzojnë respektivisht një hapësirë të caktuar vlerësimi.”⁷⁹.
2. Po kështu Gjykata, referuar edhe qëndrimit doktrinar të shprehur në opinionet e dhëna nga Komisioni i Venecias për këtë çështje, vlerësoi se nuk mund të vendosen detyrime për kompensimin tërësor të pronës së shpronësuar apo të shtetëzuar nga regjimet që nuk kanë respektuar standardet minimale të të drejtave të njeriut dhe se rivendosja e plotë e të drejtave të mëparshme të pronësisë do të ishte në kundërshtim me vet parimin e barazisë⁸⁰.
3. Gjithashtu, Gjykata vlerësoi se edhe në opinionin për vlerësimin e ligjit nr.133/2015, bazuar në kërkesën e paraqitur për amicus curia nga Gjykata, Komisioni i Venecias është shprehur: “... duke marrë parasysh situatën specifike të Shqipërisë, mund të argumentohet se kuadri ligjor i ri dhe efektiv i parashikuar nga ligji nr.133/2015, i cili mund të rezultojë në një masë më të ulët kompensimi për ish-pronarët, gjithsesi i plotëson kërkesat e proporcionalitetit të parashikuara në nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së. Në mënyrë më specifike, duket e arsyeshme që ligji nr.133/2015 i referohet kategorizimit kadastral të pronës në kohën e shpronësimit pa u konsideruar kjo gjë si një disproporcion ekstrem midis vlerës kadastrale zyrtare të tokës dhe kompensimit të ish-pronarëve”⁸¹.
4. Gjykata vlerësoi se për sa u përket dispozitave të tjera të kundërshtuara prej kërkuësve, ato parashikojnë, forma të ndryshme të kompensimit, të cilat synojnë të

⁷⁹ Shih: Vendimin nr. 1 datë 16.01.2017 (V-1/17) të Gjykatës Kushtetuese dhe opinionin e Komisionit të Venecias miratuar në Seancën e 108-të Plenare Venecia, 14-15 Tetor 2016.

⁸⁰ Shih: Vendimin nr. 1 datë 16.01.2017 (V-1/17) të Gjykatës Kushtetuese dhe opinionin e Komisionit të Venecias miratuar në Seancën e 108-të Plenare Venecia, 14-15 Tetor 2016.

⁸¹ Shih: Vendimin nr. 1 datë 16.01.2017 (V-1/17) të Gjykatës Kushtetuese dhe opinionin e Komisionit të Venecias miratuar në Seancën e 108-të Plenare Venecia, 14-15 Tetor 2016.

vendosin një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave të ndryshëm. Referuar përsëri opinionit amicus curia për këtë çështje, Komisioni i Venecias ka vlerësuar se për sa u përket vendimeve që përcaktojnë kthimin apo kompensimin vetëm me sipërfaqe dhe jo me vlerë monetare, nuk është e qartë se deri në çfarë mase ngrihet çështja e pritshmërisë legjitime. Relacioni shpjegues i ligjit nr.133/2015 argumenton se nuk është hartuar asnjëherë ndonjë skemë përfundimtare kompensimi, me një shifër konkrete kompensimi, e cila do të krijonte një “pritshmëri legjitime”. Për sa u përket individëve që ende nuk kanë marrë një vendim të formës së prerë nga organet administrative apo gjyqësore, i cili u njeh atyre të drejtën e kthimit apo kompensimit të pronës, qeveria shqiptare i referohet çështjes Bici kundër Shqipërisë për të justifikuar se këta individë apo entitete nuk janë pronarë dhe nuk kanë krijuar pritshmëri legjitime, pasi e drejta e tyre nuk është njohur në nivel kombëtar.

5. Gjykata vlerësoi se në situatën specifike të Shqipërisë mund të argumentohet se kuadri ligjor i ri dhe efektiv i parashikuar nga ligji nr.133/2015, i cili mund të rezultojë në një masë më të ulët kompensimi që u paguhet ish-pronarëve, gjithsesi i plotëson kërkesat e proporcionalitetit të përcaktuara në nenin 1 të Protokollit nr.1 të GJEDNJ. Në mënyrë më specifike, duket e arsyeshme që ligji nr.133/2015 i referohet kategorizimit kadastral të pronës në kohën e shpronësimit pa u konsideruar kjo gjë si një disproporcion ekstrem midis vlerës kadastrale zyrtare të tokës dhe kompensimit të paguar për ish-pronarët sipas opinionit të Komisionit të Venecias⁸².
6. Nisur nga analiza e Komisionit të Venecias, Gjykata vlerësoi se ligji objekt shqyrtimi pavarësisht se parashikon një metodologji të re vlerësimi për kompensimin fizik dhe financiar të ish pronarëve, e cila megjithëse rezulton në ndërhyrje në të drejtën e pronës dhe mund të mos u përgjigjet pritshmërive të subjekteve që prek ligji, rezulton se në tërësinë e tij respekton proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e kompensimit të pronës ish pronarëve dhe si e tillë është në respektim të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së⁸³.

Nisur nga argumentet e mësipërme të trajtuara *idem* edhe nga opinionin e Komisionit të Venecias, Gjykata Kushtetuese refuzoi të gjitha kërkesat që kishin të bënin me shfuqizimin e ligjit si antikushtetues, përveç nenit 6 në pikën 3 i cili parashikonte: “Në rastet kur subjektet e shpronësuara kanë përfituar me vendim kthimi dhe kompensimi, diferenca e llogaritur, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, zbritet nga vlerësimi i pronës së njohur për kompensim e llogaritur sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni”. Ndërsa pika 5 e ligjit parashikon: “Në rast se ATP-ja merr vendim për njohje dhe kompensim fizik në pronën e subjektit, prona vlerësohet sipas pikës 1 të këtij neni. Kur nga ky vlerësim rezulton se subjekti përfiton një pronë që ka vlerë më të lartë sesa prona që ka pasur në momentin e shpronësimit, atëherë subjektit i kompensohet fizikisht sipërfaqja që i korrespondon vlerësimit dhe pjesa tjetër e pronës kalon në fondin e tokës me vendim të ATP-së.”

Gjykata vlerësoi se këto dy pika, sipas përmbajtjes së tyre, të çojnë në përfundimin se ato janë konceptuar si një shpronësim i ri duke qenë se parashikojnë rivlerësimin e pronave të

⁸² Shih: Vendimin nr. 1 datë 16.01.2017 (V-1/17) të Gjykatës Kushtetuese dhe opinionin e Komisionit të Venecias miratuar në Seancën e 108-të Plenare Venecia, 14-15 Tetor 2016, fq 44.

⁸³ Shih: Vendimin nr. 1 datë 16.01.2017 (V-1/17) të Gjykatës Kushtetuese dhe opinionin e Komisionit të Venecias miratuar në Seancën e 108-të Plenare Venecia, 14-15 Tetor 2016.

kthyerë ose të kompensuara më parë. Në këtë këndvështrim, këto dy dispozita krijojnë probleme lidhur me sigurinë juridike konkretisht përsa i takon paqartësisë dhe paparashikueshmërisë së legjislacionit dhe si rrjedhojë vendosi shfuqizimin si antikushtetues të nenit 6, pika 3 dhe 5, të ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.

Në këtë linjë interesant paraqitet edhe fakti se dy anëtarë të kësaj gjykate që votuan pro kërkesës për të shfuqizuar ligjin si antikushtetues dhe dolën në mendim pakice, në arsyetimin e qëndrimit, në asnjë moment nuk i janë referuar opinionit të Komisionit të Venecias në argumentet e tyre kundër këtij ligji. Në këtë rast duket se anëtarët e Gjykatës Kushtetuese janë ndarë sa i takon referimit në opinionin e Komisionit të Venecias, megjithëse kishte një kërkesë zyrtare që i drejtohej këtij institucioni për diçka të tillë nga ana e Gjykatës. Pra në një farë mënyre kjo provon arsyetimin e theksuar më sipër, se nëse përdorej opinionin e Komisionit të Venecias, ai nuk linte shumë vend për interpretim dhe Gjykatës Kushtetuese i mbetej një vendimarrje “noteri”.

KONKLUSIONE

Opinionin e Komisionit të Venecias, siç konstatohet në gjithë arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese pati ndikim të drejtëpërdrejtë në vendimarrjen e saj. Kjo gjë pritej dhe vështirë se mund të ndodhte ndryshe, përderisa edhe pyetjet që iu shtruan Komisionit të Venecias nga ana e saj ishin shumë shteruese sa i takon objektit të çështjes që do të shqyrtohej para saj. Gjykata në këtë rast realizoi një vendimarrje të “noterit” dhe thjesht priti sa të shprehej Komisioni i Venecias.

Kjo gjë mund të cilësohet një praktikë e cila shmangu deri diku presionin politik dhe paragjykimin për një vendimarrje me ngjyrimë politike nga anëtarët e Gjykatës. Nga ana tjetër një praktikë e tillë dhe diskursi politik që shoqëroi gjithë procesin evidenton qartë se edhe ky institucion i pavarur kushtetues i një rëndësie të veçantë, të cilit i takon fjala e fundit në interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, e gjen të vështirë në raste të caktuara t'i shmanget ndikimit të politikës dhe të jetë e besueshme për opinionin në terësi për vendimarrjet e saj. Në të tilla raste kur debati politik është i ndezur është gjetur si zgjidhje nga Gjykata drejtimi për opinionin tek Komisioni i Venecias. E njëjta procedurë u ndoq edhe sa i takon ligjit të “vetting-ut”⁸⁴. Në rastin kur Gjykata i drejtohet thjesht për çështje teknike apo ekspertize të caktuar juridike, për të cilën nuk ka mundësitë dhe kapacitet për t'i njohur në thellësi, sidomos sa i takon qëndrimeve në raport me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kjo është një praktikë mjaft pozitive. Por kur kjo praktikë përdoret në kushtet e presioneve politike apo të preceptimeve që anëtarët e Gjykatës kanë ndikime politike paracaktuara, ky është një tregues jo pozitiv për këtë institucion dhe për vetë sistemin juridik në tërësinë e tij. Praktika e pyetjeve shteruese që i drejtohen Komisionit të Venecias në lidhje me një ligj të brendshëm, shton dyshimet se me tepër se një zgjidhje tekniko-juridike Gjykata ofron një zgjidhje pragmatiste duke larë duart në një farë mënyre nga përgjegjësia e ushtrimit të vendimarrjes së drejtëpërdrejtë nga ana e saj.

Gjykata Kushtetuese duhet të mbështetet në mënyrë direkte në jurisprudencën e GJEDNJ-së gjatë përcaktimit të standardeve minimale për shqyrtimin e normave dhe instrumenteve ligjore të brendshme. Rëndësia e opinioneve të Komisionit nuk duhet të vihet asnjëherë në diskutim si një burim informacioni dhe frymëzimi për Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk duhet të përcaktohen totalisht nga opinione të tilla.

⁸⁴ Ligjin Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i njohur si ligji i “Vetting-ut”.

Komisioni i Venecias duhet të jetë vetëm një nga disa burimet e shumta të informacionit për Gjykatën Kushtetuese.

Literatura:

Doktrinë

- Pietre van Dijk, ‘The Venice Commission on Certain Aspects of the European Convention of Human Rights Ratione Personae’, in S. Breitenmoser et al. (eds), Human Rights, Democracy and the Rule of Law: Liber Amicorum Luzius Wildhaber (2007).
- S Bartole, “Final Remarks: The role of the Venice Commission” (2000) 26 Review of Central and East European Laë.
- Temistocle Martines, Diritto Costituzionale - Decima edizione interamente riveduta da Gaetano Silvestri, 2000..
- [Wolfgang Hoffmann-Riem](#) “The Venice Commission of the Council of Europe – Standards and Impact” Eur J Int Law (2014) 25 (2).

Dokumente; akte ligjore dhe normative:

- Opinioni i Komisionit të Venecias miratuar në Seancën e 108-të Plenare Venecia, 14-15 Tetor 2016.
- Relacioni për projektligjin “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”
- Ligji nr. 133/2015 "Mbi trajtimin e pronës dhe finalizimin e procesit të kompensimit të pronave"
- Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 9377, dt.29.12.2015 “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend ligjin nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.

Jurisprudencë

- Vendimi nr. 1 datë 16.01.2017 (V-1/17) i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë
- GJEDNJ 26.6.1986, Nr. 8543/79 and others, Van Marle/Netherlands, § 41.
- GJEDNJ 9.12.1994, Nr. 13427/87, Stran Greek Refineries/Greece, § 59 sq.
- GJEDNJ 28.9.2004 (GC), Nr. 44912/98, Kopecký/Slovakia, § 35.
- GJEDNJ Manushaqe Puto and Others v. Albania, op. cit., §96
- GJEDNJ Bici v. Albania, nr. 5250/07, §§ 49 – 52, 3 dhjetor 2015.
- GJEDNJ EComHR 16.4.1998, Nr. 37912/97, Gospodinova/Bulgaria.
- GJEDNJ ECtHR 28.9.2004 (GC), Nr. 44912/98, Kopecký/Slovakia, § 38.
- GJEDNJ Maria Atanasiu and Others v. Romania, op. cit., §135.

6. Shoqëria Civile dhe Interferimet e saja në Funksonimin e Shtetit Demokratik

Hajrullah Mustafa

- ABSTRAKT-

Ne një kuptim të përgjithshëm, shoqëria civile kuptohet si një veprimtari e gjërë shoqërore, me karakter vullnetar, jo të detyrueshën nga shteti dhe institucionet e tij. Konceptohet si një dimension ku vepron shumë elementet e grupimeve dhe organizimeve qytetare si shoqatat, bashkimet ose forumet tjara, të cilat kanë për bazë trajtimin e problemeve me esenciale siq janë: problemet politike, sociale, të familjes, të besimit, të edukimit, arsimimit, kultures etj.

Pra përfaqëson një hapsirë shumë të gjërë të veprimit qytetarë të pavarur nga institucionet politike zyrtare. Në këtë kuptim, nocioni "Shoqëri civile" percepton ide pozitive dhe mundësitë e pafundshme që posedojnë qytetarët për të realizuar projektet e tyre, dhe për të implementuar dhe realizuar synimet e tyre, duke zhvilluar iniciativa individuale por edhe duke zgjeruar hapsirën e veprimit të lirë.

Me të drejtë studjuesi, **Charles Bahmuller** shpreh se "Shoqëria Civile" është i gjithë rrjeti i marrëdhënjëve sociale spontane që shtrihet jashtë institucioneve të sistemit politik dhe obligimeve legale. Bile edhe shkalla e lirisë së një shoqërie shpesh vlerësohet pikërisht edhe nga shkalla e zhvillimit dhe veprimtarisë së shoqërisë civile perkatese.

Shoqëria civile pra ka një rol të rëndësishëm në një shtet demokratik, sepse nga niveli dhe zhvillimi i saj në masë të madhe mëvaret edhe zhvillimi i interesit të shoqërisë.

Shoqatat dhe organizimet e shoqërisë civile në vendet me demokraci të zhvilluar, gjithsesi luajnë rolin e mediatorit (ndërmjetësit) në mes individit dhe shtetit. Prandaj, këtu qëndron edhe roli dhe rëndësia që ka shoqëria civile në funksionimin e shtetit demokratik, sepse në sistemet totalitare, shteti eliminon shoqërinë civile përmes një kontrolli total të çdo grupimi social, duke u ngritur kundër formave të lira të shprehjes dhe organizimeve.

Fjalë Kyçe: shoqëria civile, shteti, demokracia, shoqatat, OJQ.

Autori është mësues në Kolegjin Europian të Kosovës në Prishtinë

Hyrje

Sot, në teorinë bashkëkohore, gjithnjë e më shumë me nocionin e shtetit nënkuptohet shteti ligjor dhe modern, **i bazuar në qeverisjen e s'drejtës dhe funksionimin e institucioneve demokratike politike.**

Në ndërtimin dhe funksionimin e shtetit modern, demokratik, ekzistojnë një numër i madh faktorësh të cilët dallohen përka ndikimit të tyre në veprimtarinë politike shtetërore bile është edhe vështirë të bëhet ndarja e tyre.

Shkenca politike dhe teoria mbi shtetin identifikojnë disa nga faktorët ndikimi të cilëve është jo vetëm i drejtpërdrejtë por edhe determinojnë veprimtarinë politike të shtetit modern. Në grupin e faktorëve që shtrijnë ndikimin e vetë në ndërtimin dhe funksionimin e shtetit ligjor e demokratik duhet veqar edhe rolin dhe ndikimin që ka Shoqëria civile në funksionimin e shtetit demokratik.

Prandaj, vëmendja ime do të jetë e përqendruar pikërisht tek ky faktor i rëndësishëm në ndërtimin dhe funksionimin e shtetit modern, duke elaboruar konceptin dhe domethenjen e shoqërisë civile, pastaj, interferimit të shoqërisë civile në funksionimin e shtetit demokratik, dhe disa nga sfidat e funksionimit të shoqërisë civile në realitetin politik të Republikës së Kosovës.

Gjatë tërë zhvillimit historik të shoqërisë njerëzore, në mesin e mendimeve dhe filozofive gjithëherë shoqëria civile, ishte në qendër të vëmendjes, çështje kjo që ka shtruar shumë

mendime, duke filluar qe nga nocioni, por edhe deri tek roli dhe ndikimi qe ka edhe sot ne ndertimin dhe funksionimi e shtetit modern dhe demokratik.

Koncreti “shoqeri civile” është debatuar pothuajse gjate tërë historise, duke filluar qe nga Aristoteli i cili nocionin “civile” e mendonte si nje domethenje te “shtetit”, perkatesisht si nje reference e nderveprimeve kolektive te personit me shtetin si qytetar i polisit te asaj kohe.

Edhe tek mendimtaret e kohes së re, por edhe shume më vone, në kuader mardhenjeve dhe antagonizmave te kohes shtroheshin shume diskurse se si duhej te organizohet shoqeria, si eshte e mundur qe individet, me interesa, pretendime, ambicie, individuale shoqerohen dhe jetojn ne nje shoqeri, perkatesisht shtet qe iu imponon norma, ligje, urdhera dhe obligime, duke i gjveshur ata nga bindjet, teket, deshirat dhe ambiciet e tyre. Në një forme ose tjeter si do te mund te gjindet nje kompromise ne mese te asaj qe do te donin te benin dhe asaj qe jane te detyruar te bejn si anëtar të shoqerisë përkatese.

1. Nocioni dhe Kuptimi i Shoqerise Civile

Përgjithesisht është pranuar se termi “Shoqeri Civile” në përmbajtjen e vet i referohet një veprimtarie te gjere shoqerore me karakter vullnetar, jo te detyruar nga shteti dhe institucionet e tij. Me fjale te tjera shoqeria civile kuptohet si nje dimension ku veprojn elementet e tille te grupimeve qytetare si: shoqatat; bashkimet rrjetet, apo asociacionet te cilat kane ne themel trajtimin e problemeve sociale, te familjes, te besimit etj. qe do te thote se perfshijn nje hapsire te gjere te veprimit qytetar te pavarur nga institucionet politike zyrtare. Pikerisht ketu qendron, kuptimi, roli dhe besimi qe ka shoqeria civile tek masa e gjere qytetare. Prandaj, te besosh ne shoqerine civile ne nje vend demokratik do te thote te besosh ne aftesine e individeve dhe grupimeve te ndrysheme per te organizuar veprimtarine e tyre, per te arritur ne perfundimet qe ata i gjejkojn si te verteta dhe te drejta.

Në këtë kontekst shoqëria civile del si një mekanizëm psikologjik qe në njërën anë ndihmon se si një shoqëri e caktuar në të vërtetë te funksionoj, duke dalluar dukshem nga trajtat tjera alternative të organizimit shoqëror, dhe në anën tjetër po kjo shoqëri civile krijon një projektion ideal rreth konkretizimit dhe qartësimit të rregullave dhe normave shoqerore në sisteme demokratike dhe aty ku funksionon dhe ndertohet jeta e gjere pluraliste.

Në një ose forme tjeter shoqëria civile, mund të kontrolloj edhe shtetin, të kundërshtoj madje edhe ta rrëzoj qeverinë nga pushteti ashtu siç ka ndodhë gjatë historisë me shumë qeveri dhe ne shume vende, e veqanarisht ne Europen Qendrore dhe Lindore ne fund te viteve 1980 dhe fillim i viteve 1990. Shumë lëvizje aktuale të kësaj kohe, te vendeve te ndrysheme si levizja Solidarnost ne Poloni, Revoluconi i Purpurt ne Çekosllovakia, vazhduar më pastaj me Perestrojkën e Gorbaçovit apo rrëzimi i “Murit të Berlinit”, shoqëria civile ka pasur një rol me rëndësi, sepse konsiderohet një goditje e fortë për komunizmin, si dhe themel i filleve te ndertimit te nje sistemi shoqeror te pluralizmit demokratik. Sepse, gjithëhere kur flitet per nocionin “shoqeri civile” mendohet per nje grup apo grupime te shumta shoqerore, organizata apo rrjete te ndrysheme medime te lira e tj. te cilat veprojn dhe funksionojnë per te aritur objektivat e tyre per nje shoqeri funksionale dhe demokratike. Keto levizjepaten jehone edhe ne vendet tjera, duke perfshir dhe ish Jugosllavine, e gjithesesi edhe ne Kosove, ku filozofia dhe baza e ketyre ishte e lidhur me nocionet e autonomise, dhe veteorganizimit, me nismat nga baza per dhenie te mendimeve alternative dhe kritike.

Sipas fjalorit politik të Oxfordit shoqëria civile është “e përcaktuar si një sërë bashkimesh të ndërmjetme që nuk janë as shteti familja (e zgjeruar). Shoqëria civile përfshinë shoqata vullnetare, ndërmarrje dhe bashkime tjera”, (Mc Lean Iain, 2001, 564).

Kështu, në këtë kontekst qëllimi ynë nuk është që të merremi vetëm me nocionin e shoqërisë civile, por të reflektojmë mbi atë se cili është roli i saj dhe interferimet e saj në zhvillimin dhe funksionimin e shtetit demokratik.

2. Roli dhe Funksionet e Shoqërisë Civile në Zhvillimin Demokratik të Shtetit

Derisa në shtetet moniste dhe centraliste, roli i shoqërisë civile është shumë i kufizuar, sepse shteti me fuqinë e vetë vazhdimisht tenton të shuajë autonominë, e organizimit të shoqërisë civile. Praktika ka treguar se ndarja dhe kontradikta midis shtetit dhe shoqërisë, gjithësesi ishte ngritje e rolit dhe pozicionit të shoqërisë civile. Dështimet e politikave të dirigjimit shtetëror të etatizmit, kriza e “shtetit të mireqenjes”, përgjithësisht shmangesisa dhe deformimet e “organizimit shtetëror të shoqërisë”, padyshim i kontribuan afirmimit dhe ngritjes së rolit të shoqërisë civile.

Demokracia edhe pse në kuptimin e saj etimologjik “sundim apo qeverisja nga populli”, ka disa shtylla fundamentale të saj, ndër të cilat janë edhe shoqëria civile dhe mediat që këto të dyja janë të ndërlidhura njëra me tjetrën. Në shumicën e rasteve, mevarsisht nga niveli, dhe funksionimi i shoqërisë civile dhe mediave të pavarura, meveret dhe të zhvillimi demokratik i shoqërisë perkatese. Hapi më i rëndësishëm bile edhe vendimtar për zhvillimin e demokracisë është përcaktimi i qartë i ndarjes së shtetit nga shoqëria, duke krijuar hapsirë sociale dhe psikologjike në të cilën individët vetëm s’bashku me të tjerët mund të realizojnë, e të gjejnë veprimet e zyrtareve publikë, perkatesisht të zyrtareve vendim- marrës publikë, gjithëherë duke perceptuar me një veshtrim kritik, e përmbytësor, dhe të bazuar në opinionin e gjere publik dhe zerin e qytetareve. Sepse, në rolet paresore të shoqërisë cile është përfshirja dhe integrimi i individit në grupet sociale, duke krijuar mundësi dhe hapsirë të gjere veprimi dhe bashkëpunimi individ-individ dhe individ-grup, duke u angazhuar dhe ndikuar dukshëm në përfshirjen paqësore të tyre në jetën normale, gjithëherë duke ruajtur dhe respektuar identitetin dhe dinjitetin e tyre. Funksioni dhe veprimtaria e shoqërisë civile, në shtetin demokratik, kundër atyre që quhen pamje të errta të shoqërisë padyshim se paqartë një rol dhe funksion tjetër me rëndësi të veçantë, sepse praktika ka treguar se shoqëria civile luan rol të pazavendesuar në zbatimin dhe avansimin e lirisë dhe të drejtave të njeriut, sigurimin e paqes, zhdukjen dhe eliminimin e dhunës, kriminalitetit dhe silljeve tjera devijante në shoqëri, sigurimin e rendit publik, stabilitetin ekonomik, zhdukjen e varfërisë, ngritjen e mireqenjes sociale, sigurimin kombëtar etj. parime dhe attribute këto esenciale për një shtet modern demokratik.

Për realizimin praktik të këtyre attributeve demokratike, gjithëherë, kërkohej edukim dhe formimi i brezave të rinjë me idetë dhe praktikën e qytetëruara, përmesë edukimit dhe forcimit të vlerave demokratike thelbësore, siq janë afirmimi i pluralizmit, respektit dhe tolerancës, ndërnjerezore. Prandaj, me të drejtë themi se shoqëria civile vërtet konsiderohet si njëra prej shtyllave të “data bazës” në zhvillimin dhe funksionimin e shtetit demokratik.

3. Disa refleksione mbi Rolin e Shoqërisë Civile në Republikën e Kosovës

Në Kosovë, fillet e shoqërisë civile kanë burimin tek zhvillimet politike në ish Jugosllavi, në fund viteve ’80, kur kriza politike shkaktoj shfuqizimin e autonomisë së Kosovës, nga Beogradi, në vitin 1989, dhe kur represioni i pushtetit serb mbi popullatën shqiptare ushtrohej në mënyrën më të ashpër, dhe në gjitha sferat e jetës. Prandaj, “Derisa regjimi serb kishte krijuar monopolin e vet mbi strukturën e shtetit, shqiptarët e Kosovës iu kundërvyen kësaj me vetëorganizimin e tyre dhe me aktivitetet vetanake (Clark.H.2000, 95). Kjo padyshim argumenton kuptimin e plotë, esencën dhe rëndësinë që ka shoqëria civile sepse përfshinë thellë idetë pozitive të mundësive të pafundme që kanë njerzit për të realizuar projektet e tyre për të arritur synimet e tyre, për të zhvilluar iniciativën individuale e për të zgjeruar hapësirat e lirisë.

thelbesore, siq jane afirmimi i pluralizmit, respektit dhe tolerances, ndernjerezore. Prandaj, me te drejte themi se shoqeria civile vertet konsiderohet si njera prej shtyllave te "data bases" ne zhvillimin dhe funksionimin e shtetit demokratik.

3. Disa refleksione mbi Rolin e Shoqerise Civile ne Republiken e Kosoves

Ne Kosove, fillet e shoqerise civile kane burimin tek zhvillimet politike ne ish Jugosllavi, ne fund viteve '80, kur kriza politike shkaktoj shfuqizimin e autonomise se Kosoves, nga Beogradi, ne vitin 1989, dhe kur represioni i pushtetit serb mbi popullaten shqiptare ushtrohej ne menyren me te ashper, dhe ne gjitha sferat e jetes. Prandaj, "Derisa regjimi serb kishte krijuar monopolin e vet mbi strukturen e shtetit, shqiptaret e Kosoves iu kundervyen kesaj me veteorganizimin e tyre dhe me aktivitetet vetanake" (Clark.H.2000, 95). Kjo padyshim argumenton kuptimin e plote, esencen dhe rendesin qe ka shoqeria civile sepse perfshine thelle idene pozitive te mundesive te pafundeme qe kane njerzit per te realizuar projektet e tyre per te arritur synimet e tyre, per te zhvilluar iniciativen individuale e per te zgjeruar hapesirate e lirise. Duke u ballafaquar me sfida te veta zhvillimore, shoqëria civile do te ndihmoj Kosovës ne rrjedhat e mevoneshme, sepse si "sektor I trete" i shkathët dhe me besim ne vete, është thelbësor për funksionimin e demokracisë së shëndoshë. "Shoqëria civile e Kosovës ka lindur në erën e represionit dhe te kundërshtive. Ajo u pavarua njëkohsisht me krijimin e institucioneve paralele nga shqiptarët e Kosovës pasi qe Jugosllavia ia mori statusin e autonomis ish-krahines se atehershme ne vitin 1989. Me kete rast shoqeria civile mori nje game te gjerë te kompetencave, duke filluar nga të drejtat e njeriut e deri te kujdesi shëndëtsor dhe zbutja e varfërisë. Pas konfliktit te armatosur te vitit 1999, ne kuadër të Administrimit të Kombeve te Bashkara, Kosova perjetoi një dhënie te shpejt të ndihmesës. Dhe organizata vendore u themeluan per te punuar ne donatorët e huaj ne nje vaster pothuajse te pakufishme te projekteve. Kohëve te fundit, posaqërisht pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë në shkurt të vitit 2008, donatorët po drejtojnë fondet e veta më shumë për qeverinë e më pak për shoqërinë civile. Andaj, mjedisi ku Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) duhet të punojnë, dhe sfidat me të cilat ato ballafaqohen, prapë janë duke ndryshuar, duke kërkuar shkathësi dhe qëndrimet të reja. OSHC-të kanë filluar procesin e transformimit në disa mënyra, duke filluar nga hartimi i kodeve të mirësjelljes e deri te kërkimi i mënyrave për të përmirësuar bashkëpunimin me njëra –tjetrën dhe me qeverinë" (Shoqeria Civile & Zhvillimi 2008, 11). Ndonese ne shumicen e rasteve shoqëria civile ne shumë vende demokratike ka edhe rolin e monitoruesit për punën dhe veprimtarinë e institucioneve publike, si dhe kontribon edhe në hartimin e politikave qeveritare, në Kosovë, shoqëria civile nuk e ka pasur atë jehonën e saj sikur në vendet tjera. Megjithate në ndertimin dhe funksionimin e shtetit, është duke luar njërol konstruktiv sepse ngre zërin kundër shumë dukurive dhe të metave që mund të bëj shteti. Kështu, që edhe në Kosovë shoqëria civile për aq sa ka pasur kapacitete është munduar që të bëj të pamundurën që zëri i saj të ngrihet lartë dhe t'i denoncojnë shkeljet ligjore të bëra nga vet mekanizmi shtetëror, sidomos lidhur me ndërtimin e demokracisë dhe të vet shtetit ligjor.

Sipas nje hulumtimi qe ka realizuar KCSF, Mbi Indexin e Shoqerise Civile në Kosove, shifet së të gjeturat kane dhënë këto rezultate:

- "Trendi I fondeve te donatorëve ndërkombëtar per OSHC, respektivisht shoqërinë civile ne Kosovë është në rënje;
- Ka ndërrim të fokusit të përkrahjes/ristrukturim të fondeve të donatorëve

- *Përkrahje më e madhe nga donatorët u oftohet institucioneve publike*
- *Shumë OSHC do të pasivizohën/shuhën*
- *Mungon përkrahja institucionale për OSHC-të, respektivisht shoqërinë civile*
- *Nuk ka alternative tjera të financimit. (**Indexi Shoqërise Civile në Kosovë, 2009, 16**)*

Normalisht që sipas rezultateve dhe analizave shkencore, do të shihnim që shoqëria civile në Kosovë përballlet me shumë sfida, edhe pse në parim roli i saj është kyç, në raport me shoqëritë civile në shtetet e rajonit. Shoqëria civile duhet të vazhdojë me këtë stoicizëm të lartë, duke bërë progrese të vazhdueshme në ndërtimin e një shteti demokratik dhe funksional. Pikrisht për themi se është faktor shumë me rëndësi për funksionimin e shtetit.

REFERENCATË

1. *IMAIN Mc LEAN, Oxford, Fjalor Politik Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, Tiranë 2001*
2. *Howard Clark, Rezistenca Civile në Kosovë, Pluto Pres, London, 2000*
3. *Shoqëria Civile & Zhvillimi, Prishtinë, 2008*
4. *KCSF, Indexi i Shoqërisë në Kosovë, Prishtinë, 2010*

7. Diplomacia e Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore 1945-1978

Msc. Kosovar Alija

Universitetin i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Filozofik

kosovaralija2013@gmail.com

Fusha kontribuese – Diplomaci

Abstrakt

Me këtë punim me temë “Diplomacia e Shqipërisë pas Luftës së Dytë Botërore 1945-1978” synoj të sjell një pasqyrë të qartë për marrëdhëniet e Shqipërisë me shtetet fqinje, por edhe me shtetet e tjera të fuqishme, që ushtronin influencën e tyre politike në Ballkan. Historiografia shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore e ndikuar edhe nga faktori politik dhe ideologjik nuk ka mundur t’i qëndrojë realitetit historik dhe objektivitetit shkencor andaj edhe e ka glorifikuar atë periudhë historike. Kurse me rënien e sistemit komunist në Shqipëri periudha e viteve të para të pasluftës së Dytë Botërore është parë si fillimi i rrugëtimit të Shqipërisë kah Lindja. Në radhë të parë fillimi i marrëdhënieve me Jugosllavinë si, *Faza e patronatit jugosllav (1944-1948)*; *Koha e Stalinit si fazë e patronatit sovjetik (1948-1961)*; *Faza nën patronatin kinez (1961-1978)*; *Faza e emërtuar si “Splendid isolation” (1978-1988)*, dhe *faza emërtuar si “Approaching the European Mainstream” që nga viti 1988*. Por, mua si studiues i historisë më ka interesuar se lidhja e Shqipërisë me këto shtete ishte thjesht zgjedhje apo nevojë e kohës, duke marrë parasysh pozitën e brishtë ndërkombëtare të Shqipërisë në atë kohë. Po ashtu se sa mundësi reale kishte Shqipëria të renditej në anën e shteteve perëndimor, se pse Shqipëria nuk u lidh me botën perëndimore pas Luftës së Dytë Botërore, arsyet që ndikuan që të mos ndodhte një gjë e tillë. Një pjesë e këtij punimi bën fjalë edhe për pozicionin e Kosovës në marrëdhëniet Shqiptaro-Jugosllave, dhe arsyet se pse pas Luftës së Dytë Botërore Kosova nuk iu bashkua Shqipërisë. Duke kombinuar objektivitetin shkencor dhe këndvështrimin analitik rreth këtyre ngjarjeve të kësaj periudhe jam munduar të jem sa më i saktë duke shfrytëzuar literaturë nga autorë me këndvështrime të ndryshme nga të cilët kam nxjerr edhe këndvështrimin tim lidhur me temën në fjalë.

Fjalë kyçe: Diplomaci, shtetet fqinje, faktori politik, sistemi komunist, pozita ndërkombëtare.

Problemi i njohjes së qeverisë shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore

Diplomacia shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore ndahet në disa periudha nga autorë të ndryshëm. Sipas Klaus-Detlev Grothusen periodizimin e politikës shqiptare e ndanë në dy periudha, kurse këto periudha, i ndanë sërish në disa faza. Kështu, sipas tij periudha e parë ndahet në tri faza: 1. *Faza e patronatit jugosllav (1944-1948)*; 2. *Koha e Stalinit, si fazë e patronatit sovjetik (1948-1961)*; 3. *Faza nën patronatin kinez (1961-1978)*. Ndërsa, periudha e dytë ndahet në dy faza: 1. *Faza e parë e emërtuar si “Splendid isolation” (1978-1988)* dhe; 2. *Faza e dytë, e emërtuar si “Approaching the European Mainstream” që nis nga viti 1988.*⁸⁵ Menjëherë pas fillimit të fazës së parë çështja më e mbrehtë me të cilën u ballafaqua

⁸⁵ Vehbi Xhemaili, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1945-1948) dhe e vërteta e Enver Hoxhës për Kosovën*, Artikull elektronik, shikuar për herë të fundit 12.02.2017. Linku: <http://www.pashtriku.org/?kat=60&shkrimi=2345>)

politika e jashtme e Shqipërisë menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, ishte çështja e legjitimitetit dhe njohjes ndërkombëtare të qeverisë shqiptare. Shqipëria në relacionin midis shteteve të fuqishme që kishin influencë në Ballkan, përbënte një kartë të parëndësishme, sepse nuk figuronte në ujdinë midis Stalinit dhe Çërcillit, të bërë në nëntor të vitit 1944.⁸⁶ Në tetor të vitit 1944 në emër të qeverisë së përkohshme që u formua në Berat, Enver Hoxha kërkoi njohjen nga fuqitë aleate të koalicionit antifashist.⁸⁷ Lidhur me këtë, kishte një lloj hezitimi sidomos nga SHBA-ja dhe Britania e Madhe.

Vendimi për njohjen e qeverisë shqiptare nga ana e SHBA-së dhe dhe Britanisë së Madhe u mor me 2 dhjetor 1945, por nga ana e këtyre vendeve ishin vendosur edhe kushte si mbajtja e zgjedhjeve të lira, dhe njohja e traktateve që ishin lidhur deri më 1939, mes Shqipërisë dhe SHBA-së.⁸⁸ Sepse gjatë kohës së sundimit të Zogut, Shqipëria dhe SHBA kishin lidhur një sërë traktatesh, kryesisht me karakter ekonomik.⁸⁹

Në dhjetor të vitit 1945 qeverinë e Shqipërisë e njohu edhe Franca dhe ishte i vetmi shtet perëndimor që deri më 1949 kishte marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë. Edhe pse qeveria e Shqipërisë u njoh nga këto shtete, kjo nuk u shoqërua me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike ngase, Shqipëria nuk i respektoi traktatet e lidhura me SHBA-të para luftës. Ndikim të madh në këtë qasje, të shteteve perëndimore kishte edhe Incidenti i Korfuzit që ndodhi në vitin 1946. Kjo bëri që SHBA-ja të deklarohej kundër pranimin të Shqipërisë në OKB, dhe që marrëdhëniet e Shqipërisë me shtetet perëndimore të mos rezultojnë si të mira as në vitet vijuese. Në maj të vitit 1955, Shqipëria u bë anëtare e Paktit të Varshavës, duke u orientuar për miqësi dhe bashkëpunim veçanërisht me vendet e bllokut sovjetik.

Shqipëria arriti anëtarësimin në OKB më 15 dhjetor 1955, pasi siguroi njohjen ndërkombëtare pas shumë vitesh, kjo ishte rezultat i një marrëveshjeje midis Bashkimit Sovjetik dhe SHBA-së, pasi këto bllokunin anëtarësimin në OKB të shteteve të bllokut të kundërt, kështu ato u pajtuan për anëtarësimin e një numri shtetesh nga dy blloqet përkatëse ku në mesin e këtyre shteteve bënte pjesë edhe Shqipëria. Megjithatë, jashtë vendit nuk rreshtën përpjekjet për destabilizimin e Shqipërisë. Dolën në dritë dokumente të cilat flisnin në hollësi për përpjekjet anglo-amerikane për të nxitur kryengritje në Shqipëri 1945-1955, britanikët i stërvitën pjesëtarët e dikurshëm të *Gardës së Zogut*, dhe anëtarët e *Komitetit Kombëtar për Shqipërinë e Lirë*, ky komitet udhëhiqej nga Mithat Frashëri.⁹⁰ Rreziku i jashtëm ishte i vërtetë, por edhe pak i zmadhuar nga ana e autoriteteve shqiptare sepse përmes kësaj fshihej një qëllim tjetër likuidimi i armiqve të brendshëm.⁹¹

Marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë

Lidhjet e ngushta midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë kanë filluar gjatë Luftës së Dytë Botërore. Miqësinë me Jugosllavinë, pala shqiptare e quante të vlefshme për të kapërcyer vështirësitë që paraqiste paslufta dhe shaktërrimet që ishin pasojë e kësaj lufte.⁹² Edhe pse në mbledhjen themeluese të *PKSH*-së në përshtatje me qëllimin strategjik të saj dhe me kushtet e kohës, kishte përcaktuar si aleat të popullit shqiptar SHBA-në, Britaninë e madhe dhe Bashkimin Sovjetik, por ky përcaktim i komunistëve shqiptarë nuk zgjati shumë.⁹³ Fillimi i

⁸⁶ Bernard Lory, *Europa Perëndimore nga 1945 deri në ditët tona*, (Tiranë, Dituria, 2007), f. 38.

⁸⁷ Akademia e shkencave, Instituti i Historisë. *Historia e popullit shqiptar IV*, (Tiranë, Toena, 2004), f. 235.

⁸⁸ Po aty, f. 236.

⁸⁹ Haris Silajxhiq, *Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Washingtonit 1912- 1939*, (Tiranë, Dituria, 1999), f. 191.

⁹⁰ Edwin Jacques, *Shqipëritë*, (Tiranë, Kartë e pendë, 1995), f. 520.

⁹¹ Misha Glenny, *Historia e Ballkanit 1804-1999*, (Tiranë, Toena, 2007), f. 561.

⁹² Ramiz Alia, *Jeta ime kujtime*, (Tiranë, Toena, 2010), f. 168.

⁹³ Ali Hadri, *Kritikë historiografike I*, (Shkup, 1972), f. 103.

lidhjeve të ngushta të Shqipërisë me Jugosllavinë dëshmohej edhe nga fakti se i pari shtet që njohu qeverinë e Shqipërisë ishte Jugosllavia, më 29 prill 1945, pastaj Polonia, më 7 nëntor 1945 dhe BRSS, më 10 nëntor 1945.

Pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Jugosllavisë, roli i saj në Shqipëri filloi të rritej, kështu më 20 shkurt 1945 u nënshkrua *Traktati mbi Aleancën dhe ndihmën reciproke*, midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, megjithatë ky traktat mbeti thjesht në nivelin e draftit sepse nuk u ratifikua në asnjë nga parlamentet e të dy vendeve.⁹⁴ Këto marrëdhënie u bënë edhe më të ngushta pas vizitës së Enver Hoxhës në Jugosllavi në qershor të vitit 1946. Në këtë kohë, Shqipëria nuk e ngriti çështjen e Kosovës në konferencat ndërkombëtare, ose pranë kancelarive të Fuqive të Mëdha. Ajo, nuk kishte as forcën e as mbështetjen e duhur ndërkombëtare, nga ana tjetër nuk donte të krijonte probleme në marrëdhëniet e saj me Jugosllavinë. Në vitet 1945-1948 politika zyrtare e Tiranës i shmangej diskutimit të kësaj çështjeje, duke mos dashur që t'i acaronte marrëdhëniet me Jugosllavinë. Mirëpo vetë Enver Hoxha në një mbledhje të jashtëzakonshme të plenumit të *PKSH*-së në dhjetor 1946 kishte deklaruar se nuk ishte progresive të kërkohej nga ana e Shqipërisë bashkimi me Kosovën dhe se Shqipëria duhej të vazhdonte më tutje punën për vëllazërimin e shqiptarëve të Kosovës dhe popujve jugosllavë.⁹⁵

Qeveria jugosllave, duke shfrytëzuar vështirësitë ekonomike që po kalonte Shqipëria, më 27 nëntor 1946, nënshkroi *Konventën Ekonomike* e cila parashikonte koordinimin e planeve ekonomike, bashkimin doganor, dhe barazimin e monedhës në mes të dy shteteve.⁹⁶ Këto dy qeveri paraqiteshin si shumë të afërta, por faktikisht Shqipëria ishte satelit i Jugosllavisë, kurse kjo e fundit përbënte në të vërtetë një satelit të Bashkimit Sovjetik.⁹⁷ *Traktati mbi Miqësinë dhe Ndihmën Reciproke midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë*, parashihte që në rast se Greqia i shpallte luftë Shqipërisë mbi pretendimin e Jugut të saj, atëherë në luftë përkrah Shqipërisë do të hynte edhe Jugosllavia.⁹⁸ Në qershor të vitit 1947, jugosllavët ngritën për herë të parë akuzën se në kreun e shtetit shqiptar po kristalizohej një vijë antijugosllave. Enver Hoxha, për të shmangur trysninë jugosllave që synonte në radhë të parë largimin e tij nga udhëheqja e vendit, këmbënguli dhe ia doli që në korrik të vitit 1947 të bënte një vizitë zyrtare në Moskë, ku do të takohej me Stalinin. Kjo vizitë ishte shtyer disa herë për shkak të ndërhyrjes së udhëheqjes jugosllave, e cila nuk dëshironte një lidhje të drejpërdrejtë të Enver Hoxhës me sovjetikët. Ndërkohë, Titoja kishte filluar t'i shqyrtonte planet e tij për krijimin e *Federatës Ballkanike*, por kjo shkaktoi reagimin e Moskës e cila i druhej fuqizimit të Jugosllavisë. Pas rezolutës së *Byrosë Informative të partive Komuniste e Punëtore*, në qershor të vitit 1948, u dënua udhëheqja jugosllave për devijim nga rruga dhe vija e përbashkët.⁹⁹

Qeveria shqiptare kërkoi rishikimin e të gjitha marrëveshjeve duke bërë që në fund të vitit 1948 marrëdhëniet mes këtyre dy shteteve të jenë në një nivel shumë të ulët. Kjo gjendje mbeti deri në vitin 1954 kur u hapën përfaqësitë diplomatike të Shqipërisë në Jugosllavi dhe anasjelltas.¹⁰⁰ Kurse në vitin 1958 ambasadat përkatëse në Tiranë dhe Beograd mbeten në nivelin e të ngarkuarve diplomatik dhe jo të ambasadorëve, kjo situatë vazhdoi deri në vitin 1971 kur sërish të dy vendet u pajtuan që përfaqësitë e tyre diplomatike të ngriteshin në

⁹⁴ Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, (Prishtinë : Instituti i Historisë, 2012), f. 98.

⁹⁵ Noel Malkolm, *Kosova një histori e shkurtër*, (Prishtinë, Koha, 2001), f. 332.

⁹⁶ Vep e cit, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, *Historia e Popullit Shqiptar IV*, f. 242.

⁹⁷ Serge Metais, *Histori e shqiptarëve*, (Tiranë, 55, 2006), f. 328.

⁹⁸ Vehbi Xhemaili, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1945-1948) dhe e vërteta e Enver Hoxhës për Kosovën*, Artikull elektronik, shikuar për herë të fundit 12.02.2017. Linku: <http://www.pashtriku.org/?kat=60&shkrimi=2345>)

⁹⁹ Po aty, f. 335.

¹⁰⁰ Vep, e cit, Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe Kosova 1939-1981*, f. 124.

rangun e ambasadave.¹⁰¹ Në vitet vijuese marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave karakterizoheshin me normalitet shtetëror por me një armiqësi të papajtueshme në aspektin ideologjik-politik.¹⁰²

Marrëdhëniet e Shqipërisë me Greqinë

Marrëdhënjet e këtyre dy vendeve pas Luftës së Dytë Botërore do të mbeteshin të tensionuara për vite të tëra. Pretendimet e Greqisë për Shqipërinë e Jugut, dëbimi i popullsisë shqiptare çame nga Çamëria, si dhe mbështetja që qeveria shqiptare u dha komunistëve grekë gjatë *Luftës Civile* në Greqi ishin disa nga ferkimet e këtyre dy shteteve. Qeveritë greke të pasluftës nuk e njohën qeverinë shqiptare, jo se ajo ishte komuniste, po se njohja e saj forconte pozitat ndërkombëtare të Shqipërisë. Në Konferencën e Paqes në Paris, në korrik-tetor 1946, kryeministri grek, Caldaris, kërkoi që Shqipëria të trajtohej si palë e mundur dhe Greqisë t'i jepej Shqipëria e Jugut.¹⁰³ Një çështje që ndikoi në tensionimin e marrëdhënieve shqiptaro-greke, ishte edhe dëbimi i shqiptarëve çamë nga trojet e tyre në vitet 1944-1945. Mbi 25 mijë çamë u dëbuan me forcë, qindra të tjerë u masakruan, shtëpitë u dogjën dhe pronat u grabitën.¹⁰⁴ Ky gjenocid justifikohet me pretekstin se ajo kishte bashkëpunuar me pushtuesit fashistë italianë e gjermanë. Qeveria shqiptare dhe përfaqësuesit e popullsisë çame iu drejtuan disa herë *Fuqive të Mëdha* dhe konferencave ndërkombëtare me kërkesën për rikthimin e çamëve në shtëpitë e tyre dhe ndalimin e politikës antishqiptare në Greqi. Ndërkohë, problemi çam mbeti i pazgjidhur dhe objekt debati në marrëdhëniet shqiptaro-greke për gjysmë shekulli.

Marrëdhëniet e Shqipërisë me Italinë

Shqipëria si një ndër vendet që i kontribuoi luftës antifashiste ndodhej në anën e fituesve të luftës dhe duhej t'i rregullonte marrëdhëniet me Italinë fqinje përmes nënshkrimit të një traktati të paqes. Për të diskutuar për riatdhesimin e italianëve të mbetur në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, në mars të vitit 1945 në Shqipëri shkoi zëvendës sekretari në *Ministrinë Italiane të Luftës*, Mario Palermo. Kështu më 14 mars u nënshkrua marrëveshja midis Enver Hoxhës dhe Mario Palermos për riatdhesimin e italianëve të mbetur në Shqipëri, përjashtim bënin vetëm specialistët e nevojshëm për rindërtimin e vendit.¹⁰⁵

Në fundin e vitit 1946, Shqipëria u konsiderua si *“fuqi shoqe”* në zbatimin e Traktatit të paqes, i cili parashikonte që Italia ta respektonte pavarësinë e Shqipërisë dhe që asaj t'i kthehej ishulli i Sazanit. Megjithatë gjatë gjithë kohë sa zgjati diskutimi i projekt-traktatit të paqes, qeveria italiane refuzoi t'i njihte Shqipërisë dëmet e shkaktuara nga pushtimi fashist. Marrëdhëniet mes qeverisë shqiptare dhe qeverisë italiane mbetën të tensionuara edhe për një arsye tjetër, se Italia në këtë kohë ishte bërë strehë e kundërshtarëve politikë të sistemit komunist në Shqipëri. Pas aderimit të Shqipërisë në Traktatin e Paqes me Italinë, në fund të vitit 1947, qeveria italiane i kërkoi Shqipërisë vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Këtë, qeveria shqiptare e refuzoi në mënyrë sistematike duke kërkuar dorëzimin e kriminelëve të luftës, pagesën e dëmshpërblimeve dhe shlyerjen e detyrimeve të tjera që rridhnin nga zbatimi i Traktatit të Paqes.

¹⁰¹ Po aty, f. 187.

¹⁰² Zef Ahmeti, *Politika e jashtme shqiptare I*, (Artikull elektronik, shikuar për herë të fundit 02.05.2015. Linku: www.kosova.com/artikulli/888).

¹⁰³ Vep e cit, Akademia e Shkencave. Instituti i Historisë, *Historia e Popullit Shqiptar IV*, f. 240.

¹⁰⁴ Po aty, f. 241.

¹⁰⁵ Po aty, f. 240.

Marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik

Shqipëria deri në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore ka qenë në periferi të politikës së jashtme të Bashkimit Sovjetik në Ballkan. Në këto kushte qeveria sovjetike e la Shqipërinë nën njëfarë “*kujdestarie*” të Jugosllavisë. Pas njohjes së qeverisë shqiptare nga ana e Bashkimit Sovjetik, më 10 nëntor 1945, midis dy vendeve u vendosën marrëdhënie diplomatike. Në vitet 1945-1946 Enver Hoxha u mundua që ta realizojë një vizitë në Bashkimin Sovjetik, mirëpo kjo vizitë u realizua vetëm në vitin 1947, ku Enver Hoxha takoi udhëheqësin Sovjetik, Stalinin, por edhe udhëheqësit tjerë të Bashkimit Sovjetik. Pas kësaj vizite marrëdhëniet dypalëshe njohën një zhvillim në të gjitha sferat si në sferën ekonomike, ushtarake, politike, etj. Në këtë kuadër ushtria shqiptare u pajis falas me armatim sovjetik.¹⁰⁶ Afrimin e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik nuk e përkrahte Jugosllavia, sepse planet e Titos ishin që ta përfshinte Shqipërinë në Federatën Ballkanike së bashku edhe me Bullgarinë.¹⁰⁷ Me prishjen e marrëdhënieve midis Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë, Enver Hoxha për të siguruar ekzistencën e tij në pushtet mori anën e sovjetikëve. Shqipëria ishte vend i pasigurtë dhe i vështirë për t’u qeverisur, kjo bëri që ideja dominante e politikës shqiptare të ishte mbrojtja e sovranitetit të shtetit dhe përjetësimi i pushtetit të Enver Hoxhës.¹⁰⁸ Në rrethanat e krijuara Shqipëria mori dimensione të reja për politikën e jashtme sovjetike, ajo u orientua tërësisht nga ndihmat e Bashkimi Sovjetik, çka bëri që të rriste ndikimin dhe kontrollin mbi Shqipërinë, kështu vendin e specialisëve jugosllavë e zunë rreth 3000 sovjetikë.¹⁰⁹ Në vitin 1955 me vizitën e Hrushqovit në Jugosllavi, udhëheqja e Tiranës u ndie e rrezikuar dhe marrëdhëniet midis Tiranës dhe Moskës filluan të përkeqësoheshin. Ithtarët e vijës së ashpër staliniste në Tiranë po zhgënjeheshin gjithnjë e më shumë me kursin e politikës së Hrushqovit. Në vitin 1960, në mbledhjen e 81 partive komuniste të botës, Kina komuniste dhe Bashkimi Sovjetik u ndanë për shkak të vijës së ashpër staliniste të udhëheqjes kineze, në këtë rast Enver Hoxha mbajti anën e udhëheqjes kineze dhe marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik shënuan hap të pakthyesëm. Prishja e Shqipërisë me sovjetikët nuk ka qenë vetëm për arsye ideologjike por për arsye se Enver Hoxha donte ta ruante pushtetin e tij.¹¹⁰ Mosmarrëveshje dhe tensione pati sidomos për bazën e nëndetëseve në ishullin e strategjik të Sazanit. Kjo bazë ushtarake u hoq më 1962 dhe arsyeja pse rusët nuk ndërhyjnë me forca ushtarake në Shqipëri mendohet të jetë fakti se nuk donin t’i acaronin marrëdhëniet me kinezët. Ndërsa në anën tjetër edhe përfundimi nuk tentoi të lidhej me Shqipërinë, sepse duke qenë në situatë të tillë ajo nuk dëshironte të prishte *status-quo*-në në zonat e influencës sovjetike.¹¹¹

Marrëdhëniet e Shqipërisë me Kinën

Enver Hoxha kishte vizituar Kinën, më 1956 dhe kishte fituar simpatinë e kinezëve me propozimin e tij që Bashkimi Sovjetik ta armatoste Kinën me armë bërthamore, kinezët e përshëndetën qëndrimin e tij të “*drejtë*” ndaj komunizmit. Megjithatë, Kina dhe Shqipëria dallonin në çdo pikëpamje: gjeografike, kulturore, racore, gjuhësore etj. E vetmja gjë që i bashkonte ishte ideologjia e përbashkët staliniste. Largësia midis tyre krijonte fare pak

¹⁰⁶ Vep e cit, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Historia e Popullit Shqiptar IV, f. 238.

¹⁰⁷ Po aty, f. 239.

¹⁰⁸ Vep, e cit, Bernard Lory, Europa Ballkanike nga 1945 deri në ditët tona, f. 88.

¹⁰⁹ Zef Ahmeti, Artikull, *Politika e jashtme shqiptare II*, (Artikull elektronik, shikuar për herë të fundit 02.06.2015. Linku: <http://www.kosova.com/artikulli/84928>).

¹¹⁰ Paskal Milo, *Ju rrëfej anekset e fshehta të diplomacies së Enver Hoxhës*, (Artikull elektronik, shikuar për herë të fundit 02.06.2015. Linku: <http://arkivi.peshkupauje.com/2009/01/paskal-milo-ju-rrfeje-anekset-e-fshehta.html>).

¹¹¹ Blerim shala, Llukman Halili dhe Hazir Reka, *Unë Ramiz Alia dëshmoj për historinë*, (Prishtinë, Zëri, 1992), f. 56.

mundësi që Kina të rrezikonte pavarësinë e Shqipërisë. Në sajë të një rezolute të propozuar nga Shqipëria, pas prishjes së marrëdhënieve me Bashkimin sovjetik, Kina i kishte ofruar Shqipërisë një ndihmë prej 125 milionë dollarësh për mbështetjen e planeve ekonomike. Lidhja e miqësisë shqiptaro-kineze, dhe dëshira e politikës shqiptare që në çdo aspekt dhe me çdo kusht të kopjonte Kinën, në Ballkan kishte shpikur një proverbë ‘*kur bie shi në Kinë, në Shqipëri i hapin çadrat*’.¹¹²

Elita komuniste në Kinë kishte filluar një lloj happeje të vendit ndaj perëndimit dhe kjo solli edhe zbehjen e marrëdhënieve Shqipëri-Kinë. Ngjarja e parë që tronditi marrëdhëniet shqiptaro-kineze ishte vizita e presidentit amerikan Riçard Nikson në Kinë më 1972. Mirëpo, kulmi arriti kur kryeministri kinez Hua Kua Feng ftoi për një vizitë nëntëditore Titon për të diskutuar për politikën e tij të paangazhimit. Kina deklaroi ndërprerjen e të gjitha marrëdhënieve me 7 korrik 1978, një vit pas një artikulli jashtëzakonisht të ashpër që akuzonte Kinën për tradhëti ndaj marksizëm-leninizmit. Në këtë mënyrë mori fund bashkëpunimi ekonomik, politik dhe ushtarak me Kinën.

Marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet perëndimore

Britania e Madhe dhe SHBA, pas luftës kushtëzuan njohjen e qeverisë së Shqipërisë me pranimin nga ana e saj të marrëveshjeve që mbreti Zog kishte lidhur me kompanitë amerikane dhe britanike përpara luftës.¹¹³ Që prej vitit 1946, kur marrëdhëniet diplomatike me dy fuqitë perëndimore u prishën dhe misionet britanike dhe amerikane u përzunë nga Shqipëria, Hoxha nuk pati më marrëdhënie me ta. Amerikanët dhe britanikët u vendosën në Shqipëri vetëm në vitin 1991.¹¹⁴ Në prishjen e marrëdhënieve të Shqipërisë me këto shtete ndikoi edhe Incidenti i Kanalit të Korfuzit ku humbën jetën 44 marinarë britanikë.¹¹⁵ Britania iu drejtua gjykatës së Hagës e cila në vendimin e saj përfundimtar shpalli fajtorë Shqipërinë, mirëpo ky vendim nuk u njohë prej qeverisë shqiptare.

Marrëdhëniet e Shqipërisë me perëndimin kishin mbetur të ngrira, pasi politika e jashtme shqiptare u orientua thuajse tërësisht nga Bashkimi Sovjetik e më pas nga Kina. Qëndrime të njejta qeveria shqiptare mbajti edhe ndaj organizatave ndërkombëtare botërore. Bashkësitë ekonomike financiare, si *Tregu i Përbashkët Evropian*, *Fondi Monetar Ndërkombëtar*, *Banka Botërore* etj. Ajo i quante pjellë të kapitalit të madh perëndimor që kishin për qëllim skllavërimin ekonomik e politik të popujve të pazhvilluar. Por i vetmi vend perëndimor me të cilin Shqipëria kishte marrëdhënie normale ishte Franca, arsyeja që e lidhte Shqipërinë me Francën ishte antiamerikanizmi i presidentit të saj De Gol, me Francën. Shqipëria kishte marrëveshje edhe në fushën e arsimit, tregtisë etj.

Neutraliteti në politikën e jashtme të Shqipërisë

Në sferën e marrëdhënieve ndërkombëtare, Shqipëria politikën e saj të jashtme e mbështeste në parimet proletare dhe me këtë synohej: mbështetja e revolucionit botëror proletar, vendosja e shoqërisë socialiste etj., parime të tjera ishin edhe ruajtja e sovranitetit dhe integritetit territorial, parimi i reciprocitetit dhe fqinjësisë së mirë në marrëdhëniet ndërkombëtare.¹¹⁶ Megjithatë, edhe në këtë aspekt ka pasur dallime, ku në shumë raste Shqipëria politikën e saj të jashtme nuk e ka udhëhequr nga parimet proletare, si shembuj ilustrativë mund të përmenden deklarimi i Enver Hoxhës më 1979 se “Izraeli është armik i përbashkët i shqiptarëve dhe arabëve” dhe përkrahja edhe pse formalisht e revolucionit islamik në Iran po në vitin 1979.¹¹⁷ Pas prishjes së marrëdhënieve me Kinën diplomacia

¹¹² Vep e cit, Edwin Jacques, *Shqiptarët*, f. 522.

¹¹³ Blendi Fevziu, *Enver Hoxha*, (Tiranë, UET press, 2011), f. 168.

¹¹⁴ Po aty, f. 159.

¹¹⁵ Tajar Zavalani, *Histori e Shqipërisë*, (Tiranë, Phoenix, 1998), f. 330.

¹¹⁶ Hysamedin Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, (Shkup: Logos-a, 2010), f. 456.

¹¹⁷ Po aty, f. 456

shqiptare u karakterizua nga një pasivitet që shprehej me mospjesëmarrjen e Shqipërisë në organizatat e konferencat ndërkombëtare.

Kjo u manifestua qartë me mospjesëmarrjen e Shqipërisë në Konferencën për *Siguri dhe Bashkëpunim Evropian*, që u mbajt në Helsinki të Finlandës më 1975, Shqipëria ishte i vetmi vend që ndonëse u ftua nuk mori pjesë në këtë konferencë. Sa i përket anës ekonomike kishte disa marrëveshje tregtare me shtete si: Austrinë, Italinë, Turqinë, Jugosllavinë, dhe Francën, ndër eksportet më të rëndësishme ishte nafta dhe energjia elektrike e cila eksportohej kryesisht në Greqi dhe Jugosllavi. Pas prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-kineze u bënë përpjekje fillimisht për t'i ringjallur marrëdhëniet ekonomiko-politike me vendet komuniste të Evropës Lindore. Shqipëria kishte marrëdhënie diplomatike me rreth 80 vende të botës, me përjashtim të SHBA, Britanisë, dhe RFGJ, dhe marrëdhënie ekonomike me rreth 70 prej tyre. Pengesë për forcimin e marrëdhënieve tregtare ishte kushtetuta e vitit 1976 e cila ndalonte marrjen e kredive nga ana e shtetit shqiptar dhe ndalonte krijimin e ndërmarrjeve të përbashkëta ndërshtetërore.¹¹⁸

Akuzat e shteteve perëndimore për izolimin e Shqipërisë nuk ishin krejt të drejta sepse ishin vetë shtetet perëndimore që vendosën në Konferencën e Jaltës më 1945 se në influencën e cilit bllok politik duhej të ishte Shqipëria.¹¹⁹ Janë ngritur shumë akuza se pas prishjes së marrëdhënieve me Kinën, Enver Hoxha, e la Shqipërinë pa aleatë, por nuk duhet të harrojmë se as kur Shqipëria doli nga Traktati i Varshavës, as kur u prishën marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik, perëndimi heshti, nuk e “duartrokiti” as nuk e mbështeti Shqipërinë e vogël se mos zemëronte ariun rus me dhëmbë atomikë apo Kinën e madhe.¹²⁰

Si përfundim kur analizojmë periudhat e ndryshme historike, duhet të kemi parasysh një gjë shumë të rëndësishme, kushtet në të cilat është zhvilluar ajo periudhë historike. Sepse, shpeshherë në historiografi bëhet gabim duke analizuar të kaluarën me konceptet dhe logjikën bashkëkohore të së tashmes. Me këtë dua të them, si për shembull, kur analizojmë marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë në vitet 1945-1978, duhet të kemi parasysh Shqipërinë e pasluftës me ekonomi të shkatërruar dhe pozitën ndërkombëtare pafavorshme, siç ndodh në të shumtën e rasteve fuqia ekonomike apo ushtarake përcakton edhe rolin e diplomacisë së një vendi. Në këtë rast Shqipëria nuk mund të kishte rol diplomatik të rëndësishëm pasi i mungonin aspektet e tilla. Andaj, ajo nuk ishte në gjendje të bënte zgjedhje tjetër të përshtatshme veçse të krijonte miqësi me cilindo vend që kishte mundësi. Nëse analizojmë politikën e fuqive të mëdha të kësaj periudhe, do të shohim se Shqipëria ishte përcaktuar që t'i përkiste *Bllokut Lindor* ende pa përfunduar Lufta e Dytë Botërore, sepse midis Fuqive të Mëdha ishin përcaktuar zonat e influencimit politik. Nga kjo mund të konstatohet, se marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë, nuk vareshin nga dëshira e saj, por nga mundësia dhe përcaktimi i Fuqive të Mëdha. Një rast për t'u riorientuar Shqipëria kah shtetet perëndimore ishte kur u prishën marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik, por në Shqipëri tashmë ishte konsoliduar sistemi komunist, duke marrë parasysh gjendjen ekonomike-diplomatike, lidhja e miqësisë me Kinën nuk ishte krejt e padobishme, sepse mundësoi për një kohë modernizimin e vendit. Nga ana tjetër edhe largësia gjeografike, bënte që Kina mos të rrezikonte pavarësinë e Shqipërisë.

Sa i përket çështjes, se pse Shqipëria nuk u bashkua me Kosovën, mendoj duhet të kemi parasysh aspektet politike, ushtarake dhe ekonomike. Ndërsa, shtrohet pyetja, a kishte mundësi dhe kapacitete reale që Shqipëria t'i kundërvihej Jugosllavisë, mund të konstatoj, se në asnjë aspekt përcaktues, Shqipëria nuk ishte në epërsi. Ajo e kishte të pasigurtë vetë

¹¹⁸ Vep, e cit, Ramiz Alia, *Jeta ime kujtime*, f. 274.

¹¹⁹ Nexhmije Hoxha, *Jeta ime me Enverin 2*, (Tiranë, neraida, 2001), f. 293.

¹²⁰ Po aty, f. 294.

ekzistencën e saj si shtet, duke pasur përballë një Jugosllavi shumë më të zhvilluar, më të konsoliduar dhe më të madhe.

Armiqësitë vazhduan me vendet fqinje, si Jugosllavinë dhe Greqinë, sepse këto vazhdimisht propagandonin në dëm të Shqipërisë. Këto nuk e bënë një gjë të tillë për shkak të sistemit të qeverisjes së Shqipërisë, por për shkak të retorikës dhe projekteve të tyre tradicionale. Kjo bëri që edhe vendet perëndimore edhe atë pak interes që kishin për Shqipërinë, të mos e aktualizonin si çështje. Duke marrë parasysh gjitha këto rrethana, diplomacia shqiptare nuk do të mund të faktorizohej më shumë, të kishte rol dhe ndikim më të madh në Ballkan.

BIBLIOGRAFIA

1. *Historia e Popullit Shqiptar IV*. Tiranë: Toena, 2008.
2. Alia, Ramiz. *Jeta ime kujtime*. Tiranë: Toena, 2010.
3. Feraj, Hysamedin. *Skicë e mendimit politik shqiptar*. Shkup : Logos-a, 2010.
- Fevziu, Blendi. *Enver Hoxha*. Tiranë: UET press, 2011.
4. Glenney, Misha. *Histori e Ballkanit 1804-1999*. Tiranë: Toena, 2007.
5. Hadri, Ali. *Kritikë historiografike I*. Shkup: 1973.
- Hoxha, Nexhmije. *Jeta ime me Enverin 2*. Tiranë: Neraida, 2001.
- Jacques, Edwin. *Shqiptarët*. Tiranë: Kartë e pendë, 1995.
6. Jens Schmitt, Oliver. *Kosova histori e shukrtër e një treve qendrore ballkanike*. Prishtinë: Koha, 2012.
7. Kaba, Hamit. *Shqipëria dhe të mëdhenjtë nga lufta e Dytë Botërore në Luftën e Ftohtë*. Tiranë: Klean, 2015
8. Lory, Bernard. *Europa Ballkanike nga 1945 deri në ditët tona*. Tiranë: Dituria, 2007.
9. Malkolm, Noel. *Kosova një histori e shkurtër*. Prishtinë, Koha, 2001.
- Metais, Serge. *Histori e shqiptarëve*. Tiranë: 55, 2006.
10. Shala, Blerim, Llukman Halili, Hazir Reka. *Unë Ramiz Alia dëshmoj për historinë*. Prishtinë: Zëri, 1992.
11. Shatri, Muhamet. *Kosova në Luftën e Dytë Botërore 1941-1945*. Tiranë: Toena, 1997.
12. Silajxhiç, Haris. *Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Washingtonit 1912-1939*. Tiranë: Dituria, 1999.
13. Syla, Sabit. *Shteti shqiptar dhe Kosova 1939-1981*. Prishtinë: Instituti i Historisë, 2012.
14. Vickers, Miranda. *Midis serbëve dhe shqiptarëve*. Tiranë: Toena, 2004.
15. Zavalani, Tajar. *Histori e Shqipnis*. Tiranë: Phoneix, 1998.

BURIME NGA INTERNETI

16. Paskal Milo. *Ju rrëfej anekset e fshehta të diplomacisë së Enver Hoxhës*. (Artikull elektronik, shikuar për herë të fundit 2.6.2015. Linku: <http://arkivi.peshkupauje.com/2009/01/paskal-milo-ju-rrefej-anekset-e-fshehta.html>).
17. Vehbi Xhemaili. *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1945-1948) dhe e vërteta e Enver Hoxhës për Kosovën*. (Artikull elektronik, shikuar për herë të fundit 2.5.2015. Linku: <http://www.pashtriku.org/?kat=60&shkrimi=2345>).
24. Zef Ahmeti. *Politika e jashtme shqiptare I*. (Artikull elektronik, shikuar për herë të fundit 2.5.2015. Linku: <http://www.kosova.com/artikulli/84928>).
25. Zef Ahmeti.. *Politika e jashtme shqiptare II*. (Artikull elektronik, shikuar për herë të fundit 2.5.2015. Linku: <http://www.kosova.com/artikulli/84928>).

8.Femrat e panatyrshme: Shmangiet nga normat morale viktoriane në romanin *Armadel* të Uillki Kollinsit

Dr. Suzana Ibraimi Memeti

Universiteti Shtetëror i Tetovës, suzana.ibraimi@gmail.com

Abstrakt

Kur ballafaqohet me dhunën femërore, shoqëria viktoriane ishte e prirur të ofronte justifikime për sjellje brutale dhe agresive të femrës, duke u përpjekur që t'i arsyetonte disa gjëra.

Lodli dhe Hester Detrixhi janë shembuj të përkryer të dëshirës për të dhënë disa arsye rreth aktit dhunues të femrave. Kjo mungesë e dëshirës për të mos fajtuar femrën rrjedh pjesërisht nga fakti se femrat konsideroheshin si edukatore, dhe si dhënëse të jetës e jo si rrëmbyese të jetës. Mirëpo, kur ishte e qartë se nuk kishte arsye, p.sh mbi çmendurinë dhe sjelljen përdhunuese të femrës, ajo konsiderohej si e jashtëzakonshme, e panatyrshme, pothuajse si ndonjë përbindësh.

Nocionet “kriminele e lindur” ose “nënë foshnjëvrasëse” i përkasin kategorisë së femrës së ligë apo të panatyrshme. Këto gra duket se ishin pa arsye dhe shpjegime, kështu që shoqëria viktoriane i konsideronte si të jashtëzakonshme sepse sjellja e tyre ishte në kundërshtim me moralin viktorian të gruas dhe të nënës. Ndërsa një kundërvajtje apo shkelje e ligjit mund të kuptohej dhe sqarohej, gruaja e cila shkelte ligjin disa herë, siç ishte rasti i Lidia Guillt në romanin “Armadel,” konsiderohej si jonormale dhe e panatyrshme. Në fakt, romani “Armadel” e Uillki Kollinsit analizon figurën e femrës që simbolizon aspektin e rrezikshëm dhe hipokrit të kriminalitetit femëror. Ndërsa ajo shtiret si simbol i idealit viktorian, apo si “femër engjëllorë”, nën sipërfaqe gëlojnë të palara, keqbërje dhe vrazhdësi.

Fjalë kyçe (Keywords): femrat e panatyrshme, femra kriminele, norma morale, periudha viktoriane.

1. Hyrja

Meqë në periudhën viktoriane femra ideale konsiderohej si një modele e virtytit, femra kriminale ndëshkohej shumë më rreptë se burrat kriminelë, sepse burri konsiderohej se mund të bënte vepra dhe aventura në jetën e tij. Në të vërtetë, kriminelin mashkull kishte shkakun, justifikimin, kurajon, vlerën fizike dhe shkathtësinë dhe nuk ishte larg koncepteve burrërore. Ndryshe nga kjo pikëpamje, femra për veprime analoge vazhdimisht i kundërvijej ligjit dhe tregonte vetëm veçoritë negative të femrave. Femra kriminele shkaktonte një kundërpërgjigje shumë të fuqishme emocionale të shoqërisë kur bënte mëkate; e keqja e saj dënohej shumë më rreptë sesa krimi mashkullor. Normat kulturore të shoqërisë, të cilat kërkonin nga gruaja mirësjellje, modesti, bindje, respekt, paprekshmëri dhe mbrojtje, konsideroheshin si gardianë moralë të veçorive të errëta të femrës, mirëpo kur një femër

bëhej e pakujdesshme në shoqëri dhe nuk u përmbahej normave të gruas viktoriane, ajo konsiderohej se i nënshtrohej anëve të liga të natyrës së saj, sepse “nën fasadën e dashurisë, femra e ndershme shpaloste anët e saj të errëta dhe sjelljet e së ligës” (Zedner, 41).

2. Teksti kryesor

Nga fundi i shekullit XIX u shfaq koncepti i „moralit indifferent” që kishte të bënte me femrat kriminele. Më 1890, Havelok Ellis e përkufizoi kriminelën e pavetëdijshme si një kriminele instiktive dhe të zakonshme e cila nuk kishte brejtje të ndërgjegjes (124). Ky sqarim i ngarkonte me faj femrat të cilat mohonin “idealin femëror” dhe dukej se ishin të privuara nga vetërespekti duke shpërfillur rendin shoqëror.

Romani “Armadel” e Uillki Kollinsit analizon figurën e femrës që simbolizon aspektin e rrezikshëm dhe hipokrit të kriminalitetit femëror. Ndërsa ajo shtiret si simbol i idealit viktorian, apo si “femër engjëlllore”, nën sipërfaqe gëlojnë të palara, keqbërje dhe vrazhdësi. Lidia Villti që nga fillimi e deri në fund është një kriminele, interesat, manipulimet dhe pasionet e së cilës janë të dukshme. “Armadeli,” është një vepër që tregon shmangiet nga normat viktoriane. Kollinsi e përdorë Lidia Guilltin si një grua të keqe e cila i sfidon normat besimtare me një vrull të madh. Kur u botua romani së pari me 1866, Lidia Gvillti përshkruhej në vepër si “një ndër femrat më të poshtëra, dëshirat dhe veprimet e së cilës i kanë hedhur një hije të zezë romanit” (Hughes, 158).

Në të përkohshmen “Spectator” redaktori e sulmonte Kollinsin për arsye se:

“...I ka tejkaluar kufijtë e asaj që quhet dinjitet dhe ka revoltuar çdo ndjenjë humane, meqë heroina e tij është një femër më e ndyrë se laviret nëpër rrugë. Ajo i ka mbushur 35 vjet dhe nëpërmjet Merit, falsifikimeve, vrasjeve, vjedhjeve, bigamisë, burgimit dhe përpjekjes për të bërë vetëvrasje, mbeti e gjallë pa pasur asnjë gjurmë në bukurinë e saj” (Boyle, 170).

Kuptohet që idea se një grua e bukur ishte në gjendje të kryente krime të neveritshme ishte një dukuri shumë shqetësuese për ndërgjegjen dhe moralin viktorian. Lidia Guillti është një grua e bukur me një të kaluar të shëmtuar dhe të çoroditur. Krimin e parë e filloi duke falsifikuar një letër, kur ishte në moshën 12 vjeçare. Më pas, kur dërgohet në shkollën frënge, Kollinsi shkruan se kishte ndodhur një skandal, kur ligjëruesi francez i muzikës i Lidias (i cili ishte i martuar dhe kishte fëmijë) orvatet të bëjë vetëvrasje dhe më vonë çmendet. Pas mbarimit të shkollës, Lidia hyn në manastir por atë e përjashtojnë për arsye se “prifti ishte i bindur se në të kishte hyrë djalli” (A, 523). Më pas Lidia shoqërohet me bataçinj, mashtrues dhe keqbërës. Ndërkaq, ajo martohet, por e helmon burrin për shkak se e kishte qëlluar me kamxhik në fytyrë; pastaj gjen një dashnor. Për krimin e bërë ajo dënohet me vdekje, mirëpo ministri i Punëve të Mbrendshme e ndryshon dënimin e saj. Në vijim, ajo merr pjesë në një grabitje; pasi ia falin dënimin me vdekje, ajo mbetet në burg për gabitjen e bankës. Pikërisht në këtë pjesë të romanit, zhvillohet linja kryesore e subjektit, kur Lidia maskohet si guvernante dhe shërben te zonjusha Mirloji, familja e së cilës kishte marrë një vilë në pronën Thorp Ambrozi. Lidia është maskuar si guvernante, me qëllim që t’i afrohet Allen Armadelit, pasurinë e të cilit ajo dëshiron ta përvetësojë. Plani i saj ishte që ta mashtronte dhe ta shtinte në dorë Armadelin duke u martuar me të. Por Ozias Miduinter (i quajtur po ashtu Allen Armadel) bie në dashuri me Lidian. Kjo nuk e luhatë vendimin e saj. Së këndejmi, ajo vendos të martohet me Miduinterin me emrin e Allen Armadelit për ta

vrarë Allen Armadelin e vërtetë i cili është pronar i Thorp Ambrozit. Pasi ta kryente këtë punë, ajo kishte ndërmend ta mohonte marrëdhënien e saj me Ozias Miduinterin (në të vërtetë ajo u martua me të me emrin e Armadelit jo të Miduinterit) dhe prandaj vendoset në Thorp Ambrozi, si një vejushë e re me emrin zonja Allen Armadel. Lidia Gvillti është e portretizuar si një kriminele egoiste dhe karrieriste. Ndërsa, Kollinsi e përshkruan Lidian si egoiste, ai nuk gabon, por njëherësh vazhdon ta portretizojë atë si “viktimë të një sistemi shoqëror indiferent, të korruptuar dhe hipokrit” (Boyle, 170).

Perspektiva e dyfishtë me të cilën Kollinsi e paraqet Lidian pasqyron besimin e shoqërisë në mirësinë femërore. Kur është e shtrënguar ta pranojë aftësinë e saj për dhunë, shoqëria ka një lloj tendence që të jap justifikime për sjelljen e saj. Kollinsi e shkatërron veprimtarinë e Lidias, sepse nuk është Lidia, por zonja Oldersho (një sharlatane e cila e ka rritur Lidien jetime) e cila manipulon me intriga për mashtrimin e Armadelit. Ajo po kështu e këshillon Lidian që të vendoset pranë Armadelit, duke punuar si guvernante e zonjushës Mirloi (A, 164-165).

Përveç kësaj, Kollinsi e përfshin edhe nocionin e fatit dhe e kritikon mungesën e veprimit nga ana e Lidias. Zonja Oldershou i thotë Lidias se me të vërtetë duket se vetë fati ndihmoi që Lidia ta luante rolin e zonjës Armadeli të Thorp Ambrozit. Kollinsi përmend shpesh nocionin e fatit në romanin e tij. Miduinteri, bie fjala, e pyet veten se a është ai një instrument në duart e fatit apo një instrument në dorën e Hyjnisë (A, 103). Në kuadrin e nocionit të fatit është edhe sugjerimi që parashikon se Lidia është në duart e fatit, jo një kriminele me përvojë e cila bën komplot për ta vrarë Armadelin. Miduinteri me ngulmim pohon se aktet e Lidias janë në duart e fatit dhe prandaj thotë me vete: “Ajo që është për t’u bërë, do të bëhet. Çfarë duhet të bëjë unë me të dhe çfarë ka Lidia të bëjë me të?” (A, 416). Më në fund, Lidia i beson fatit kur shkruan në ditarin e saj: “Sikur të mund ta anashkaloja atë që më ka caktuar fati të bëj” (A, 438).

Fakti që prindërit e Lidias janë të panjohur e përforcon nocionin e misterit rreth saj. Ç’është e vërteta, askush nuk e di se kush është me të vërtetë Lidia Guillti. Autori vëren: ajo mund të jetë bija e ndonjë shitësi të zakonshëm. Rrethanat mund të jenë mjaft romantike por edhe mjaft të rëndomta. Trashëgimia e saj është e panjohur tërësisht, gjë që paraqet një hamendesim për opinionin dhe vlerat viktoriane. Prindërit e Lidia Guilltit mbeten një mister. Ekziston mundësia që ajo mund të jetë ose anëtare e klasës më të lartë ose pjesëtare e klasës së ulët. Për më tepër, Lidia shoqërohet me dr. Daunvordin të cilin narratori e konsideron si një njeri që mendon se fshehtësitë njeriu duhet t’i ruajë për vete dhe jo për të tjerët (A, 340).

Simbolikisht kjo e përforcon edhe më shumë misterin dhe sekretin e trashëgimisë së Lidias. Prejardhja e Lidia Guilltit mbetet një mister i mbuluar me heshtje. Sidoqoftë, në shoqërinë ku sundojnë klasat, prejardhja dhe trashëgimia e pasigurt shkakton shqetësim. Fakti se Lidia, si anëtare e klasës së ulët, është në gjendje ta fshehë veten dhe ta kapërcej barrierën klasore është mjaft shqetësuese. Përveç kësaj, Lidia është e zonja ta fshehë edhe karakterin e saj si kriminele pas idesë së respektabilitetit, të marrë pozitën e guvernantes dhe të përpiqet ta marrë edhe titullin e një “zonje” të klasës së lartë. Kështu, Lidia Guillt paraqet një kërcënim për klasat “e respektuara” të shekullit XIX të Anglisë. E kaluara kriminale e zonjushës Guillt shërben si një ndotje dhe njollosje potenciale e atyre anëtarëve të klasave të respektuara, me të cilët shoqërohet ajo. Ekzistonte frika se po të depërtonin anëtarët e klasave më të ulëta në mesin e klasave të mesme dhe të larta, ata do t’i dobësonin këto klasa dhe do të përhapnin papastërtinë morale dhe fizike.

Kështu Lidia Guillt simbolizon nocionin e mashtrimit fizik dhe moral, siç vë në dukje dhe vetë autori: “Për Lidia Guilltin çdo gjë ishte në rregull, çdo gjë ishte e qartë në sipërfaqe. Ndërkaq, çdo gjë ishte e kalbur dhe e çoroditur nën sipërfaqe” (A, 524). Ndërsa sa për sy e faqe, Lidia dukej si një grua elegante dhe tërheqëse, si një grua zemërbardhë, në të vërtetë ajo ishte “një aventuriere e klasës më të lartë, një grua pa asnjë vlerë dhe tejet e rrezikshme” (A, 362). Lidia nuk është vetëm një produkt i prindërve të panjohur, ajo është edhe një produkt i shoqërisë. Kështu ajo sfidon normat e trashëgimisë dhe të përkatësisë klasore. Lidia Guillt, si një grua e njollosur dhe e përjashtuar nga shoqëria, e vazhdon karrierën e saj kriminale (Barickman, 133). Lidia si bigamiste, vrasëse, falsifikatore dhe mashtruese edhe në moshën 35 vjeçare, pasi u gjykua dhe u dënua për vrasje dhe për vjedhje, është ende e bukur dhe fatale (Altick, 323).

Kritikët viktorianë kanë shkruar shpesh për bukurinë e Lidia Guilltit, në kundërvënien me të këqijat e saj. Siç duket, viktorianët besonin se natyra kriminale e femrës së njollosur duhet të pasqyrohet edhe në pamjen e saj fizike. Lidia Guillt, është një grua e bukur me një natyrë të pabesë. Në librin e tij “Burgjet Kriminele” Henri Meji thekson se “femra kriminale pasi ka mbetur pa asnjë vlerë morale, për t’i përmbajtur prirjet dhe veprimet e saja shtazarake shndërrohet në kafshë të egër pa pasur fuqinë për t’i frenuar keqbërjet e saj” (Zedner, 41-42). Si për ironi, pikërisht natyra shtazarake dhe e ulët e femrës i shqetësonte meshkujt. Ndërkaq, pikërisht ana e errët dhe e rrezikshme e Lidias në të njëjtën kohë magjepsë dhe triumfon. Bojli thotë se “zonjusha Gvilld në marrëdhëniet e saj me Miduinterin, Armadelin dhe me shoqërinë në përgjithësi, përfaqëson zhvillimin e prozës së ndjenjave që përbëhet prej të mirës dhe të keqes së një femre, ose të një krijese engjëlllore dhe një tigreshe” (167).

Shkrimtari përdor disa krahasime me kafshë kur e përshkruan Lidia Guilltin. Ajo, duke ecur nëpër rrugë, e çon fustanin deri në bel për t’u ruajtur prej papastërtisë së rrugës dhe e vazhdon rrugën e saj e hareshme dhe krenar, si macja që shkon rrugës së saj pasi ta ketë frikësuar miun (A, 379). Ajo përshkruhet si një femër delikate viktoriane që zotëron një dinakëri vrastare. Po kështu, përdorimi i lokucioneve “e ngriti fustanin” sugjeron ekzistencën e një gruaje pasionante dhe erotike me një pamje engjëlllore.

Pikërisht kjo bukuri sensuale, epushore dhe kafshërore e bën zonjushën Guillt mahnitëse dhe joshëse. Lidias i kujtohet: “I pashë sytë e mëdhenj e të zinj të Miduinterit që shkëlqenin në muzg, duke e përpirë me sy që nga koka e deri te këmbët... kërko nga unë ç’të duash,” pëshpëriste ai (A, 415).

Pushteti dhe ndikimi i Hetit mbi meshkujt mbështeten në bukurinë e saj femënore; gjithashtu, natyra erotike e Lidias së rritur përbën bazën e pushtetit të saj mbi meshkujt. Miduinteri i përgjigjet Lidias: “Ta kam frikën” (A, 416). Atë e joshë kotelja, mirëpo e frikëson tigresha. Miduinteri është i mahnitur me fuqinë magnetike të seksualitetit të Lidia Guilltit, por njëkohësisht ka frikë nga natyra e vërtetë e një gruaje që fshihet nën bukurinë e saj. Sensualiteti i Lidia Guilltit përshkruhet edhe me pamjen e saj fizike: “Flokët e saj vezullonin për bukuri dhe kishin nuanca të veçanta të cilat popujt e veriut nuk i harrojnë. Ajo është ngjyra e kuqe. Buzët e saj ishin sensuale dhe joshëse”.

Flokët e kuqe ishin shenjë e gruas së rrezikshme në periudhën viktoriane. Riçard Altiku shkruan se në dramat e Mesjetës demonët dhe djajtë zakonisht kishin flokë të kuqe (316). Flokët e kuqe të Lidias autori i përdor si sugjerim i pasionit dhe i rrezikut të një krijese sfiduese dhe tunduese. Bukuria e Lidia Guilltit e gërshetuar me pasionin e rrezikshëm të saj, e bën atë tejet tërheqëse për meshkujt. Kalikofi pohon se për shumë vëzhgues viktorianë hijeshia e femrave vrastare rritej apo krijohet nga pasionet e tyre kriminale, erotike dhe

tërbuese. Lidia Guillti shfrytëzon fuqinë e bukurisë së saj sensuale si mjet për të arritur pozitë shoqërore dhe pasuri. Një pjesë e magjepsjes së Lidia Guilltit për meshkujt gjendet jo vetëm në fshehjen e natyrës së vërtetë të bukurisë së saj, por edhe në fshehjen e fytyrës së saj pas vellos. Fakti se fytyra pas vellos është pjesërisht ose tërësisht e errët dhe duket disi misterioze dhe magjepsëse. Velloja shërben jo vetëm si simbol i mashtrimit të Lidias por edhe si simbol i dualitetit të saj. Në ditarin e saj ajo shkruan:

“Ndërsa po kalonte koha, unë fillova të ndjehem tepër e emocionuar... ja ku isha aty me Armadelin, duke biseduar me një ton të hapur të lehtë, miqësor dhe duke menduar tërë kohën se si do ta eliminoja nga rruga ime e jetës kur të vinte çasti i volitshëm, ashtu si do të fshija një njollë në xhaketen time.... në atë çast, më vlonte gjaku, m’u skuqën mollëzat e faqes... m’u desh ta lëshoj vellon që ta fshehë fytyrën prej tij” (A, 486). Lidia Guillti pas vellos s’ka dyshim se nuk është ajo Lidia Guillti që e sheh bota. Velloja shërben që ta fshehë ajo natyrën e saj të mbrendshme dhe qëllimet e saj djallëzore. Velloja është edhe simbol e asaj që pretendon të jetë zonjusha Guilt. Në rini, pasi kishte kaluar ca kohë në manastir, Lidia kishte vendosur të mbante vello. Velloja e ndershmërisë që rekomandonte kisha ishte për Lidian mjet për të ruajtur fshehtësinë e saj. Mirëpo si zoti Bashvud, pasi u informua për të kaluarën e saj, ashtu edhe lexuesi mund të thonë: “Zonjusha Guillt e veshur si murgeshë është një dukuri femërore të cilën nuk mund ta shihni shpesh. Femrat janë krijesa të çuditshme” (A, 523).

Falë kalimit prej vetës së tretë në vetën e parë të Lidia Guilltit, “shoqëria e respektuar njihet me botën nëntokësore, të përshkruar me tërë ndyrësinë dhe degradimin e saj” (Hughes, 157).

Njëkohësisht, pikërisht nëpërmjet teknikës së narracionit në vetën e parë, lexuesi ka mundësi të kuptojë, madje të tregojë edhe mirëkuptim për Lidia Guilltin. Kalimi i simpatisë tek protagonistja negative është bërë edhe nga një pjesë e kritikëve të romanit. Berikmani, Mekdonaldi dhe Starku në librin e tyre *Corrupt Relations: Dickens, Thackeray, Trollope, Collins, and the Victorian Sexual System*: “(Marrëdhëniet korruptuese: Dikensi, Thekëri, Trollopi, Kollinsi, dhe Sistemi Seksual Viktorian) thonë: Ajo që i shqetësonte kritikët nuk ishte emocionimi nga krijesa të tilla si Lidia Guillti, por konstatimi i tyre se autori Kollins e kishte vënë atë në epiqendrën e romanit në atë mënyrë që ajo zgjonte simpatinë e lexuesit dhe duke bërë këtë sfidonte edhe traditën konvencionale shoqërore” (134).

Pikërisht në saje të narracionit në vetën e parë, lexuesi do t’ia dalë mbanë të futet në mendjen e Lidia Guilltit dhe ta kuptojë me dashamirësi dilemën e saj, Ndërsa bie në sy ana e errët e intrigave dhe makinacioneve të Lidias për ta shtënë në dorë pronën e Thorp Ambrozit nëpërmjet vrasjes dhe mashtrimit, por ana humane e Lidias është në konflikt me dashurinë e Miduinterit.

Në saje të narracionit të Lidias, lexuesi është në gjendje ta kuptojë ndryshimin e qëndrimit të saj:

“29, korrik... Për pakë sa nuk e tradhtova veten. Doja t’i thosha me zë të lartë, :“Gënjeshtër! Çdo gjë është gënjeshtër! Unë jam djalli në formë njeriu! Martohu më mirë me femrën më të poshtër të rrugëve dhe do të kesh një grua më të mirë se unë!” (A, 490).

Beritmen, Mekdonalldi dhe Starku pohojnë se megjithëse Lidia Guillt bën krime, vrasje, dhe falsifikime, ajo sfidon konceptin viktorian të moralit, nga se ajo i bën krimet pa brejtjen e ndërgjegjes, pikërisht si një grua e njollosur. Kjo pikëpamje, megjithatë duket se nuk i ka parasysh mendimet tjera të Lidias si dhe vdekjen e saj si viktimë.

Kur Lidia e ka të qartë se Miduinteri do të jetë viktimë e helmimit, të cilin ajo ka ndërmend ta përdorë kundër Allen Armadelit, ajo ndërhyr me qëllim që ta shpëtojë jetën e

Miduinterit: “Jeto, engjëlli im! Tërë jetën e ke përpara, një jetë të lumtur dhe të ndershme, në qoftë se të liroj unë!” (A, 666).

3. Përfundime

Ky veprim zbulon faktin se Lidia ka ndërgjegje, dhe e thekson vullnetin e Lidia Guilltit që ta flijojë veten e saj për hatër të Miduinterit. Përmes vetëvrasjes, ajo i shmanget traditës viktoriane, sipas të cilës femra e njollosur në fund duhet të vdesë. Lidia Guillti me dëshirë të sinqertë vendos të bëjë vetëvrasje si një lloj akti vetflijues për nder të njeriut të cilin e dashuron, e jo si pasojë e turpit apo e damkosjes për shkak të jetës së shturur. Vdekjen e saj nuk e imponon dënimi i shoqërisë, sepse vdekja e saj është një akt i vetëdijshëm i saj. Ndoshta lexuesi mund të vendosë vet, nëse ai është një akt i vetflijimit të ndërgjegjshëm apo është një akt i fundit rebelues të Lidia Guilltit. Ndonëse akti i krimit të Lidia Guilltit mund të konsiderohet si i jashtëzakonshëm, mbetet fakti që krimet janë megjithatë rezultat i natyrshëm i një shoqërie ku jetonin femrat. Pikëpamjet e pabaza dhe të padrejta për gratë, së bashku me pengesat shoqërore me të cilat ballafaqohen këto gra, janë kryesisht përgjegjëse për veprimet e tilla të grave. Ndërsa ato nuk janë engjëllushe, nuk mund të thuhet se janë djallëzore. Këto gra u përballën me luftën për mbijetesë në kuadrin e një kulture e cila kërkonte izolim të rreptë dhe zbatimin e normave konvencionale.

Me që Lidia vendosi që t’i cenojë botëkuptimet konvencionale mbi të drejtat e grave dhe përdorin mjete e mënyra të dhunshme për arritjen e pikësnyimeve të tyre, ajo u stigmatizua, u izolua, u mallkua dhe u dëbua; qoftë me vetëdije, qoftë me fuqinë e ligjit, ajo u eliminua nga shoqëria e respektuar angleze.

Së këndejmi Lidia Guillt në romanin e sipërpërmendur është portret jo i natyrshëm i gruas viktoriane. Nga ana tjetër, është e bukur dhe e shkathët dhe ka dëshirë të madhe që ta tejkalojë klasën e saj të prejardhjes, pa marrë parasysh barrierat dhe pengesat shoqërore. Ajo zakonisht gjykohet për shkak të anashkalimit të jetës së femrës ideale, nga njëra anë, dhe për shkak të akteve kriminale, nga ana tjetër. Po kështu, ndërsa këto gra mund të jenë konsideruar si të panatyrshme, rruga që merr secila prej tyre për ta zgjidhur dilemën e saj është pasojë e kufizimeve që u imponohen nga shoqëria viktoriane.

4. Referencat

1. Adams, J. Eli. A History of Victorian Literature, Clichester West Cambridge, 2012.
2. Aitken, J. Lyall, *Masques of Morality: Females in Fiction*, Toronto: The Women's Press, 1987.
3. Albert, E. A. History of English Literature, Hong Kong, 1985.
4. Allott, M. (Ed.). (1974). *The Brontës: The Critical heritage*. London: Routledge.
5. Altick, R. D. (1973). "The Weaker Sex", *Victorian People and Ideas: A Companion for the Modern Reader of Victorian Literature*. New York: Norton.
6. Anger, Suzy, Ed. *Knowing the Past: Victorian Literature and Culture*. London: Cornell UP, 2001.
7. Boyle, Thomas. *Black Swine in the Sewers of Hampstead: Beneath the Surface of Victorian Sensationalism*, New Your, Viking Press, 1989.
8. Collins, Wilkie "*Armadale*"
9. *Collins, Wilkie "Man and Wife"*
10. Conley, Carolyn A. *The Unwritten Law: Criminal Justice in Victorian Kent*: Oxford UP, 1991.
11. Cruttendan, Aidan. *The Victorians, Facts and Files*, London 2003.
12. Cvetkovich, Ann. *Mixed Feelings, Feminism, Mass Culture and Victorian Sensationalism*, Piscatawy. New Jersey, Rutgets UP, 1992.
13. Cunningham, Gail. *The New Woman and the Victorian Novel*. London: Macmillan Press, 1978.
14. Daiches, David. *A Critical History of English Literature, Volume II*, London, Secker and Warburg, 1963.
15. Damrosch, David Ed., *The Longman Anthology of British Literature*, New York, Addison Wesley Educational Publishers Inc., 2003.
16. Davidoff, Leonore. *Class and Gender in Victorian England In Sex and Class in Woman History*, Ed. J. Walkowitz, London, 1983.
17. Davidoff, Leonore. & Hall, C. 2002. *Familyfortunes:men and womenof the English middle class 1780-1850*. Revised edition. London, Rautledge.
18. Hughes, Winifred. *The Maniac in the Cellar, Sensation Novels of the 1860*Princeton UP, 1980.
19. Williams, Merryn. *Women in the English Novel (1800-1900)*, Macmillan Press, 1984.
20. Zedner, Lucia. *Women, Crime and Custody in Victorian England*, Oxford UP, 1991.

9.Mbrojtja e dhunës në familje

Msc. Besmir Nikqi

Zyrtar ligjor, Drejtorati për Arsim - Komuna Pejë
Qendra Kerkimore Zhvillimore PEJA

Bsc.Milot Blakaj

Qendra Kerkimore Zhvillimore PEJA

Hyrje

Dhuna në familje në ditët në të cilat jetojmë po bëhet gjithnjë e më shqetësuese. Familja si një rrjet i raporteve primare, hapësira e kohës së lirë, është vendi i shprehjes legjitime të të jetuarit të konflikteve dhe frustimeve. Në të paraqiten shqetësime dhe dalin në pah vuajtjet. Aty ku agresiviteti paraqitet si një rrezik për përbërit e vetë familjes. Dhuna në familje zakonisht përkufizohet si dhunë e cila shfaqet në vendbanime private në mes të bashkëshortëve. Përderisa shumica e akteve të dhunës në familje kryhen kundër grave ose fëmijëve, kjo dhunë mund të drejtohet edhe kundër bashkëbanuesve të tjerë, sikurse janë burrat dhe të moshuarit.

Dhuna në familje është një mënyrë e sjelljes, e cila zbatohet dhe tolerohet nga shumë shoqëri. Dëshmitë kanë treguar se dhuna në familje është çështje e zgjedhjes dhe nuk rezulton vetëm nga keqpërdorimi i alkoolit apo substancave narkotike, sëmundjes fizike apo mendore, sjelljes së pakontrolluar apo problemeve në lidhje me to. Sjelljet e zakonshme të kryesve të dhunës në familje përfshijnë përpjekjet për të kontrolluar viktimat e tyre, nënvleftësuar efektet e dhunës, fajësimin e viktimave të tyre për dhunë dhe mohimin e veprimeve të tyre.

Kryesit mund të sillen në mënyrë të qetë në sferën publike dhe në gjykatë, por privatisht vazhdojnë ushtrimin e dhunës dhe shpesh besojnë se kanë të drejtë të përdorin dhunën. Sipas Regjistrit gjyqësor të Kosovës mbi urdhëresat për mbrojtje, "viktimat zakonisht e konsiderojnë dhunën në familje si diçka unike që u ndodh atyre dhe fajësojnë veten për dhunën e ushtruar, duke racionalizuar abuzimin.

Prandaj dhuna në familje bart një kosto të lartë për shoqërinë, përfshirë shpenzimet për kujdes shëndetësor, polici, ndjekje penale, gjykim, nivel të arsimit dhe të punësimit, humbjes së ditëve të punës (që ndikojnë në BPV), produktivitet dhe ndihmë sociale për viktimat. Krijimi i një kulture pa dhunë siguron një zhvillim të lirë dhe të sigurt për çdo anëtar të shoqërisë. Për më tepër, në një fazë afatgjate mungesa e dhunës është më pak e kushtueshme për shtetin, i cili duhet të investoj në parandalim, mbrojtje dhe ndjekje të akteve të dhunës në familje. Duke reaguar ndaj dhunës e cila manifestohet në shtëpitë tona, shteti mund të dërgojë një mesazh të qartë se nuk do të tolerojë akte të tilla dhe do të ofrojë një mirëqenie për çdo qytetar të tij.

Familja paraqet një sistem kompleks, në të cilën veprojnë individë, role, përgjegjësi dhe detyra. Bëhet fjalë për një sistem të përcaktuar nga pengesa të llojit afektiv, në të cilin veprojnë qoftë efekte positive (në të cilat mund të përmendim respektin, ndarjen e gjërave të mira, dashurinë....) dhe efektet negative (në të cilat mund të përmendim urrejtjen, abuzimin, dhunën, perversionin). Familja paraqet, si definim një nga sferat për mbrojtje

potenciale të anëtarëve të saj, por mund të paraqitet edhe si një dukuri negative dhe një ambient armiqësor dhe i rrezikshëm për integritetin fizik dhe psikik të subjekteve që bëjnë pjesë në të. Cfarë ndodh në raste të tilla? Kush do të duhej të bënte diçka për zvogëlimin e kësaj dukurie? A janë të mjaftueshme ligjet dhe rregulloret për ti dhënë fund dhunës në familje në Kosovë?

Këto janë çështje të cilat do ti diskutojmë gjatë shtjellimit të kësaj teme.

1.1 Korniza ligjore e Kosovës për mbrojtjen dhe ndjekjen penale të dhunës në familje

Pasi që dhuna mund të shfaqet në forma të ndryshme, varësisht nga shteti, konteksti, kultura dhe lidhjet ndër-familjare, çdo shtet është përgjegjës për krijimin e mekanizmave të duhur ligjorë dhe institucional për t'u përgjigjur ndaj akteve të dhunës në familje brenda kornizës së ligjeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Për të përmbushur obligimin e tyre, autoritetet e Kosovës kanë miratuar disa ligje për të adresuar çështjen e dhunës në familje. Në vitin 2003, UNMIK-u ka shpallur Rregulloren për ndryshimin e ligjit në fuqi¹²¹ Neni 3 i Konventës thekson në mënyrë të veçantë se “askush nuk mund të jetë subjekt i torturës ose trajtimit poshtërues ose dënimi ky është një kombinim me nenin 1, i cili i obligon shtetet të “të sigurojnë çdokujt nën juridiksionin e tyre gëzimin e të drejtave dhe lirive të definuara në KEDNJ,” kërkon që shtetet si obligim pozitiv, të parandalojnë torturën ose sjelljen degraduese në kontekstin vendor.

E drejta zakonore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ), neni 3, kërkon që autoritet publike të ndërmarrin masa të duhura për të siguruar që individët nuk janë subject i trajtimit poshtërues (përfshirë dhunën në familje) nga persona privat. Korniza ligjore duhet të mbrojë viktimat në situata të tilla.

Sipas kësaj deklarate, person mund të konsiderohet një viktimë “pavarësisht asaj nëse kryesi i veprës është identifikuar, kapur, ndjekur penalisht apo dënuar dhe pavarësisht lidhjes familjare në mes të kryesit të veprës dhe viktimës.

Më tej, “viktimë” do të thotë personat “të cilët në mënyrë individuale apo kolektive janë lënduar, përfshirë dhunën fizike apo lëndimin mendor, vuajtje emocionale, humbjen ekonomike apo shkeljen e të drejtave të tyre themelore, përmes veprimeve apo gabimeve to cilat janë në shkelje të ligjeve penale në funksion brenda shteteve.”

Në deklaratë u kërkohej shteteve anëtare që të njohin obligimin e tyre për të parandaluar, hetuar, dhe dënuar të gjitha aktet e dhunës në familje dhe të mbrojnë viktimat e dhunës familjare. Më pas në maj të vitit 2003, UNMIK-u ka shpallur Rregulloren për mbrojtjen kundër dhunës në familje 2003/12, duke i dhënë gjykatave rolin kryesor në dhënien e urdhrave për mbrojtje si mjet juridik civil. Më tej, Kodi Penal i Kosovës (KPK) dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) përcaktojnë disa vepra penale të kryera në lidhje familjare të cilat në procedurën penale mund të konsiderohen si dhunë në familje.¹²²

Edhe pse KPK-ja vetvetiu nuk i kriminalizon aktet e dhunës në familje, sidoqoftë ajo përcakton disa vepra penale të cilat mund të konsiderohen si akte të dhunës në familje ose gabime kur ato kryhen në lidhje familjare:

¹²¹ Mbrojtja kundër dhunës në familje (rregullorja e UNMIK-ut 2003/12, 7 maj 2003);

¹²² Theodore S, Orlin “Jurisprudenca e Ligjit të të drejtave të njeriut”

- Lëndimi i lehtë dhe i rëndë trupor (neni 153 dhe 154 i KPK-së);

Shtrëngimi (neni 160);

Kanosja (neni 161);

Privimi i kundërligjshëm nga liria (neni 162);

Dhunimi, përfshirë dhunimin martesor dhe sulmin seksual (neni 193, 195);

Degradimi i integritetit seksual (neni 196);

Keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime mendore a emocionale ose me paafësi mendore (neni 197);

Rrëmbimi i kundërligjshëm i fëmijës (neni 210);

Keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës (neni 211);

Shkelja e detyrimeve familjare (nenet 212, 213);

Vendosja e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërinë dhe e punës së detyruar (neni 137); dhe

Veprat penale kundër pasurisë kur kryhen në lidhje familjare, përfshirë veprat penale të vjedhjes, shpërdorimi ose marrja e posedimit të pasurisë së luajtshme të viktimës, përfshirë mashtrimin, sikurse dhe dëmet e shkaktuara në të drejtat pronësore (nenet 252, 253, 257, 258, 260, 261).

Për të ofruar mjete juridike civile dhe penale për viktimat e dhunës në familje, ligji i zbatueshëm i Kosovës përfshinë një përkufizim të gjerë të marrëdhënieve familjare për të adresuar format e ndryshme të lidhjeve ndër-familjare që mbizotërojnë në Kosovë. Prandaj, aktet e dhunës në familje në Kosovë mund të shfaqen në mes të partnerëve intim jashtëmartesor që banojnë së bashku, dajës dhe mbesës, vjehrrit dhe nuses, dhe Rregullorja e UNMIK 2003/01 mbi ndryshimin e ligjit në fuqi lidhur me veprat penale që kanë të bëjnë me dhunën seksuale. Shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/25 dhe 2003/26 dhe ndryshuar me ligjet e Kuvendit të Kosovës, p.sh., Ligji mbi ndryshimin e kodit të përkohshëm penal të Kosovës, Ligji Nr. 03/L-02 dhe Ligji mbi ndryshimin e kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës, Ligji Nr. 03/L-03 (6 nëntor 2008). Ligje të tjera po ashtu rregullojnë forma të ndryshme të dhunës në familje të cilat ndodhin në publik ose në procedura lidhur me kontestet familjare, sikurse është ligji mbi rendin dhe qetësinë publike (Gazeta Zyrtare e KSAK. Nr. 13/81.), Ligji i Kuvendit të Kosovës mbi Familjen, Nr. 2004/32, etj.

Këto nene janë të parapara në Kodin Penal të Kosovës në Kapitujt mbi: veprat penale kundër jetës dhe trupit; kundër lirisë dhe të drejtave të personave; integritetit seksual; martesës dhe familjes; pasurisë; dhe të drejtës ndërkombëtare.¹²³ Rregullorja mbi Dhunën në Familje e adreson problemin e dhunës në familje në mes të personave në lidhje familjare të cilët ndajnë një banesë të përbashkët ose janë prindër të fëmijës.

Përkundër perceptimeve ekzistuese në mesin e disa qytetarëve, një çift nuk ka nevojë të ketë certifikatë zyrtare të kurorëzimit për të jetuar në një "lidhje familjare" dhe të jenë të dyshuar për dhunë në familje.¹²⁴ Rregullorja për mbrojtjen kundër dhunës në familje i përkufizon aktet e dhunës në familje dhe gabimet si baza për lëshimin e urdhrave për mbrojtje në procedurën e përsheptuar civile. Disa nga aktet e përkufizuara në Rregullore

¹²³ Shih definicionin e "lidhjes familjare" në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/12, neni 1.1, dhe nenin 107(24) të Kodit Penal të Kosovës

¹²⁴ Hamdi Podvorica, "E drejta Familjare", Prishtinë, 2005.

krahasohen me veprat penale të shënuara në KPK që kanë për qëllim lëshimin e urdhrave për mbrojtje. Aktet e tjera të shënuar në Rregullore e zgjerojnë përkufizimin e dhunës në familje për të rregulluar shfaqje të ndryshme të akteve të dhunës në familje dhe ofrojnë mbrojtje kundër këtyre akteve. Sepse disa akte të cilat ekzistojnë në Rregullore, por nuk gjenden në legjislacionin penal të Kosovës, është kritikuar si një zbrazëti në ofrimin e mjete efikase juridike për viktimat e dhunës në familje.¹²⁵

Rregullorja i konsideron aktet e mëposhtme si “akte të dhunës në familje”:

Shkaktimi i lëndimit trupor;

Marrëdhënia seksuale ose keqtrajtimi seksual pa pëlqim;

Qitja e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen e tij apo të saj fizike, emocionale dhe ekonomike;

Rrëmbimi;

Shkaktimi i dëmeve pasurore;

Kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;

Hyrja me dhunë në pronën e personit tjetër;

Largimi me dhunë i personit tjetër nga banesa e përbashkët;

Ndalimi i personit tjetër për të hyrë ose për të dalë nga banesa e përbashkët ose përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër.

Veçanërisht, Rregullorja kërkon ndjekje sipas detyrës zyrtare (ex officio) për shkak të shkeljes së urdhrit për mbrojtje dhe lëndimit të lehtë trupor. Kodi i mëparshëm penal që ka hyrë në fuqi pas Rregullores për mbrojtjen kundër dhunës në familje. Kodi i ri i procedurës penale të Kosovës ka larguar pjesën sipas së cilës është kërkuar që pala e dëmtuar të paraqes një shkresë në rastet e lëndimit të lehtë trupor.¹²⁶

Prandaj Prokuroria është e detyruar që të ndjekë sipas detyrës zyrtare veprat penale të lëndimit të lehtë trupor. Rregullorja për mbrojtjen kundër dhunës në familje e adreson nevojën për mbrojtje të drejtave të viktimave të dhunës në familje i mundësuar një gjyqtari që në procedurë civile të lëshojë disa masa mbrojtëse kundër kryesve të pretenduar.

Masat përfshijnë:

ndalimin që kryesi t’i afrohet viktimës brenda një distance të caktuar;

t’i ndalojë kryesit vizitimin e vendit të punës së viktimës;

ndalimin e bezdisjes;

të urdhërojë kthimin e fëmijës nën kujdesin e viktimës;

konfiskimin e armëve;

të urdhërojë kthimin e viktimës në banesën e përbashkët; dhe/ose

të kërkoj nga kryesi të paguaj qiranë për viktimën në rastet e kërcënimit të drejtpërdrejtë për sigurinë e viktimës dhe mirëqenien e saj.

Këto masa janë në dispozicion përmes lëshimit të tre llojeve të urdhrave për mbrojtje: Urdhëresat për Mbrojtje Emergjente të Përkohshme (UMEP), Urdhëresat për Mbrojtje

¹²⁵ Mbrojtja kundër dhunës në familje (rregullorja e UNMIK-ut 2003/12, 7 maj 2003)

¹²⁶ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 153.

Emergjente (UME) dhe Urdhëresat për Mbrojtje (UM). Kodi Penal i KSAK dhe Kodi i Procedurës Penale të ish Republikës Jugosllave.¹²⁷ A PIT Sipas Rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje, përgjegjësia primare në ofrimin e mbrojtjes viktimave të dhunës në familje bie mbi gjykata.

Gjykata mund të lëshoj dy lloje të urdhrave për mbrojtje:

Urdhrat për Mbrojtje Emergjente (UME) dhe
Urdhrat për Mbrojtje (UM).

Dallimet në mes të urdhrave janë kohëzgjatja për të cilën ato zbatohen, afatet e gjykatave për të lëshuar urdhrat për mbrojtje dhe masat të cilat mund të aplikohen kundër kryesve. Urdhrat për mbrojtje e plotësojnë njëri tjetrin me UME-në të lëshuar në procedurë të shpejtë në rastet kur siguria dhe mirëqenia e viktimës konsiderohet të jenë në rrezik. Nëse gjykata lëshon në mënyrë të shpejtë një UME, kjo nuk e ndalon atë që së pari të lëshojë UM në rast se viktimë ose personi i autorizuar kërkon një urdhër të tillë. UME-ja duhet të lëshohet brenda 24 orëve dhe duhet të konfirmohet brenda 48 orëve nga lëshimi në seancë të rregullt gjyqësore të thirrur nga një gjyqtarë i vetëm në prani të viktimës dhe kryesit të pretenduar. UM-ja lëshohet për një kohëzgjatje maksimale prej 12 muaj dhe mund të përfshijë masa shtesë kundër kryerësit. Afati për lëshimin e UM-së është 15 ditë në seancë të rregullt gjyqësore dhe më së shumti mund të lëshohet për 12 muaj.

Agjencia për zbatimin e ligjit, Policia e Kosovës, është e obliguar të mbikëqyrë zbatimin adekuat të UM-së, që përfshin ndërmarrjen e masave në rast të shkeljes së UM-së. Rregullorja po ashtu parasheh që policia mund të lëshoj një lloj të tretë të UM-së, Urdhrin për mbrojtje emergjente të përkohshme (UMEP) për një periudhë prej 48 orëve kur gjyqtarët nuk janë në dispozicion, siç është rasti gjatë natës ose fundjavës.

1.2 Pozitat juridike në brendësi të një familjeje

Realizimi aktual i vlerave të barazisë në fushëne e marrëdhënieve familjare është frut i një evoluimi kompleks, në të cilin kanë luajtur një rol themelor faktorët politikë, ekonomikë, social, kulturor dhe ato juridikë. Kalimi nga një shoqëri bujqësore në një shoqëri të industrializuar, nga një regjim politik totalitar në një regjim demokratik, me pasoja evoluimin e moralit dhe të zakoneve, ka përcaktuar një ndryshim të thellë të strukturës familjare, duke rritur në këtë mënyrë autonominë dhe pavarësinë e individëve brenda grupit familjar.

Në bazë të evoluimit dhe krijimit të legjislacionit dhe të Shtetit, dhe në ballafaqim me familjen si një institucion juridik¹²⁸ janë krijuar principet e barazisë së bashkëshortëve dhe mos pranimit të principit hierarkik i cili themelonte modelin e familjes tradicionale.

1.3 Të drejtat e familjes si të drejta themelore të njeriut

Definimi i përbërjes së familjes si shoqëri natyrale (neni 29 pika 1) nënkupton njohjen e të drejtave familjare si të drejta themelore të njeriut. Ndër to dy janë ato më të rëndësishmet,

¹²⁷ Raporti i Misionit të OSBE në Kosovë, pjesa 6, "Të drejtat e viktimave. Rishikimi i sistemit të drejtësisë penale 2000-2001".

¹²⁸ Alessio Aneschi, "Dhuna familjare", aspektet penale, civile dhe kriminologjike, 2009.

liria e gjithësecilit për krijimin e familjes sipas zgjedhjes së tij/asaj, dhe brenda kësaj familjeje të zhvillojë dhe krijojë personalitetin e tij/asaj në liri të plotë.

Të njohurit me interesat e realizuara në familje, si shoqëri natyrale, janë thelbësore të njeriut, shënon kufinj të ndërhyrjes nga Shteti, i cili nuk mundet, në emër të interesave publike, të tjetërsojë apo të ndalojë shprehjen e lirë të individëve në sferën e tij familjare. I takon individit të të realizojë vlerat e raporteve të tij familjare, ndërsa Shtetit i takon detyra e ofrimit të kushteve për zhvillimin e këtyre raporteve. Ndërhyrja e Shtetit pra drejtohet në mbrojtjen e individit në familje.

Të drejtat e familjes janë personale, përderisa janë të drejtuara ndaj mbrojtjes së individit dhe në interesat e tij morale dhe materiale. Personaliteti i ngushtë i të drejtave të familjes përkthehet në mirëkuptimin dhe respektin e ndërsjelltë¹²⁹. Ndër të tjera, nevoja e stabilitetit të raporteve familjare dhe interesat e tyre janë themelore dhe duhet të mbrohen nga Shteti.

1.4 Të drejtat e personit brenda një familjeje

Çdo individ ka te drejte të jetë i mbrojtur në brendësi të sistemit familjar. Ligji në Kosovë në fakt parasheh si të drejtë themelore dhe të pacënueshme të njeriut në zhvillimin e plotë të tij, në raportet sociale, në familje dhe në punë. Ky princip shprehet edhe në Kushtetuten e Kosoves.

Ndër të tjera Konventa Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore (e datës 4 nëntor 1950) shpreh të drejtën jetësore (neni 2), të drejtën e individit për tu martuar dhe për të krijuar familje (neni 12), dhe gjithashtu të drejtën e jetës private dhe të asaj familjare (neni 8). Edhe traktati i Bashkimit Europian (hyrë në fuqi më 1 nëntor 1993) parasheh mbrojtjen e të drejtave të njëriut.

1.5 Të drejtat dhe obligimet e bashkëshortëve

Ligji në Kosovë parasheh të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve të cilët lidhin martesë. Në ligjet të cilat ekzistojnë më herët dhe tanimë nuk janë në fuqi e shohin figurën e bashkëshortit si një kryefamiljar i cili duhet të mbrojë gruan, ta mbajë afër dhe ti sigurojë asaj jetesën. Të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve mund të lindin, respektivisht, në favor të të dy bashkëshortëve dhe të fëmijëve të lindur nga martesa e tyre.

Personat të cilët lidhin martesë kanë të drejta dhe obligime dhe principi i besnikërisë, i mirëkuptimit, e dhënies së të drejtës për njëri tjetrin janë thelbësore gjatë lidhjes së martesës midis dy personave. Të dy bashkëshortët kanë të drejtat dhe liritë e tyre të plota në ushtrimin e profesionit, në pasurinë e cila ngrihet mbas datës së martesës dhe gjithashtu secili ka detyrimet e përbashkëta në këtë lidhje martesore.

1.6 Të drejtat dhe detyrimet prindërore ndaj fëmijëve.

Edhe përsa i përket, fëmijëve, shoqëria ka filluar të kuptojë se marrëdhëniet ndërmjet një të rrituri dhe një fëmije jo gjithmonë janë të bazuara në dashuri, në respekt. Shumë shpesh dashuria ndaj fëmijëve kthehet ose zëvendësohet nga dhuna e llojeve të ndryshme,

¹²⁹ Suzan Murphy, *“Defending our Lives – getting away from domestic violence and staying safe”*, 1996

dashuria ndaj fëmijës nuk ndalon shfaqjen e urrejtjes dhe agresivitetit të të rriturve dhe është krijuar bindja se fëmija është pronë e prindërve dhe me të mund të bëhet çfarë të duan.

Prindërit janë të detyruar t'i rrisin fëmijët, t'i edukojnë dhe të kërkojnë ti mësojnë të jenë të arsimuar për vetën dhe për shoqërinë. Fëmijët kanë të drejtat e tyre. Shumë pak në vendin tonë flitet për të drejtat e fëmijëve dhe funksioni edukativ në shkollë është shumë pak efikas në këtë drejtim. Fëmija duhet konsideruar si person i cili ka të drejtat¹³⁰ e tij, dhe është një burim i të ardhmes.

Keqtrajtimet ndaj fëmijëve apo shfrytëzimi i fëmijëve paraqet një problematikë për të gjithë shoqërinë. Gjëja më shqetësuese është se keqtrajtimet ndaj fëmijëve nuk denoncohen ose këto raste janë të pakta. Ky problem bëhet gjithnjë e më i madh kur keqtrajtimet përsëriten, nuk lajmërohen organet kompetente, trauma e fëmijës vetëm rritet dhe ajo më e keqe është se lidhja midis viktimës dhe abuzuesit është lidhje familjare.

Përderisa Qendrat për punës sociale (QPS-të) kanë përgjegjësi të ndryshme, puna e tyre në veçanti sa i përket viktimave të dhunës në familje që i qasen drejtësisë përfshinë aftësinë për të kërkuar Urdhrin Mbrojtës në rastet e dhunës në familje kur janë të përfshirë fëmijët. QPS-të kanë përgjegjësi ligjore që të përfaqësojnë interesat më të mira të fëmijës në procedurat gjyqësore. Në rastet civile, QPS-të ofrojnë mendimin e tyre në lidhje me kujdestarinë e fëmijës. Indirekt, QPS-të mundën gjithashtu të ndikojnë në qasjen në drejtësi. Sigurimi i asistencës sociale dhe/ose mbështetja e QPS-së në rastet e kujdestarisë së fëmijëve mund të bëjë ndryshim për gratë që kërkojnë lirim nga lidhjet familjare të dhunshme dhe/ose të sigurojnë kujdestarinë e fëmijëve të tyre. Neni 6 (2) i rregullores për mbrojtje kundër dhunës në familje. Një numër i ligjeve udhëheqin shërbimet sociale në ofrimin e mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje (do të thotë Ligji për shërbimet sociale dhe familjare, Ligji për familje, rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje, etj.).

2.1 Dhuna në Familje – Fenomen antik

Dhuna në familje, në pjesën më të madhe, paraqitet si një fenomen maskilist, i cili lind nga bindja se ata mund të dominojnë të drejtat trupore, shpirtërore, ekonomike dhe marrëdhëniet me partneren. Nëse gruaja në raste të tilla merr një rol pasiv dhe viktimizues, atëherë dhuna mund të arrijë nivele jonormale dhe kriminale. Ja se si shkruan një grua për dhunën që ka pësuar nga bashkëshorti padron i saj: "... jam në kufijt e rezistencës sime psikologjike dhe fizike sepse kam duruar për më shumë se njëzet vjet çdo lloj ngacmimi, dhune morale dhe materiale në mua dhe në jetën e fëmijëve të mi nga ana e bashkëshortit tim. Tani me rritjen e fëmijëve të mi shoh se po afrohem drejt një tragjedie më të madhe se sa ajo të cilën kam arritur ta shmang deri tani, e shoh veten të detyruar të marr masa dhe të kërkoj ndihmën e autoriteteve për të shmangur atë që mund të jetë e pashmangshme"

Vetëm në këto vitet e fundit fenomeni i dhunës në familje, dhe në veçanti dhuna kundër grave në familje (qoftë ajo bashkëshortja, nëna apo motra), është transformuar nga një çështje private në një problem publik. Deri pak dekada përpara, mbi bazën e një mjedisi familjar të ndryshëm nga ai i sotmi gruaja e cila denonconte¹³¹ dhunën e pësuar në të shihej si një devijuese, një grua ndryshe nga të tjerat e cila kishte dështuar në detyrën e saj ndaj familjes në mbajtjen e familjes të bashkuar.

Megjithatë, dhuna e kuptuar si fizike, psikologjike, sociale, ekonomike dhe seksuale, e ushtruar nga ana e një subjekti më të fortë në përballje me subjektin tjetër më të dobët,

¹³⁰ Philip Cook, "The hidden side of domestic violence", 1999

¹³¹ David Powilson, & Poul Trip, "Abuzimet shtëpiake. Si të ndihmojmë?"

(gra, fëmijë, të moshuarit,) është një fenomen social me origjinë të kahershme. Ky fenomen është studiuar në dekadat e fundit nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës¹³². Këto studime janë bërë edhe në Europë. Analizat kanë sjellë në dritë ndryshimet kulturore dhe pasojat direkte janë si rrjedhojë e ndërhyrjeve legislative qoftë në nivel nacional dhe në atë internacional.

2.2. Llojet e dhunës familjare

Në një kuptim më të gjërë dhuna familjare nuk është kufizuar vetëm në rrahjen e bashkshortes siç mendohet zakonisht. Ajo mund të marrë trajta dhe forma të ndryshme siç janë :¹³³

Dhuna fizike.

Abuzimi fizik mund të jetë shuplaka, rrahja, përdredhja e krahut, gjuajtja, shtërgimi në fytyrë, djegija, goditja, kërcnime me objekt, me armë, apo kërcimi për vrasje. Përfshin gjithashtu mohimin e nevojave bazë për ekzistencë siç janë: ushqimi, gjumi, ndihma mjeksore, si dhe çdo lloj akti dhune të krijuara për të kontrolluar, bërë keq, dëmtuar apo sulmuar fizikisht partnerin.

Dhuna psikologjike

Abuzimi psikologjik përfshin sjellje që synojnë frikësimin dhe persekutimin dhe merr formën e kërcnimeve, braktisjes apo ubuzimit, mbylljes në shtëpi, mbajtjes nën kontroll, kërcnime për të marrë fëmijët, shkatërrim të pronës, izolim, privim, agresion verbal dhe poshtërime të vazhdueshme. Kjo dhunë ka për synim të degradojë, poshtërojë dhe të përlulë në publik apo privatisht viktimën.

Dhuna ekonomike

Abuzimi ekonomik që përfshin veprime të tilla, si kontroll me anën e të ardhurave që sigurohen në familje, refuzim për të kontribuar financiarisht, mohim të nevojave për ushqim dhe nevojave tjera bazë, kontroll i punësimit, etj. Viktima ka liri të kufizuar ose nuk ka fare, nuk ka kontroll mbi të ardhurat familjare, duke e detyruar atë të jetë e varun prej abuzuesit për para' dhe mbijetë.

Dhuna seksuale

Abuzimi seksual shfaqet si seks me dhunë përmes kërcnimit, frikësimit apo forcës fizike, kryesë së marrëdhënieve seksuale me forcë, detyrimit për të kryer marrëdhënie seksuale pa dëshirë, apo detyrimit për të kryer marrëdhënie seksuale me të tjerë, sulmi fizik ndaj pjesëve seksuale të trupit të gruas, ose bërja e komenteve seksuale përlulëse dhe poshtëruese. Kjo përfshin edhe cdo tentativë për të detyruar me forcë bashkeshorten për të kryer akte seksuale kundër dëshirës së saj.

Dhuna shoqërore

¹³² Suzan Murphy, "Defending our Lives – getting away from domestic violence and staying safe", 1996

¹³³ Betty A Reardon, "Jo dhunës, toleranca pragu i paqes", 2001

Izolimi shoqëror i forcuar ose kontrolli shoqëror, ku abuzuesi ndalon gruan e tij të ketë kontakte shoqërore, ose në mënyr strikte kontrollon cdo kontakt me miqtë ose me familjarë, kufizon atë cka bën gruaja, me kë takohet, cka lexon, ku shkon etj...

2.3 Cikli i dhunës familjare

Edhe pse në mënyrë të dukshme dhuna familjare ndodhë papritur me ose pa provokim, ajo nuk është një veprim i izoluar dhe pazakontë nga ana e abuzuesit apo ekzekutorit të dhunës. Ajo manifestohet me sjellje para dhe pas incidentit sic vijon:¹³⁴

Faza përgaditore

Tensioni përgaditet brenda ekzekutorit për arsye të ndryshme sic janë janë presionet familjare, streset e punës apo vet rrjedha e mendimeve të tij. Sjellja e tij bëhet gjithnjë e më agresive dhe më e ashpër, varësisht sa fortë viktimë përpiqet që ta qetësojë atë. Në disa raste disa individë kanë një seri sjelljesh të ndryshme ndaj këtij tensioni i cili mund të mos përfshijë përdorimin e dhunës por në mardhënie abuzuese i lë vend fazës në pritje.

Faza në pritje

Gjatë kësaj faze gruaja ndjen se është nën kontrollin e burrit të saj, si rrjedhojë e fuqisë së tij fizike dhe kërcnimeve të tij reale për ti bërë keq asaj. Sulmet e tij gojore do ta dobësojnë gruan më tepër.

Faza shpërthyesë

Në këtë fazë, një shpërthim dhune ndodhë nga ana e ekzekutorit e cila bëhet zakonisht si një furi në vetvete e drejtë. Këto shpërthime kanë tendencë të shpeshtohen në kohë.

Faza e pendimit

Pas sulmit bashkëshorti hyn në fazën e pendimit. Ai mundë të ndihet i turpëruar, fajtor, ose edhe i friksuar për pasojat. Megjithatë ai do të mohojë ose nënvlerësojë dhunën dhe do të refuzojë të marrë përgjegjësi për veprimet e tij.

Ai mundë të thotë se ajo është përgjegjëse për dhunën pasi e provokoi atë, se ajo e meriton atë ose ai që jashtë kontrollit dhe nuk po kuptonte se çfarë po bënte. Për fat të keq, gruaja shpesh ka tendencë të besojë këtë "arsyetim", për të ruajtur marrëdhënien.

Faza e ndjekjes

Nëse viktimë largohet pas veprimit të dhunshëm, ai zakonisht do të përpiqet ti kthejë mendjen. Kjo është gjithashtu e njohur si faza e blerjes mrbrapsh, sepse ai do të përpiqet të kthejë pas partneren e tij duke e mbushur me dhurata luksoze, duke u treguar i dashur dhe i vëmendshëm, dhe duke i premtuar se nuk do ta lëndojë përsëri. Ajo mund të kthehet duke

¹³⁴ Alessio D'aiuto, " Dhuna në familje", 2001.

besuar se ai ka ndryshuar. Nëse ajo vazhdon të refuzojë kthimin mbrapsht ai mund të përdorë kërcnime dhe më shumë dhunë.

Ai mund të kërcënojë se do t'ia bëj jetën tepër të vështirë, pavarësisht nga varfëria e tyre, gjendja financiare, fëmijët, të afërmit e të tjera. Kjo është periudha në të cilën ndodh numri më i madh i vrasjeve familjare. Nga ana tjetër ai mund të bëhet si i pashpresëse nuk mund të ia dal pa të dhe kërcënon me vetëvrasje, nëse ajo nuk kthehet. Shumë gra kthehen duke u ndjerë të kërkuara, ose ngaqë ato ndjejnë se duhet të mbrojnë atë që të mos i bëj keq vetes. Cifti kalon në fazën e muajit të mjalit.

fëmijëve, ndjekja duhet të reagoj në pajtim me kërkesat e ligjit në fuqi.

3.3 Këshilli Gjyqësor i Kosovës – Përmbledhje e rezultateve të rasteve penale

Përmbledhje të rasteve penale për vitin 2008

Rastet penale kundër krimeve kundër jetës dhe trupit rregullohen me nenin 146 – 157. Në të gjitha rastet e poshtëpërmendura kryerësi i veprës dhe viktimat janë në lidhje familjare.

Rastet penale të bartura nga viti 2007 ka qënë 2.036

Rastet penale të iniciuara në vitin 2008 është 759

Numri i përgjithshëm i rasteve në vitin 2008 është 2.795

Nga këto janë 482 janë raste të zgjidhura me aktgjykimin dhe përfshijnë:

Burgim – 52

Dënim me gjobë – 237

Dënim me kusht – 182

Vendime të tjera të gjykatës 10

Të falur 5

Aktgjykime të refuzuara 12

Të zgjidhura përmes metodave të tjera 122

Numri i rasteve të pazgjidhura në vitin 2008 është 2.174 135

Neni Krime kundër jetës dhe trupit (NeneVit200) Kusht Burgosj

Viti

Vitet	Raste	Përfunduara	Përfunduara në vijim		AKUZA	
				Lëndime	Kërcënime	Totali
2005	72	22	50	61	11	72
2006	73	53	13	60	13	73
2007	47	28	19	32	15	47
2008	47	28	19	38	9	47
2009	24	1	22	42	18	60
TOTALI	263	132	123	233	66	299

Rezultatet e gjykimeve të përfunduara

Viti	Gjoba (€)	Kusht.	Burgosje	Trajtim psikiatri	Vërejtje	Palët kanë	Kryesi është	Ri-gjykim	totali
------	-----------	--------	----------	-------------------	----------	------------	--------------	-----------	--------

¹³⁵ Burimi i të dhënave gjyqar penalist, gjykata komunale, 2009

				k	gjkatës	ndaluar procedur e	falur		
2005	11	6			2	1	2		22
2006	35	17	2		1	1	1	2	59
2007	21	6		1					28
2008	21	7							28
2009		1					1		2
TOT									

Burimi: Gjyqtar penalist, Gjykata Komunale, 2009157) / Lëndim i lehtë trupor (krysi dhe vik-
Llojet e rasteve tima janë në lidhje familjare) - 153

Neni Krime kundër jetësUMRI I PËRGJITHSHËM I RASTEVE NË VITIN 2008 2,795

Pasi që ligji është i qartë në lidhje me dënimet që duhet zbatuar në rastet e lëndimeve trupore në lidhjet familjare, është esenciale që gjykatat të zbatojnë ligjin në mënyrë korrekte. As ndërmjetësimi dhe as pushimi i rasteve nuk duhet përdorur nga gjykatat si metoda për zgjidhjen e rasteve penale. Më parë, përmes zbatimit të duhur të ligjit, gjykatat kanë mundësinë të ofrojnë një “rrugëdalje” dhe kushte më të mira për gra (dhe burra) në situata të dhunshme. Ndjekja e përshtatshme dhe dënimi, të kombinuara me masa shtesë të lëshuara nga gjykatat komunale, sikurse alimentacioni, të drejtat pronësore, dhe pagesa e qirasë nga krysi, do të adresojnë tutje disa nga shqetësimet e shfaqura nga gjyqtarët sa i përket alternativave në dispozicion për gra pas qasjes në drejtësi.

3.4 Shërbime psikologjike dhe mjekësore të vlefshme për viktimat e dhunës në familje.

Shërbime psikologjike dhe mjekësore të vlefshme për viktimat e dhunës në familje ofrohen nga shoqëria civile. Shumë gra-viktima të dhunës e kanë më të lehtë të drejtohen në qendrat spitalore, sesa të paraqiten në polici për të bërë denoncimin përkatës. Spitalet, shërbimet e urgjencës janë pikat e para ku drejtohen gratë e abuzuara. Megjithatë, mungon trajnimi i vazhdueshëm për specialistët që të mundësohet evidentimi i shenjave kur ato janë shenja të dhunës në kushtet familjare. Shërbimet psikologjike mbi veçantitë e këtij target-grupi nuk sigurohen. Sidoqoftë, prania e psikologëve pranë qendrave të shërbimit shëndetësor përbën një hap pozitiv, por, jo rrallë, ndodh që, kur këto viktima paraqiten në qendrat spitalore, nuk shprehen me specialistët rreth shkaqeve të vërteta të dëmtimeve që kanë pësuar.

PËRFUNDIMI

Dukuria e dhunës është e pranishme në familjen shqiptare. Përlllogaritja e shtrirjes së kësaj dukurie të dhembshme është e vështirë në kushtet kur mungojnë të dhënat zyrtare, kur nuk ka shërbime publike, kur nuk ka një ligj që e ndalon atë, kur të dhënat grumbullohen vetëm nga një palë burime, kur viktimat nuk denoncojnë dhe kur shoqëria në përgjithësi nuk është ende gati për t'i thënë "Stop!" dhunës në familje.

Nga të dhënat që burojnë kryesisht nga shërbime e policisë dhe nga gjykatat, rezulton se forma të dhunës që takohen në mjediset shqiptare, janë ato klasiket: dhunë fizike, dhunë emocionale, dhunë seksuale dhe dhunë ekonomike.

Mbizotërimi i këtyre formave ndryshon në varësi të zonës, shkallës së ndërgjegjësimit, si dhe karakteristikave të viktimës dhe dhunuesit. Megjithatë, rezulton se format e sipërpërmendura, në shumicën e rasteve takohen të kombinuara dhe jo të pastra.

Dhuna është një dukuri e dhembshme e realitetit mbarëbotëror dhe shoqërohet me pasoja të viktimës. Nga dhuna vuajnë jo vetëm gratë, por edhe fëmijët, të moshuarit dhe vetë dhunuesi. Pasojat e dhunës mund të grupohen në pasoja të: shëndetit mendor, shëndetit fizik dhe shëndetit riprodhues.

Faktorët që ndikojnë te dhuna janë të shumtë dhe të shumëfishtë. Ata mund të klasifikohen si faktorë të nivelit makro, të familjes ose mikro dhe faktorë individualë. Në përpjekje për ta konkretizuar më tej natyrën e faktorëve ndikues mund të përmendim situatën ekonomike, politike, kulturën dhe norma të një kulture të lidhura me dhunën, lëvizjet demografike të popullsisë, faktorë që kanë të bëjnë me familjen, si; modeli i prindërve, edukata, atmosfera, si dhe faktorë personalë të lidhur me personalitetin e dhunuesit dhe të viktimës.

Situata aktuale mund të ndryshojë nëse ligjet në Kosovë nuk janë të aplikueshme vetëm në letër por ato duhet të implementohen dhe të jenë në favor të atyre që me të vërtetë pësojnë dhunën në familje. Gjithashtu kjo kërkon ndërgjegjësim të publikut, të grupeve të ndryshme sociale, të të gjitha moshave dhe të profesionistëve.

REKOMANDIME

Me gjithë përpjekjet serioze të shoqërisë civile, shtetit, medias dhe aktorëve të tjerë për të rritur ndërgjegjësimin e përgjithshëm shoqëror në lidhje me problemin e dhunës ndaj gruas në familje apo dhunës në familje në përgjithësi, rezultatet nuk janë optimiste.

Tradita, kultura përbëjnë faktorë që veprojnë në kah të kundërt me këto përpjekje, e ushqejnë, e justifikojnë dhunën në familje dhe mbajnë një qëndrim indiferent ndaj saj duke e trajtuar si një çështje private dhe jo si çështje mbarëshoqërore .

Duket se shoqëria kosovare është larg një reagimi jotolerant ndaj dhunës. Me gjithë arritjet modeste, ajo vazhdon ta konsiderojë dhunën në familje si një çështje që nuk i takon askujt, përveç personave të përfshirë në të dhe vetëm atyre.

Kjo situatë kërkon në radhë të parë rritjen e ritmeve të punës për ndërgjegjësimin e publikut të gjerë për ndryshimin e qëndrimit dhe të vlerësimit të dhunës në familje.

Ndryshimet në mendësi duhet të shoqërohen me një legjislacion që të reflektojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, pa dallim race, gjinie apo statusi martesor. Legjislacioni është instrument sa mbrojtës, aq edhe me efekt parandalues.

Media është një tjetër mjet që mund të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit mbi këtë dukuri. Media, si ajo e shkruar, ashtu edhe elektronike, vitet e fundit është përfshirë në përpjekje për të promovuar barazinë gjinore, por ende është larg standardeve bashkëkohore. Në rekomandimet për barazinë mes grave dhe burrave në Media të Këshillit të Europës, roli i medias konsiderohet i rëndësishëm në formimin e qëndrimeve dhe të vlerave të individëve, si dhe një instrument i dobishëm për të realizuar ndryshime sociale. Për të arritur këtë synim fisnik, për të formuar një qëndrim të ri, vlera të reja, për të realizuar ndryshime të mëdha sociale, ajo duhet të përballet me mendësinë ekzistuese, të paraqesë dimensionet e reja që kanë marrë rolet gjinore në kulturën ekzistuese dhe traditën, të përballet me mungesën e profesionalizmit.

LITERATURA

A. Babani, " Dhuna ndaj gruas, studim eksplorues", Tiranë 2003, f. 49.

Anceschi, Alessio, Dhuna familjare, aspektet penale, civile dhe kriminologjike, 2009

Betty, A. Reardon, Toleranca pragu i pages, 2001

Cook, Philip, The hidden side of domestic violence, 1999

D'aiuto Gianluca, Dhuna në familje, 2011;

E. Gjermani, Të Mbijetuarat e dhunës në familje. Roli i profesionistëve dhe shërbimet sociale në ndihmë të tyre, "Trajtesa Juridike dhe sociale për mbrojtjen nga dhuna në familje" 2005

Halili, Ragip, Viktimologjia, Prishtinë, 2007

Kanuni i Leke Dukagjinit, neni 43, kapitulli XII

Murphy, Suzan, Defending our lives – getting away from domestic violence and staying safe, 1996

Mustafa Qosaj, Arjana & Farnsëorth, Nicole "Fjalë në letër"? : Përgjigja e organeve të drejtësisë ndaj dhunës në fami

10.Dënimi me gjobë ndaj veprave penale në republikën e Maqedonisë

PhD candidate, Nurten Kala Dauti

International University of Struga

Faculty law,teaching assistant

n.kala@eust.edu.mk

Abstrakt

Dënimi si sanksion për pengimin e kriminalitetit dhe sjelljeve të rrezikshme në shoqëri, të cilat rrezikonin intereset e përgjithshme, vlerat e individit dhe të shoqërisë, ekziston që në shoqëritë primitive. Liritë dhe të drejtat e qytetarëve mbrohen me Kushtetutë si akti më i lartë juridik-politik I një vendi dhe me kodin penal pozitiv të vendit. Që të mund të shqiptohet dhe të zbatohet një dënim me gjobë, së pari duhet të ekzistoj vepra penale. Pasi ekziston vepra penale shihet a janë plotësuar kushtet për shqiptimin e dënimit me gjobë, bëhet matja e tij dhe cili është qëllimi që duhet të arrihet me këtë sanksion të shqiptuar që ekzekutohet.

Dënimi me gjobë bën pjesë në grupin e dënimeve pasurore.

Fjalët kyqe: vepër penale, dënimi me gjobë, kryesi, përgjegjësi penale.

Zbatueshmëria dhe ekzekutimi i dënimit me gjobë

Dënimi me gjobë është dënim i cili shqiptohet dhe ekzekutohet më së shpeshti pas dënimit me burgim në praktikën gjyqësore të shteteve të ndryshme të botës. Lidhur me ekzekutimin e tij në praktikën gjyqësore nuk ka probleme të veçanta kur personi i dënuar në mënyrë vullnetare e zbaton këtë dënim, gjegjësisht e paguan gjobën me të cilën është dënuar nga gjykata kompetente.¹³⁶

Problemi shfaqet atëherë kur personi i dënuar me gjobë nuk e përmbush detyrimin vullnetarisht atëherë shteti është i obliguar ti vë në funksion instrumentat e tjerë siç është ekzekutimi i detyrueshëm të dënimit me gjobë. Gjykata kompetente pas shqiptimit të dënimit me gjobë e informon të dënuarin për numrin e llogarisë ku duhet të paguhet dhe intervalin kohorë deri kur duhet të përmbushet obligimi. Nëse e sheh të arsyeshme gjykata mund tia mundësoj përmbylljen e detyrimit ta bëj edhe me këste.

Zbatueshmëria e dënimit me gjobë sipas Kodit penal në Maqedoni

E drejta bashkëkohore penale në shtetinë tonë dhe shtetet fqinje kthehet nga dënimi me gjobë si një prej alternativave kryesore të dënimit me burgim. Është pikëpyetje nëse ky këthim i

¹³⁶Halili Ragip. "Penologjia shkenca mbiezekutimin e sanksioneve penale", Prishtinë, 2005, fq.251

tillë mund të ketë sukses nëse njëkohësisht nuk kthehet në funksionin e dyfishtë të dënimit me gjobë: plotsimin e karakterit publik juridik të dënimit edhe në interes të të dënuarit. Kërkesat e pasurisë sigurohen me këthimin e lëndëve ose me konfiskimin e shfrytëzimit të pasurisë ose dëmshpërblimin e dënimit.

Nga njëra anë dënimi me gjobë do të thotë zvoglim i pasurisë së kryerësit, por nga ana tjetër që është e rëndësishme, zvoglimi i këtillë i pasurisë duhet të ketë pasoja më afat gjatë në pakësimin e mundësisë së kryerësit për harxhime dhe për plotësimin e nevojave të tij që kanë ekuivalencë të të hollave.¹³⁷ Nga kjo vijmë në konkluzion se dënimi me gjobë ka veprim afatgjatë ashtu që i dënuari e ndien si kufizim personal.

Në KPM, për dënimin me gjobë janë përcaktuar disa karakteristika të përgjithshme:¹³⁸

- Karakteristikat themelore të dënimit me gjobë duhet të zbatohen në kohën kur shqiptohet dhe zbatohet ky dënim kryerësit të veprës penale.
- *Dënimi duhet të jetë personal.* Nga kjo kuptohet që dënimi dhe pasoja e tij të duhet të godas kryerësin e veprës penale, por jo edhe të afërmit e tij. Megjithatë pasojat negative e dënimit ndikoj edhe të të afërmit e të dënuarit, është e përshtatshme që të shqiptohet ai dënim që pasoja e tij ndikon më pak të të afërmit e kryerësit.
- *Dënimi duhet të jetë human.* Nga kjo kuptohet që ndaj të dënuarit të mos bëhen mundime dhe përbuzje duke i shkaktuar pasoja fizike dhe psikike në shëndetin e tij. Duhet garantuar dhe respektuar personalitetin dhe dinjitetin e njeriut, jetën si dhe integritetin truport të dënuarit.
- *Dënimi duhet të jetë i ligjshëm.* Dënimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, këtu duhet vlen të theksohet parimi i ligjshmërisë (nulla poena sine lege). Çdo dënim që shqiptohet duhet të jetë i paraparë me ligj si dhe të jetë përcaktuar lloji dhe lartësia.
- *Dënimi duhet të shqiptohet nga organi i caktuar shtetëror* - Gjykata, e cila është organi shtetëror i posaçëm që bën shqiptimin e dënimit në procedurë gjyësore.
- *Dënimi duhet të jetë proporcional më peshën e veprës penale* si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të kryerësit. Proporcionaliteti dhe drejtësia shprehet duke marrë parasysh jo vetëm peshën e veprës penale, por duhet marrë edhe rethana tjera subjektive dhe objektive si sjelljen, jetën si dhe rethana tjera në lidhje me të dënuarin.

¹³⁷ Osmani Afrim, "Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve", Shkup, 2013, fq. 238-239

¹³⁸ <http://juridiksi.e-monsite.com/faqe/e-drejta-penale/leksione/matja-e-denimit.html>

- *Dënimi duhet të jetë njëlloj për gjithë kryersit e vepreave penale*, duke mos marrë parasysh gjininë, racën, nacionalitetin, fenë, kombësinë, gjuhën, etj. Ky tipar konsiston në vëninen e barazisë në mes kryersve përpara ligjit dhe gjykatës.
- *Dënimi duhet të jetë i ndarë*, ai duket ti ngjasoj veprës dhe kryersit të veprës, varësisht pesha e veprës, rrethanat në të cilat ajo është kryer si dhe shkallës së rrezikshmërisë së kryersit të veprës, dënimi ndahet se si ai mund të shqiptohet në masë të vogël ose të madhe.
- *Dënimi duhet të jetë i revokueshëm*, me këtë dënim jepet mundësi të bëjë revokim të dënimit në të gjitha rastet kur konstatohet se shqiptimi i dënimit ka qenë pasoj e disa provave të rrejshme në procedurën gjyqësore.
- *Dënimi duhet të jetë i përmisueshëm*, kjo shprehet në rastet kur dënimi është shqiptuar në kundërshtim me ligjin për arsye të dëshmisë së rrejshme, ky tipar i dënimit është prezent më se shumti te dënimet pasurore.
- *Dënimi duhet të jetë i zëvendësueshëm*, sipas këtij tipari mund të kuptojmë të gjithë rastet të bazuara ku mund të zëvendësohet dënimi me ndonjë dënim tjetër, por më qëllim që dënimi tjetër i shqiptuar të arrij qëllimin e dënim më me sukses.

Pra, dënimi që i shqiptohet kryersit duhet të godas vetëm atë, qoftë me kufizim lirie qoftë me dënim me para. Ligjërisht ndalohen torturimet apo malltretimet fiziko-psiqike të të dënuarit, do me thënë edhe pse është i dënuar duhet të respektohet dinjiteti dhe personaliteti i tij si individ. Që të konsiderohet vepër penale veprimi i kryesit duhet që më parë të jetë përcaktuar e tillë në ligj, nëse nuk është e përcaktuar më parë në ligj atëherë nuk kemi të bëjmë me vepër penale. Poashtu, dënimi duhet të jetë i revokueshëm nëse gjykata ka shqiptuar aktgjykim dënues duke u bazuar në prova të rrejshme. Zëvendësimi i dënimit me dënim tjetër mund të bëhet vetëm me qëllim që të ketë sukses ndaj kryersit.

Qëllimi i gjobës si dënim

E drejta jonë penale i përkrah teoritë e përziera në lidhje me qëllimin e dënimit. Kjo mund të shihet nga dispozitat me të cilat përfshihet kjo çështje.

Në nenin 32 të Kodit Penal të R.M është përcaktuar qëllimi i përgjithshëm i dënimit. Në këtë dispozitë është paraparë se qëllimet e dënimit përveç realizimit të drejtësisë të ndara janë:

1. Pengimi i kryerësit të kryej vepra penale dhe riedukimi i tij dhe
2. Në mënyrë edukative të ndikoj ndaj të tjerëve të mos kryejnë vepra penale.

Siç shihet nga dispozitat e lartëpërmendura të kodit penal, del qartë se e drejta jonë e përveteson preventivën e posaçme dhe të përgjithshme si qëllim të dënimit.

Pra, përveç që të pengohet kryesi që mos bëhet recidivist, po ashtu të ndikojë që edhe të tjerët mos kryejnë vepra penale.

Preventiva e posaçme shprehet në parag. 1 të nenit 32 të kodit penal në të cilën si qëllim i dënimit parashihet “Parandalim i kryesit të veprës të kryej vepra penale dhe rehabilitim i tij”, ndërsa preventiva e përgjithshme është përcaktuar në parag.2 të nenit të njëjtë, ku thuhet se “qëllimi i dënimit është të parandaloj personat e tjerë që të mos kryejnë vepra penale, përkatesisht ndikimi preventiv ndaj të tjerëve që të mos kryejnë vepra penale”.

Qëllimi i preventivës së përgjithshme apo gjenerale të dënimit, i cili është sublimuar në kodin penal me postulatit që të ushtrojë ndikim edukativ ndaj të tjerëve, arrihet edhe me një atribut të dënimit, i cili shprehimisht nuk është theksuar në kodin penal, mirëpo ai është immanent në të. Ky është në fakt efekti frikesues i dënimit ndaj kryesve të mundshëm të veprave penale. Rrjedhimisht me faktin se për çdo vepër penale është paraparë dënimi që do ti shqiptohet kryesit të veprës penale, kjo është një lloj kanosje dhe si e tillë ushtron edhe efekte frikesuese. Shumë persona nuk kryenë vepra penale ngase e dinë se do të ndëshkohen

dhe kështu krahas privimeve tjera, do të humbasin dhe autoritetin që gezojnë në shoqëri.¹³⁹ Parashikimi i dënimit të veprave penale të kryera me veprim ose me mosveprim ndikon në respektimin e rendit shtetëror nga qytetarët si rezultat i frikës së sanksionimit.

Në kuadër të preventivës gjenerale, e drejta penale synon që të ushtrojë funksionin etikë dhe përgjegjësinë në shoqëri. Shqiptimi i dënimit personave që e kanë shkelur dhe cenuar moralin e shoqërisë nëpërmjet krimit, qëllimi i dënimit këtu del se është aspirat përmbrojtje të moralit në shoqëri.

Nga gjithë kjo që u tha më lartë lind pyetja: a thua krahas preventivës gjenerale dhe speciale si qëllim i dënimit është edhe hakmarrja?

Përgjigjia valide në këto dilema nuk mund të jepet duke u mbështetur vetëm në dispozitat e nenit 32 të KPM, në të cilat shprehimisht flitet për qëllimin e dënimit, por duhet të merren parasysh të gjitha dispozitat e kodit penal si dhe disa parime të përgjithshme të së drejtës penale, të cilat në menyrë të tërthortë i referohen dhe e zgjidhin këtë çështje.

Në dispozitat e përgjithshme penale juridike, lloji dhe lartësia e dënimit përcaktohet sipas intensitetit dhe sasisë së të keqes- dëmit, që kryesi i veprës penale i ka shkaktuar individit

¹³⁹ Kambovski, Vllado.” *E drejta penale pjesa e përgjithshme*, Shkup, 2006, fq. 888-890

dhe shoqërisë. Së këndjemi, del qartë se edhe sot e kësaj dite, edhe pse në përmasa më të vogla në krahasim me të kaluarën, dënimi përmbanë në vete edhe një dozë të hakmarrjes.

Mirëpo, hakmarrja, si qëllim i dënimit nuk mund të kuptohet ashtu çfarë ka qënë para disa shekujve, e sidomos në mesjetë. Përkundrazi në të drejtën penale bashkohore, hakmarrja duhet kuptuar edhe trajtuar si qëllim që në shoqëri të arrihet drejtësia, ngase akoma jetojmë në kohën e cila kërkon që për vepra penale më të rënda të shqiptohen dënime të rënda. Mirëpo përmbushja e këtij postulati duhet të sendërtohet në menyrë racionale e jo afektive për tu përmbushur qëllimet e dënimit si preventivë individuale por edhe si preventiv e përgjithshme.

Në të kaluarën sanksionimi ka qënë me karakter hakmarrës, kjo vërehet më së miri në funksionimin e të drejtës së Talionit, ku vlenin parimet sy për sy, dhëmb për dhëmb, ndërsa tani qëllimi hakmarrës është që të vijet drejtësia në vend, të respektohen normat shoqërore dhe friksimi i kryesve potencial se do të ndëshkohen për veprimet që janë përcaktuar që më parë si verpime të kundër ligjshme.

Nga gjithë kjo që u tha më sipër, mund të përfundojmë se dënimi, krahas qëllimit të preventivës individuale dhe të përgjithshme duhet të përmbush edhe qëllimin e drejtesisë.

Sipas Kodit penal të Maqedonisë nuk është i përgjegjshëm kryerësi që gjatë kohës së kryerjes së veprës penale nuk ka mundur të kuptojë rëndësinë e veprës së tij ose nuk ka mundur të udhëheq me veprimet e tij për shkak të sëmundjes së përhershme ose të përkohshme psikike ose pengesave tjera të rënda psikike.

Një ndër kushtet tjera për shqiptimin e dënimit me gjobë është edhe fajësia si element subjektiv i veprës penale, me të cilën nënkuptohet se ndëshkohen vetëm kryesit e fajshëm të veprave penale. Një person konsiderohet se veprën e ka kryer me faj në rastet kur ka ditur se në veprimin apo në mosveprimin e tij do të shkaktoj pasojë të ndalur.

Kushtet për shqiptimin e dënimit me gjobë

Për shqiptimin e dënimit me gjobë në bazë të Kodit Penal dhe ligjeve tjera në fuqi, duhet zbatuar rregullat të përgjithshme të shqiptimit, duke mos i shqiptuar këto dënime si mënyrë diskriminimi duke u bazuar në racë, ngjyrën e lëkurës, gjininë, këndvështrimeve politike, prejardhjes etnike, përkatësisë fetare, fisit, arsimimit, moshës, apo nivelit material e pasuror.

Çdo aktivitet njerëzor, i thjeshtë apo kompleks, sjell një konsumim të vazhdueshëm të burimeve të energjisë. Siç e tregojnë edhe shkencat fizike e biologjike, është evident relacioni mes zhvillimit ekonomik dhe entropisë (çrregullimi i sistemit biofizik). Përmes këtij punimi, kemi kërkuar të tregojmë domosdoshmërinë e ekzistencës së limiteve në lidhje me shfrytëzimin e burimeve energjitike në zhdukje dhe nevojën për mbështetje juridike të politikave për mbrojtjen e mjedisit, duke analizuar legjislacionin aktual të vendeve të rajonit, konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm, sipas të cilit vetëm duke kontrolluar zhvillimin ekonomik mund të garantohet rritja e mirëqënies për gjeneratat e tanishme dhe të ardhshme. Përmes një kërkimi të kujdesshëm të studimeve kryesore të ndërmarra në këtë sektor, rezulton se një strategji e mirë mund të jetë përdorimi i kontrolluar i burimeve të energjisë në zhdukje dhe drejtimi i tregut drejt burimeve alternative të energjisë së riciklueshme, duke rritur kështu kostot e përdorimit të burimeve natyrore në zhdukje dhe duke stimuluar zhvillimin e një sistemi energjitik të bazuar në modelin "Green economy", ku mjedisi konsiderohet si investim në qëndër të të cilit qëndron shfrytëzimi i burimeve të energjisë së riciklueshme. Në përfundim kemi sygjyeruar që ky model të gjeje mbështetje juridike në vendet e rajonit tonë, pasi kjo do sillte si rrjedhojë zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm duke siguruar një mbrojtje dhe përmirësim të atij që konsiderojmë investimin më të madh në lidhje me burimet energjitike: "mjedisin"!

I. Hyrje

Në këtë punim është ndjekur tentativa për të evidentuar strategjitë dhe politikat të cilat në mënyrë konkrete mund të ndiqen nga vendet e rajonit tonë, duke vlerësuar si pozitive eksperimentin në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin ekonomik, të disa vendeve të tjera të cilat kanë kohë që po aplikojnë modelin "green economy"¹⁶⁸. BE-ja për të përballuar krizën aktuale, ka propozuar politika të drejtuara drejt modelit "green economy", e quajtur ndryshe *low carbon economy*¹⁶⁹, duke paraqitur indikacione të qarta që nxisin shtetet për të gjetur investime në sektorin "jeshil". Në vendet e rajonit tonë, duhet theksuar se nuk mungojnë mbështetjet juridike në lidhje me çështjen shumë delikate të mbrojtjes së mjedisit, madje ato janë në përputhje të plotë me direktivat e Parlamentit europian të cilat rregullojnë parimet dhe politikat e tutelës së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm¹⁷⁰. Në bazë të studimeve konkrete, raporteve dhe vlerësimeve të ekspertëve dhe specialistëve të fushës, problemi i evidentuar, më së shumti qëndron te mosparashikimi i atyre programeve dhe

¹⁶⁸Sipas Komunikatës së Komisionit të Parlamentit Europian, në Këshillë, në Komitetin Ekonomik dhe Social Europian, numër 363, del 20 giugno 2011, "green economy" është: « Një ekonomi që gjeneron rritje, krijon punë dhe largon varfërinë duke investuar dhe mbrojtur burimet ekapitalit natyrorë nga ku varet mbijetesa e Planetit tonë ».

¹⁶⁹ Duke paraqitur indikacione të qarta që nxisin shtetet për të gjetur investime në sektorin "jeshil".

¹⁷⁰ CECCHETTI M., *Il principio costituzionale di unitarietà dell'ambiente*, in AA. VV., *Ambiente e diritto*, a cura di GRASSI S. – CECCHETTI M. – ANDRONIO A., Firenze, 1999, f. 261

politikave strategjike konkrete dhe sektoriale, për fusha të veçanta dhe të caktuara, por me impakt shumë të lartë për mjedisin, zhvillimin ekonomik e për rrjedhojë sigurisht edhe për cilësinë e jetës së banorëve¹⁷¹.

Ky punim ka qëllimin për të treguar se si modeli green economy, në lidhje me shfrytëzimin e energjisë së riciklueshme duke përdorur burimet alternative, duhet marrë parasysh, sepse mund të jetë një politikë e dobishme në lidhje me këtë çështje edhe orientimi i konsumatorit drejt atyre produkteve, prodhimi i të cilave kërkon procese të cilat shfrytëzojnë burime alternative të energjisë.

Fillimisht është paraqitur një kuadër i përgjithshëm i legjislacionit përkatës për mbrojtjen e mjedisit, në disa vende të rajonit tonë, konkretisht, në Shqipëri dhe Mal të Zi. Më pas janë trajtuar problematikat kyçe konkrete, të cilat shqetësojnë studiuesit e këtij sektori, duke trajtuar parimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Krahasimi i sipër-cituar ka pasur si qëllim të tregojë se si, mbrojtja ligjore dhe mbrojtja e mjedisit zënë një rëndësi kyçe në lidhje me zhvillimin ekonomik, por kjo nuk mund të jetë e mjaftueshme nëse në mënyrë konkrete dhe faktike, nuk veprohet menjëherë, duke ndërhyrë *in primis*, në zbatimin konkret të ligjit për mbrojtjen e mjedisit, e më pas duke vepruar me politika për çdo fushë përkatëse.

II. Shqyrtimi i legjislacioni aktual për mbrojtjen e mjedisit, në vendet e rajonit

Njeriu konsiderohet si subjekt përgjegjës i kushteve që mbajnë dhe drejtojnë ekuilibrin ekologjik, duke nënvizuar kështu lidhjen e pandashme ndërmjet gjeneratave të tanishme, të ardhshme dhe mjedisit. Nga këtu ka lindur nevoja për krijimin e instrumenteve dhe institucioneve juridike për mbrojtjen e mjedisit, si një investim i mirë për zhvillimin ekonomik. Në vendet e rajonit tonë, çështja e mbrojtjes së mjedisit është një pikë kyçe dhe delikate, dhe kjo jo për mungesën e mbrojtjes dhe normativës juridike në mbrojtje të mjedisit për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, por për shkak të mungesës nga ana konkrete e lëvizjeve strategjike dhe politikave të cilat vënë në zbatim, atë që në fakt legjislacionet përkatëse në mbrojtje të mjedisit, paraqesin më së miri¹⁷².

Në Shqipëri, mbrojtja e mjedisit parashikohet nga Ligji nr.10431, dt.09.06.2011, «Për mbrojtjen e mjedisit», me qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, duke e ruajtur dhe përmirësuar atë, duke parandaluar dhe pakësuar rreziqet ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe duke siguruar kushtet për një zhvillim të qëndrueshëm në vend¹⁷³. Gjithashtu në bazë të germës c, të nenit 3 të këtij ligji, një ndër objektivat parësor të tij është ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesmarrje publike dhe në germën ç të po këtij neni, vendoset si qëllim primar i ligjit për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri, përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj¹⁷⁴. Gjithashtu neni 5 i Ligjit nr. 10 431, datë 09.06. 2011, «Për mbrojtjen e mjedisit», përkufizon qartësisht fushën e zbatimit të këtij ligji, duke theksuar se mbrojtja e mjedisit nga ndotja e dëmtimi përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë¹⁷⁵. Ky Ligj është përafëruar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21.04.2004

¹⁷¹ JONAS H., Il principio responsabilità. Un'etica per la civiltà tecnologica, Torino, 2009, f. 176.

¹⁷² Montorsi, T., «Crisi economiche, sostenibilità ambientale e politiche pubbliche: Il ruolo del legislatore e della pubblica amministrazione», (tesi di dottorato di ricerca in diritto ed economia), Università 'degli studi di Bologna, Bologna, 2013, f. 6-12.

¹⁷³ Ligji nr. 10 431, datë 09.06. 2011, «Për mbrojtjen e mjedisit», neni 1.

¹⁷⁴ Po aty, neni 3.

¹⁷⁵ Ligji nr. 10 431, datë 09.06. 2011, «Për mbrojtjen e mjedisit», neni 5.

«Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin», të ndryshuar¹⁷⁶. Në nenin 8 të këtij ligji, parashikohet parimi i ruajtjes së burimeve natyrore, sipas të cilit mbrojtja e mjedisit realizohet duke ruajtur njëkohësisht burimet natyrore, përmes kursimit, përdorimit të efektshëm apo zëvendësimit të lëndëve të para natyrore e të materialeve të përfutuara prej tyre dhe ripërdorimit, riciklimit e rekuperimit të mbetjeve, ndërsa autoritetet publike, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve e projekteve, brenda kompetencave të tyre, nxitin marrjen e masave dhe kryerjen e veprimtarive për mbrojtjen e burimeve natyrore¹⁷⁷.

Në zbatim të programeve kombëtare të monitorimit të mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti përkatës për kontrollin e cilësive dhe vënien në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse, duke hartuar çdo vit¹⁷⁸ (ne faqen zyrtare të Ministrisë gjenden vetëm raportet nga viti 2011 deri në 2015), raportin për gjendjen në mjedis. Duke qenë se nuk rezultojnë publike raportet për vitet e fundit, jemi marrë kryesisht me analizën e Raportit për Gjendjen në Mjedis për vitin 2014 hartuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) si dhe nga disa studime të posaçme për gjendjen e elementëve të mjedisit në Shqipëri, siç ishte grupi I punës IV, Sesion II, "Ndotja e mjedisit në Shqipëri dhe Standartet Europiane", Pjesëmarrës në Sesionin I, Grupin e Punës: Institucione shtetërore dhe shoqëri civile¹⁷⁹. Grupi i punës u përqëndrua kryesisht në diskutimin e çështjeve më urgjente të ndotjes, si ndotja e ajrit, ujrave, tokës dhe në problemin e

menaxhimit të mbetjeve një nga sektorët kryesorë që ndikon në ndotjen e mjedisit në Shqipëri¹⁸⁰.

Në fakt, Raporti 2014 i AKM-së, ofron disa të dhëna të pjesshme në lidhje me gjendjen e ndotjes së Ajrit në Shqipëri. Kjo për arsye se, siç përcaktohet në raport "rrjeti ekzistues i monitorimit të cilësisë së ajrit në Shqipëri është i kufizuar në aspektin e numrit të stacioneve monitoruese po ashtu edhe në tipin e stacioneve". Në raportin e tij përfundimtar ky grup pune thekson faktin se ndotja e tokës nga metalet e rënda është një problem shqetësues për Shqipërinë duke qenë se ka aftësinë të ndikojë seriozisht në shëndetin e njeriut nëpërmjet zinxhirit ushqimor të rritur dhe të ushqyr në tokat e ndotura. Mungesa e informacionit mbi shkallën e ndotjes së tokës nga metalet e rënda shpesh ka çuar në përdorime të përshtatshme të tokës me pasoja në shëndetin e njerëzve si përsëmbull përdorimi i tokës për kultivimin e bimëve të arave. Shkarkimet urbane të ujrave të patrajtuara kanë një ndikim të dukshëm edhe në cilësinë e ujërave detare. Gjithashtu grupi i punës evidenton faktin se, menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri është i decentralizuar¹⁸¹, pra kryhet nga organet përkatëse të pushtetit vendor të cilat kryesisht kontraktjnë shoqëri private për kryerjen e shërbimeve të mbledhjes dhe transportimit të mbetjeve. Sistemi i riciklimit të mbetjeve në Shqipëri është ende në fazën fillestare¹⁸².

¹⁷⁶ Numri CELEX: 32004L0035, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 143, datë 30.04.2004, faqe 56-75.

¹⁷⁷ Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21.04.2004 «Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin», të ndryshuar, neni 8.

¹⁷⁸ Marrë nga : <http://akm.gov.al/cil%C3%ABsia-e-mjedisit.html>.

¹⁷⁹ Rekomandime, Sesion II "Ndotja e Mjedisit në Shqipëri dhe Standardet-Europiane", 2015.

¹⁸⁰ Po aty, f. 3-15.

¹⁸¹ Po aty, f. 6.

¹⁸² Nuk ka një sistem të sigurtë për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme, siç janë mbetjet industriale, shtëpiake dhe spitalore. Metoda më e përdorur për trajtimin e mbetjeve është ajo e groposjes, por gropat e përdorura për këtë qëllim nuk kanë strukturën e përshtatshme ose janë vendosur në zona të ndjeshme të cilat çojnë në ndotjen e mjedisit.

Mjedisi është ndër-territorial, pra i kalon kufijtë e një vendi dhe për këtë arsye Bashkimi Evropian i jep një rëndësi të veçantë mbrojtjes së tij. Prej vitesh BE-ja ka miratuar një sërë Direktivash dhe Rregulloresh të cilat përcaktojnë standarte të rrepta për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të cilat mund të ndikojnë në ndotjen e mjedisit. Ekspertët e Grupit të Punës nënvizuan rëndësinë e legjislacionit dhe standardeve të BE-së në fushën e mbrojtjes së mjedisit, duke analizuar veçanërisht dy direktiva kyçe për mbrojtjen e Mjedisit¹⁸³. Eksperti i Grupit të Punës vuri në dukje se disa elemente të legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e

mjedisit janë të përafëruara me standartet evropiane. U përmend si shembull ligji kuadër nr. 10431 "Për mbrojtjen e mjedisit", i cili është përafëruar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE mbi përgjegjësinë mjedisore, të përmendur më sipër dhe përmban disa nga parimet e kësaj direktive si parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, parimin e zëvendësimit dhe kompensimit, parimin ndotësi paguan etj. Gjithashtu ligji 10431, ashtu si Direktiva 2004/35/KE parashikon edhe mundësinë që publiku ti kërkojë autoriteteve marrjen e masave në rast kërcënimi apo ndotje të mjedisit. U përmend edhe fakti që Kodi Penal shqiptar parashikon disa vepra penale si krime mjedisore.

Grupi i Punës theksoi se problemi kryesor qëndron jo aq në mangësitë e legjislacionit shqiptar sesa në mungesën e zbatimit të legjislacionit ekzistues. U përmend fakti që shpesh ka mangësi në miratimin e akteve nënligjore zbatuese, si dhe realizimi i VNM-ve lë për të dëshiruar dhe në të shumtën e rasteve realizohen nga një specialist i vetëm edhe për projekte të komplikuar. Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e mjedisit duhet të vazhdojë me shpejtësi përafrimin me legjislacionin evropian veçanërisht për sa i përket ligjeve sektoriale për mbrojtjen e elementëve të mjedisit. Gjithashtu i gjithë legjislacioni mjedisor duhet të harmonizohet në mënyrë që të mos ketë boshllëqe dhe mbivendosje kompetencash, gjë e cila mund të arrihet hartimit të një kodi mjedisor i cili të rregullojë në mënyrë të harmonizuar të gjithë sektorin.

U vu në dukje se mungon koordinimi ndërmjet institucioneve të ndryshme kompetente për mbrojtjen e mjedisit midis të cilave ka mbivendosje përgjegjësish dhe konflikte kompetencash si dhe mungojnë mekanizmat administrativ dhe procedurial për zbatimin e legjislacionit.

Mali i Zi është një shtet lider kur trajtohet çështja e ndërgjegjshmërisë ambientale, në fakt në vitin 1991, deputetët e Parlamentit të tij, vendosën ta deklarojnë Malin e Zi shtetin e parë ekologjik në botë¹⁸⁴. Parimet e tutelës ambientale parashikohen në një tërësi ligjesh dhe aktesh nënligjore¹⁸⁵, në fakt Mali i Zi ka firmosur një tërësi marrëveshjesh ndërkombëtare

¹⁸³Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21.04.2004, "*Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin*", e cila sjell disa risi, si regjimin e përgjegjësive edhe pa faj për ndotësit që kryejnë aktivitete me rrezikshmëri për mjedisin dhe mundësimin e grupeve të interesit dhe OJF-ve mjedisore t'i kërkojnë autoriteteve publike të **veprojnë** në raste ndotje dhe t'i drejtohen gjykatës në rast se konsiderojnë që veprimi apo mosveprimi i autoriteteve është i paligjshëm. Direktivën 2008/99/EC "*Për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet legjislacionit penal*" e cila përbën një hap thelbësor në kuadrin e mbrojtjes së mjedisit nëpërmjet legjislacionit evropian duke qënë se për herë të parë u kërkohej shprehimisht shteteve antare mbrojtja e mjedisit, nga disa lloje të rënda ndotje, me anë të legjislacionit penal.

¹⁸⁴ Kushtetuta e Malit të Zi, neni 1.

¹⁸⁵ Legge sull'Ambiente del Montenegro ("Gazzetta Ufficiale del Montenegro" n.48/08, 40/10, 40/11) ; Legge sulla valutazione strategica dell'impatto ambientale ("Gazzetta Ufficiale della Repubblica del Montenegro n. 80/05 e "Gazzetta Ufficiale del Montenegro" n. 73/10,

mbi mbrojtjen e mjedisit. Konkretisht problematikat për këtë sektor, pavarësisht se nuk mungojnë parashikimet ligjore, siç thekson raporti i vlerësimit CAU¹⁸⁶, qëndrojnë në mungesën e politikave të ndryshme të cilat garantojnë për aktivitetet në sektorin e naftës dhe gazit, një veprimtari konkrete zhvillimi në mënyrë ekologjike, të qëndrueshme dhe në mbrojtje të ambientit. Sipas këtij vlerësimi, do të ishte gjithashtu e dobishme, adoptimi i një strategjie nacionale për të kontrastuar efektet e ndryshimeve klimatike në Malin e Zi, të cilat nuk ndodhin vetëm për shkaqe natyrore por më së shumti për shkak të shterrimit të burimeve energjetike natyrore¹⁸⁷.

III. Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm dhe alternativ i energjisë së riciklueshme

Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm bën pjesë tashmë në legjislacionet e vendeve të rajonit, në kriteret orientuese përmes së cilave formohen politikat publike, merren masat ligjore dhe ushtrohet pushteti administrativ. Për këto arsye, ky parim merr një rol shumë të rëndësishëm në këtë punim, sepse përfaqëson një parim të përgjithshëm që çdo shtet duhet të marrë në konsideratë, kur bëhet fjalë për politikat publike dhe ushtrimin e funksioneve administrative¹⁸⁸.

Sipas parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, është e pandashme lidhja mes mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit ekonomik, të cilat duhet të jenë të harmonizuara me njëra-tjetrën për të siguruar pikërisht zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Në fakt ky parim gjendet në nenin 37, të Kartës së të Drejtave themelore të BE-së, i cili parashikon një mbrojtje të lartë të mjedisit dhe një përmirësim të cilësive të tij, si detyrim për politikat e vendeve të BE-së për të garantuar me siguri, principin e zhvillimit të qëndrueshëm¹⁸⁹.

Zhvillimi i qëndrueshëm duhet të sigurojë rritjen e mirëqënies përmes një fluksi të rregullt të konsumit e për këte duhen vlerësuar burimet natyrore dhe kapaciteti i tyre për rigjenerim, duke zëvendësuar burimet natyrore me burimet artificiale¹⁹⁰. Një strategji mund të jetë efikase vetëm nëse përdoren me kujdes burimet natyrore të disponueshme, gjë e cila mund të arrihet duke modifikuar pikërisht modelet aktuale të prodhimit të energjisë. Prandaj ka qenë gjithmonë e domosdoshme ndjekja e një politike ambientale në favor të zhvillimit të qëndrueshëm. Këtu mund të përmendim vendosjen e një takse ekologjike për dëmet ndaj ambientit, ose rritjen e çmimit për ato produkte, prodhimi i të cilave kërkon një proces me impakt të lartë ambiental, të cilat mund të jenë incentive kryesore për të stimuluar tregun drejt

40/11 e 59/11); Legge sulla valutazione dell'impatto ambientale del Montenegro ("Gazzetta Ufficiale della Repubblica del Montenegro" n. 80/05 e "Gazzetta Ufficiale del Montenegro" n. 40/10, 73/10, 40/11 e 27/13) etj.

¹⁸⁶ CAU-Centro per l'Architettura e Urbanistica, Istituto per lo Sviluppo la Ricerca nel settore della salute e della sicurezza (ITI) e Earth Link & Advanced Resources Development (ELARD), të cilat merren e vlerësimin ambiental strategjik për Malin e Zi.

¹⁸⁷ Marrë nga: <http://ëëë.milleunadonna.it/green/rubriche/stefania-elena-carnemolla/articoli/16231/montenegro-il-futuro-e-green/>,

¹⁸⁸ BRUNDTLAND G.H., *Il futuro di tutti noi. Rapporto della Commissione mondiale per l'ambiente e lo sviluppo*, Milano, 1989, f. 97-120.

¹⁸⁹ ZITO A., *I limiti dell'antropocentrismo ambientale e la necessità del suo superamento nella prospettiva della tutela dell'ecosistema*, in AA. VV., *Ambiente, attività amministrativa e codificazione. Atti del primo colloquio di diritto dell'ambiente*, Teramo, 29-30 aprile 2005, a cura di DE CAROLIS D. – FERRARI E. – POLICE A., cit., 6 ss.

¹⁹⁰ HICKS J.R., *Value and capital. An inquiry into some fundamental principles of economic theory*, Oxford, 1939 (trad. it. *Valore e capitale*, Torino, 1954), Torino, 1954, f.234-235.

një sistemi energjitik internacional të bazuar në burimet e energjisë së rinovueshme si dhe për të stimuluar zhvillimin teknologjik për këtë sektor¹⁹¹.

Një mbështetje të qartë juridike, parimi i zhvillimit të qëndrueshëm e gjen nga e drejta (kushtetuese) evropiane, në veçanti nga neni 191, paragrafi 3, i TFE-së, sipas të cilit kjo e fundit, në paraqitjen e politikës së saj në mbrojtje të mjedisit, duhet të marrë parasysh zhvillimin social ekonomik të BE-së në tërësi dhe të zhvillimit të ekuilibruar të vendeve anëtare. Gjithashtu në bazë të nenit 3, paragrafi 3, i TBE-së, zhvillimi i qëndrueshëm në vendet e BE-së, bazohet në një rritje ekonomike të ekuilibruar, në stabilitetin e çmimeve, në një ekonomi sociale në favor të punësimit dhe progresit social, si dhe në një mbrojtje dhe përmirësim të cilësisë së mjedisit.

IV. Konkluzione dhe rekomandime: Modeli «green economy» në mbështetje të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm për vendet e rajonit

Gjetja dhe aplikimi një politike energjetike e cila përshtatet me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, prezanton një nga sfidat kryesore jo vetëm për vendet e rajonit tonë.

Në bazë të këtij parimi nuk mund të konsiderohet i qëndrueshëm një zhvillim ekonomik i bazuar në një prodhim energjitik me emision të lartë të gazit ndotës për mjedisin dhe mbi zhfrytëzimin e burimeve energjetike tradicionale. Burimet energjetike të rinovueshme, prezantojnë shumë avantazhe, sepse kjo formë energjie nuk kontribuon vetëm në mbrojtjen e mjedisit, por ngadalëson proceset që sjellin ndryshime klimatike (problematikat e sjellura për rastin e Malit të Zi), si dhe garantojnë zhvillimin e infrastrukturave të reja.

Bëhet kështu e domosdoshme, parashikimi i instrumentave rregullatore që inkurajojnë përdorimin e këtyre burimeve alternative të energjisë¹⁹², duke favorizuar kështu pavarësinë ekonomike të vendeve të rajonit tonë. Kjo mund të arrihet falë një sistemi të ri të prodhimit përmes burimeve alternative të energjisë, duke sjellur si pasojë një fenomen pozitiv për vendet e rajonit: shkëputjen nga varësia e domosdoshme për energjinë e shteteve të industrializuara, të cilat janë eksportueset më të mëdha të energjisë natyrore në zhdukje.

Nuk mund të lëmë pa përmendur, lidhjen e ndërsjellte që është verifikuar në vitet e fundit, mes emergjencës ambientale dhe krizës ekonomike, duke vënë theksin mbi rolin e rëndësishëm që "energjinë e gjelbër" mund të ketë në mbështetje të zhvillimit ekonomik.

Sugjerojmë që këto forma të burimeve alternative energjetike, të përdoren nga politikat strategjike të vendeve të rajonit tonë, sepse një element shtesë përveç atyre të përmendur më lart, është edhe zvogëlimi i kostës së kësaj energjie për shkak të rritjes së kërkesës që kjo formë energjie ka pasur kohët e fundit, dhe kjo sigurisht i bën më kompetitive këto teknologji energjetike të rinovueshme në krahasim me ato të formës tradicionale. Nuk duhet harruar se këto burimeve energjetike të rinovueshme mund të gjenerojnë energji në çdo pjesë të Planetit tonë dhe të përdoren menjëherë, duke eliminuar kështu pengesat dhe problemet e dispersionit që rrjedh nga transporti i energjisë në vendet e rajonit tonë.

Duke parë problematikat në sektorin energjitik, të vendeve të rajonit tonë, rekomandojmë prodhimin e energjisë së gjelbër, e cila gjenerohet nga burime të rinovueshme energjetike, për arsye të mëposhtme:

¹⁹¹ PERMAN R. – MA Y. – MCGILVRAY J. – COMMON M., *Natural Resources and Environmental Economics*, London, 2003, f.20-45.

¹⁹² Burimet alternative të energjisë modern: hidroelektrike, bioenergjitë, fotovoltaike, eolike, solare, gjeotermike, *biofuels* dhe biomasa.

1. Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm në rajon përmes mbrojtjes së mjedisit, duke plotësuar kështu edhe një ndër kriteret e vendosura për tu plotësuar nga vendet anëtare të BE-së.
2. Prodhimi i kësaj forme energjetike lufton ndryshimet klimatike, të cilat do të ishin drastike për zhvillimin ekonomik të bazuar në turizëm për vendet e rajonit.
3. Zvogëlimi i varësisë energjetike të eksportuar nga vendet e industrializuara të cilat kanë monopolizuar këtë sektor.
4. Do të zvogëlonte varfërinë përmes zhvillimit të tregjeve të reja të punës.
5. Përfaqeson një përgjigje për pasigurinë e mjaftueshmërisë së burime tradicionale energjetike.
6. Në kontekstin e krizës aktuale ekonomike, sektori i energjisë së rinovueshme ka treguar (falë mekanizmave nxitës të përmendur gjatë këtij punimi), duke dhënë prova përmes shteteve që e përdorin këtë sistem energjetik, një rritje konstante të investimeve. Në lidhje me këtë pikë të fundit, Komisioni European kohët e fundit përmes deklaratave ka rilevuar se vendet e punës në ekonominë e gjelbër kanë vazhduar të rriten dhe sipas parashikimeve, kjo rritje do të mbesë solide. Sektorët e efikasë energjetike dhe të energjive të rinovueshme mundet që të vetme, të krijojnë 5 milion vende të reja pune brenda vitit 2020¹⁹³.

Gjithashtu, për të nxitur këtë proces, propozojmë një thjeshtësim dhe eliminim të elementeve burokratik në lidhje me procedurat administrative autorizuese, për lidhjen dhe vendosjen në funksion të impianteve energjetike, në mënyrë që uljes së kostos së teknologjisë ti shtohet edhe ulja e kostove indirekte.

Bibliografia:

1. Montorsi, T., «*Crisi economiche, sostenibilità ambientale e politiche pubbliche: Il ruolo del legislatore e della pubblica amministrazione*», (tesi di dottorato di ricerca in diritto ed economia), Università 'degli studi di Bologna, Bologna, 2013.
2. HICKS J.R., *Value and capital. An inquiry into some fundamental principles of economic theory*, Oxford, 1939 (trad. it. *Valore e capitale*, Torino, 1954).
3. PERMAN R. – MA Y. – MCGILVRAY J. – COMMON M., *Natural Resources and Environmental Economics*, London, 2003.
4. BRUNDTLAND G.H., *Il futuro di tutti noi. Rapporto della Commissione mondiale per l'ambiente e lo sviluppo*, Milano, 1989.
5. ZITO A., *I limiti dell'antropocentrismo ambientale e la necessità del suo superamento nella prospettiva della tutela dell'ecosistema*, in AA. VV., *Ambiente, attività amministrativa e codificazione. Atti del primo colloquio di diritto dell'ambiente*, Teramo, a cura di DE CAROLIS D. – FERRARI E. – POLICE A. 29-30 04.2005
6. CECCHETTI M., *Il principio costituzionale di unitarietà dell'ambiente*, in AA. VV., *Ambiente e diritto*, a cura di GRASSI S. – CECCHETTI M. – ANDRONIO A., Firenze, 1999.
7. JONAS H., *Il principio responsabilità. Un'etica per la civiltà tecnologica*, Torino, 2009.

¹⁹³ Komunikata e Komisionit të Parlamentit European, në Këshillë dhe në Komitetin Ekonomik dhe social european "Unatabelladi marcia verso un'economia competitiva a basse emissioni di carbonio nel 2050"

[COM(2011) 112 def.] del 8/3/2011.

8. Montorsi, T., «*Crisi economiche, sostenibilita' ambientale e politiche pubbliche: Il ruolo del legislatore e della pubblica amministrazione*», (tesi di dottorato di ricerca in diritto ed economia), Universita 'degli studi di Bologna, Bologna, 2013.
9. Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit European dhe Këshillit, datë 21.04.2004 «Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin», të ndryshuar.
10. Direktivën 2008/99/EC “Për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet legjislacionit penal”.
11. Komunikata e Komisionit të Parlamentit European, në Këshillë dhe në Komitetin Ekonomik dhe social european “*Unatabelladi marcia verso un'economia competitiva a basse emissioni di carbonio nel 2050*” [COM(2011) 112 def.] del 8/3/2011.
12. Komunikatës së Komisionit të Parlamentit European, në Këshillë, në Komitetin Ekonomik dhe Social European , numër 363, del 20 giugno 2011.
13. Kushtetuta e Malit të Zi.
14. Ligji nr. 10 431, datë 09.06. 2011, «Për mbrojtjen e mjedisit».
15. Rekomandime, Sesioni II “Ndotja e Mjedisit në Shqipëri dhe Standardet-Europiane”,2015.
16. <http://akm.gov.al/cil%C3%ABsia-e-mjedisit.html>.

13.Elementet themelore te vepres penale

IRIDA B.QOKU
Prokuroria Tiranë

ABSTRAKTI

Tema që do të trajtoj lidhet ngushtë me veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit . Edhe në parahistori duke përfshirë periudhën e zhvillimit shoqëror përfshihet 1500000 deri në 10000 vite me parë ruajtja e dinjitetit dhe moralit ishte një nga armët mbrojtëse me anë të cilit njeriu paraqitej në grup , pastaj me evoluimin e kohës në shoqëri ,dhe me pas në qeverisje . Me pak fjale , ishte çështja kryesore e individit . Individi duke u përfshirë në qeverisje , në vendimarrje filloi ta kuptonte që dinjiteti lidhej tërësisht me vlerat e tij vetjake kryesisht me sferën që do të zinte ai në shoqëri si dhe me tiparin e ndërshtërës nga e cila buroi morali . Por , që nga evolucioni dhe kalimi i kohës nga historia deri në ditët e sotme a ka ndryshuar kuptimi i dy fjaleve kyç moral dhe dinjitet ? Vështirë të pranohet sot ? Teknologjia ka bërë të veten në fushën e komunikimeve saqë çdo ditë e më shumë vihet në dukje zbehja e këtyre .Prandaj si e tillë u pa e nevojshme që të futet si e drejtë mbrojtja dhe dinjiteti i njeriut në pedestalin më të lartë të vlerave të tyre dhe ka tentuar që marrëdhëniet shoqërore të cilat u paraqiten në një shoqëri të veje nën kornizat e normave juridike për të garantuar një siguri tek individi në shoqëri si dhe në përgjithësi..

Hyrje

Drejtësia penale është një nga shtyllat kryesore të shtetit të së drejtës . Në ditët e sotme ajo përballë me format e reja të sofistikuar të krimit në dy aspekte kryesore si ;vepra penale kundër moralit , dhe vepra penale kundër dinjitetit . Duke njohur dhe zbatuar në praktike sistemin e normave juridike procedurale penale , si dhe duke vënë në zbatim funksionin e këtyre normave të vetë sistemit të drejtësisë penale , për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut , në kultivimin dhe parandalimin e tij . Punimi është i ndarë në kapituj që flitën për Veprat Penale kundër Moralit dhe Dinjitetit . Të cilat u futën si veprat në Kodin Penal të vitit 1995 që hyri në fuqi më 1 dhjetor . Qëllimi dhe futja si vepra penale ishte e lidhur ngushtë me cenimin , shpifjen , përndjekjen , përhapjen e sekreteve vetjake të personit që çuan deri në burgim të tij . Shumë vepra të cilat përmenda sot janë dhe mbrohem dhe nga Deklarata Universale e të drejtave të njeriut . Një ndër to është e drejta e privatesisë ku një nën të saj është i pasqyruar edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë , por edhe në

Kushtetutat e botes . Madje per shkelje te saj jane marr sanksione te ndryshme . I vetmi kendevershtrim qe kjo e drejte te jete e garantuar ishte shtetit perballe individit ku shteti se bashku me organet e tij nuk mund ta shkele kete te drejte qe mbrohet me ligj . Pra vete shoqeroria po kontribon dhe po kujdeset qe dispozitat nderkombetare dhe kushtetuese ndaj dinjitetit dhe moralit te mbetet nje dileme fakti se a duhet tani e tutje qe te jete nje e drejte e garantuar edhe ne instrumentat ligjor ?!

LLOJET E VEPRAVE PENALE

Duke ju referuar Kodit Penal te Republikes se Shqiperise morali dhe dinjiteti u futen si veprave penale te cilat mbroheshin me ligj . Ne Kod jane referuar 11 nene kunder moralit dhe dinjitetit. Po analizoj Neni 121 te Kodit ;

Nderhyrja te padrejta ne jeten private ;

Vendosja e aparaturave qe sherbejne per degjimin apo regjistrimin e fjaleve ose te figurave , degjimi, regjistrimi , ose transmetimi i fjaleve , fiksimi , regjistrimi , ose transmetimi i figurave , si dhe ruajtja per publikim apo publikimi i ketyre te dhenave qe ekspozojne nje aspekt te jetes private te personi pa pelqimin e tij perben kundervajtje penale dhe denohen nga me gjobe ose me burgim gjer ne 2 vite .

Theksojme ... Njeriu qe ne castin qe lind i atribohet kjo e drejte pra eshte si nje pakete vlerash qe e shoqerojne individin pergjate gjithë jetes . Por , nese do te analizojme nenin nderhyrjes se padrejta ne jete private nga ana objektive jane marredheniet juridike te vendosura nga shtetit me qellim qe te mbaje sa me te kufizuar dhe shume diskrete jeten e personit , qoft personit publik ashtu edhe qytetarit te thjesht . Nga ana objektive kjo veper penale realizohet me ane te aparaturave te sofistikuara qe sherbejne per degjimin regjistrimin e figurave transmetimin fiksimin dhe ruajtjen dhe ne pas publikimin prane mjeteve dhe programeve transmetuese ne Tv , radio , ose faqeve te Uebit . Kjo vetem realizohet nga qytetaret kundrejt personave me autoriteti te larte qe ushtrojne poste drejtuese ne institucone te larta qeverisese . Nga ana subjektive vepra realizohet nga cdo person i cili ka mbushur moshen per pergjegjesi penale dhe eshte i pergjegjshem duke vendosur dhe cenimin e te gjithë kesaj privatesie , por gjithemone mbetet pjese e gjykimi nese do te shkoj ceshtja ne gjykate . Per nga ana subjektive vepra 121 realizohet me dashje te drejteperdrejte duke pasur si synim kryesor qellimin e perfitimit. Veprimi me

ane te sjelljes se individit duke i cenuar jeten e tij perben nje nga elementet themelore te vepres penale . Ky veprim shprehje me ane te veprimeve qe gjate analizes konstatojne ne veprime te kryera me dashje te drejteperdrejte dhe ne raste te tjera edhe nga pakujdesia duke bere bujen e materialeve qe per nje cast te vetem mund te bejme bujen ne qindren e sekondit . Ne thelb te gjithë kesaj vepre qendron veprimi i cili eshte i lidhur ngushtesisht me boten e brendshme te njeriut qe shfaqen ne forma te ndryshme si mendimi , deshira veprimi , realizimi i drejteperdrejte dhe qellimi per ta kryer vepren penale .

ELEMENTET EVEPRES PENALE

Struktura per te gjitha veprat penale qe jane te sanksionuara ne Kodin penale per moralin dhe dinjitetin jane te njejta . Ne vepren penale elementi qenesor nenkupton te gjithë elementet e vepres penale .Pra jane pikerisht elementet qe e dallojne kete veper nga veprat e tjera penale . Ne veper dallojme elementet e vecanta dhe elementet e pergjithshem derisa te zbulojne ekzistencimin e vepres penale .Elementet e pergjithshem karakteriozohen permes elemnteve te vecanta , e cila lidhet nepermjet kohes qe eshte bere vepra penale , vendit , menyres, dhe mjetit qe eshte realizuar vepra , dhe pasojen (lidhet me shkeljen , pakujdesine , ose me shkallen e rezikshmerise shoqerore qe eshte realizuar vepra penale ne raport me objektin e caktuar . Elementet dytesore nese nuk mund te ekzistojne atehere nuk ka vepra penale. .

- Vendi i vepres penale konstaton qe zakonisht pasoja vjen ne vendin ku eshte kryer vepra . Por nuk mund te anashkalojme faktin kur vepra kryhet ne nje vend dhe pasoja mund te vij ne nje vend tjeter . Zakonisht keto vepra i quajme vepra destinancionale ku eshte me nje rendesi shume te madhe vetem vendi ku eshte kryer vepra .
- Nga vendi ku eshte kryer vepra penale varet se cili ligj mund te aplikohet
- Pastaj sipas vendit do te caktohet kompetenaca lendore kur ceshtja do te shkoj per gjykim
- Mund te konsiderohet vendi i kryerjes se vepres konsiderohet si vend konstiuktiv
- Si dhe me ane te marreveshjeve diplomatike ku ndodh shpesh qe nje vepra penale mund te jete kryer ne nje vend dhe pasoja mund te kete ardhur ne nje shtet tjeter , prandaj eshte me shume rendesi vendi
- Koha e realizimit te vepres penale eshte nje faktor thelbesor qe lidhet kryesisht me ligjin qe do te gjykohet ceshtja. Pra nese ekziston eshte ne fuqi ligji ne kohen qe eshte

mare veprimi per realizimi te vepres penale . Por nese i referohemi sanksionit te veprave penale kunder moralit dhe dinjitetit mund te themi se lidhet dhe me moshen e personit qe mund te jete i mitur , i pergjegjshem , i pafajshem , ose mund te jete pikerisht ai qe ka kryer veprën , ose i fajshem . Por nese do te referohemi vepres penale te kryer ne bashkepunim merret koha kur bashkepunetori ka ezauruar keto element te vepres penale pikerisht kohen .

- Nje nga elementet e figures se vepres penale nje vend te vecante ze edhe pergjegjesia penale . Lidhet drejtepersedrejt dhe me kohen e realizimit te vepres nese ne ato momente ka qene i pergjegjshem . Krahas pergjegjesise penale kemi dhe papergjegjshmeri

- ✓ Papergjegjshmeria ku nje ligjin penal eshte ^nje person nuk eshte i pergjegjshem nese ne kryerjen e vepres penale nuk ka mundur te kuptoje rendesine e vepres se vet , apo nuk ka mundur qe ti kontrolloj sjelljet e tij per shkak te semundjeve psikike , crregullimit psikik te perkohshem , apo te metave te tij mendore ^.

Semundjet mendore e bejne personin te perkohesisht te papergjegjshem .

Semundjet psikike jane ato qe mund te zgjaten per nje periudhe kohet te caktuar dhe personi mund te kthehet ne gjendjen fillestare ku ka qene ne fillim .

1. Menyren e realizimit te vepres penale futet tek objekti i vepres penale dhe nuk element perberesi domosdoshem i anes objektive te figures se vepres penale per te gjitha llojet e veprave penale qe jane te parashikuar ne kodin penal. Pra menyra e realizimit eshte procesi i realizimit te punes qe autori ndjek qe ne momentin e kryerjes se veprimit ose mosveprimit , shoqerisht te rezikshem dhe qe eshte ne kundërshtim me ligjin , deri kur ka ardhur pasoja .

- 1) Ne veprën penale nje rol te rendesishem ze dhe **Mjeti** qe ne te drejten penale quhen element te anes objektive te figures se vepres penale . ^per shkak te rrezikshmerise se larte shoqerore qe paraqesin veprat penale , per kryerjen e te cilave do te perdoren ku per ligjevenesine kane sherbyer si baza per dhenien e vendimit.Keshtu per shembull nese do ti referohem neni 80 te kodit penale (sigurimin e kushteve dhe i mjeteve materiale)ku sigurimi i vjeteve materiale per te kryer veprën penale perbente veper penale (krim)

Fazat e kryerjes se vepres penale

Veprimi i njeriut per te kryer veper penale kalon ne disa faza.

1. Mendimi per te realizuar vepren penale . Kjo faze zhvillohet ne psikiken e autorit .Qe ka per qellimin momentin kur autori vendos per te kryeje vepren penale . Ka raste kur mendimi per te realizuar vepren ka ardhur nga deshira por edhe mund te jete nje vendimi i castit qe merret aty per aty. Nese do te analizojme vepren penale te fyerjes dhe te ndalemi te ana objektiv mendim lind ne menyre te natyrueshme dhe pa menduar qe lidhet drejtepersdrejti me forcen e brendshme qe shpikesit dhe rrezikshmeria shoqerore kur fyerja vjen ne menyre te qellimeshme eshte me e larte . Por kjo faze ekzsiton vetem ne veprat penale te cilat jane te kryera me dashje .

Veprimet pergaditore te cilat ndermerren me qellim per te kryer vepren penale .

Per te realizuar vepren penale nuk mjafton vetem koha , menyra , vendi , mjeti qe i grupojme si elemente te vepres penale . Veprimet pergaditore konsistojne ne furnizimin e mjeteve per kryerjen e vepres penale si nga furnizimi me ane te pageses , *duke ju referuar nenit 114 * Shfrytezimi i porstitucionit . Ku eproret sic mund te quajme ne thonjeza e ushtrojne prostitucionit duke vendosur ne dispozicion te tyre ambjente me qera qofshin shtepiza te vogla per ta ushtruar kete vepres penale . Krahas shtepiza te vogla ato jane te detyruar qe te furnizojne me ushqime , veshje , si dhe me ane te mjeteve per te bere te mundur transportimin e tyre nga nje vend ne tjetet per te gjetur partnere . Ku bie ne shkelje flagrante me ligjin . Por legjislacioni penale dhe praktika gjyqesore njeh dy lloje te veprimeve pergaditore

*Veprimet pergaditore qe jane percaktuar si veper penale te posacme

*Nderlikimet e te gjitha fazave te veprimeve pergaditore te disa veprave penale

Nga praktika gjyqesore veprimet gjate gjykimit sherbenin si prova e cila formohet vetem ne gjykate .

Fillimi i kryerjes se vepres penale e cila mund te ngel dhe ne tentative

Tentativa eshte nje nga institutet me te rendesishme te se drejtes penale . Kuptimi i saj paraqet rendesi shume te madhe per percaktimin e se drejtes , ku vepra penale eshte kryer apo ka mbetur ne tentative .Duke ju referuar nenit 22 te Kodit Penale 8* Vepra penale quhet e mbetur ne tentative kur , megjithese personi , ndermerr veprime te drejteperdrejta per ta kryer

ate , vepra nderrpritet dhe nuk perfundohet per rrethana te pavarura nga vullneti i tij . Pra vete kuptimi i tentatives ka 2 kuptime ate te anes objektive ashtu dhe te anes subjektive . Pas gjithë fazave per te realizuar vepren penale qe ishte mendimi , veprimet , vjen momenti i fillimit te kryerjes se vepres penale . Por kjo faze te mund te jete vetem per krime dhe jo per kundervajtje penale . Tentativa ekzsiton vetem per krimet e kryera me dashje duke u nisur vetem nga perkufizimi qe lidhet me veprimin e drejteperdrejte ne vepren penale . Referime *

Nje problematike e hasur ne praktike eshte ajo qe autori hyne ne banese per vjedhje por qe per shkaqe te pavarura nga vullneti i tija ai merr vetem disa sende dhe jo te gjitha sipas planit te paramenduar .Ne keto raste jemi perballe vepres se kryer apo te mbetur ne tetnative ?Ne praktiken tone raste nuk ka por sjell ne vemendje jurisprudencen e gjzkatave italiane . Keshtu ne nje vendim te saj gjykata e Kasacionit ne Itali 3 maj te vitit 1972 me numer 1448 e zgjidh kete dyshim perfundimisht duke shprehur se vepra do te konsiderohet e konsumuar .

Vendimet e gjykates Shqiptare

Per vendimet e gjykates shqiptare u referuan vetem te Kodi Penal dhe Kodi i Procedures . Duke ju referuar nje venimi te Gjykates se Larte te Kolegjeve se Bashkura Penale .

Per te analizuar vendimet e gjykates trupi gjykues ne baze te nenit 120 te shpifjes

Ato rriten ne perfundim se ceshja qe ju shkoi ne gjykate nuk kishte te bente me shpifje . Ne vendimin e tij citohej

Nga permbajtja e nenit 120 te Kodit Penal per te pasur shpifje kerkohej te plotesohen keto kushte

- Shpifja te behej me perhapjen e thenieve si dhe cdo informacioni tjeter
- Theniet apo informacioni tjeter te jete i rreme
- Theniet apo informacionet tjera te jene konkrete
- Theniet apo informacioni tjeter te jene diskritituese domethene te cenojne nderin dhe dinjtetin e njeriut .

- Legjislacioni yne penal nuk e parashikon si figure te vepres penale difamacionin – perhapjen e informacioneve te verteta por qe jane me natyre poshteruese per tjetrin . Pra dhe ne keto kushte vepra u cilesua si fyerje dhe jo shpifje .
- Ne nje tjeter vendim gjyqesor i Pandehuri L deklarohet fajtor sepse kishte perhapur informacione te rreme ne adrese se te demtuares se gjoja ajo mbante relacione intime me nje person tjeter , duke e denuar per kundravajtje penale te shpifjes dhe u denuar ne baze te nenit 120 te kodit penal

Gjykata shprehej se nese shpifja eshte ne rrethana te cilesuara kur ajo do te kryhej boterisht , kurse ne rastin e vendimit gjyqesor ajo u kryeu vetem nga nje person , nuk kishte te bente me shpifje .

Kurse me shpifje te bere ne dem te disa personave , kuptohet perja e thenieve qe dihet se jane te rreme kunder 3 apo me shume personave ,,,, Psh perhap thenie se A, B e C jane pjestare te bandes se armatosur qe grabiten pasagjeret ne autobus , duke ditur se keto thenie nuk ishin te verteta .

KONKLuzionET

- Gjate punimit te tezes arrita te identifikoj se cfare quajme moral , dinjitet
- Cilat ishin elementet qe conin ne nje veper penale
- Si kryhej vepra ?
- Fazat e kryerjes se vepres penale ?
- Nese ishim perballe kesaj vepre penale kush ishin elementet qe do te konstatoje gjykata per te dhene ne fund vendimin ne lidhje me vepren penale
- Perkraha kodi penal dhe kodit te procedures plus dhe te drejtes penale , dhe te drejtes penale te posacme per vepren penale u hartua dhe deklarata universale per te drejatat e njeriut qe ju vinte ne ndihme te gjitha vendeve te bashkimit evropiane qe i dergonin ceshtjet e tyre ne gjykatën e strasburgut .

- Ndersa ne legjislacionin e brendshem sic perfshihej edhe juridiksioni i gjykatave kompetente te cilat do te gjykoreshin ne gjykatën kompetente

Literatura:

- ✓ Kodi penal i Republikës së Shqipërisë
- ✓ Konventat Europiane e të Drejtave të Njeriut
- ✓ Pakti Nderkombëtar mbi të Drejtat e Njeriut
- ✓ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
- ✓ Vendimet e Gjykatës së Lartë
- ✓ Vendimet e Gjykatës së Strasburgut
- ✓ GjEDNJ